



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2022

P R I S H T I N Ë , Q E R S H O R 2 0 2 3

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2022

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit-Ushtrues detyre i Guvernatorit	11
Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv	13
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2022	17
1. Përmbledhje ekzekutive	19
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	25
2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	25
2.2. Ballkani Perëndimor	27
3. Ekonomia e Kosovës.....	29
3.1. Sektori real	29
3.2. Sektori fiskal	34
3.3. Sektori i jashtëm.....	35
3.4. Sektori financiar	38
3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2023	55
4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar	56
4.1. Licencimi	56
5. Mbikëqyrja e sistemit financiar	67
6. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun	72
6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	72
6.2. Sistemi i Pagesave.....	79
6.3. Menaxhimi i Mjeteve	87
6.4. Teknologjia Informativë	92
6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës	93
6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar	94
6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2022.....	95
6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.....	97
7. Zhvillimet e Brendshme	98
7.1. Auditimi i Brendshëm	98
7.2. Burimet Njerëzore	99
7.3. Aktiviteti Ligjor i BQK-së.....	99
7.4. Funkcioni i Menaxhimit të Rrezikut	100
8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....	103
8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare	103
8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar.....	105
8.3. Asistenca Teknike.....	106
8.4. Integrimet Evropiane	107

9. Pasqyrat Financiare	111
10. Shtojca Statistikore.....	167

LISTA E SHKURTESAVE

ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (Automated Clearing House)
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
EUROSTAT	Drejtorati Gjeneral për Statistika Evropiane
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
KJP	Kreditë Joperformuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësishë

PNI	Pozicioni Ndërkombëtare i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RPP	Programi për Pagesa dhe Remitanca
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SPN	Sistemi i Pagesave Ndërbankare
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)

LISTA E GRAFIKËVE

1.	Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore -----	26
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor -----	27
3.	Norma e rritjes së BPV-së reale -----	29
4.	Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore -----	30
5.	Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm -----	31
6.	Inflacioni i brendshëm dhe i importuar -----	31
7.	Regjistri i bizneseve -----	32
8.	Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	33
9.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	35
10.	Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	35
11.	Struktura e importeve sipas kategorive -----	36
12.	Remitancat -----	37
13.	Investimet e huaja direkte -----	37
14.	Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës -----	38
15.	Zërat kryesorë të aseteve të sektorit bankar -----	39
16.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	39
17.	Kreditë e reja -----	40
18.	Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë -----	40
19.	Stoku i kredive, sipas sektorëve ekonomikë -----	40
20.	Struktura e depozitave -----	41
21.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	42
21a.	Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit -----	42
22.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	43
23.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve të ekonomisë -----	43
24.	Norma mesatare e interesit në depozita -----	43
25.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	43
26.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	44
27.	Profiti neto i sektorit bankar -----	44
28.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	44
29.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	45
30.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	45
31.	Asetet e sektorit pensional -----	46
31a.	Përformanca e FKPK-së -----	46
32.	Investimet e FKPK-së -----	47
33.	Investimet e FSKP-së -----	47
34.	Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale -----	47
35.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	48

36.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	51
37.	Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	52
38.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	52
39.	Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare -----	52
40.	Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	52
41.	Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	53
42.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë -----	53
43.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	54
44.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	54
45.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore-----	54
46.	Struktura e sitemit financiar në Kosovë -----	57
47.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	57
48.	Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve -----	57
49.	Rrjeti i siguruesve-----	58
50.	Furnizimi me para të gatshme-----	73
51.	Pranimi i parave të gatshme -----	73
52.	Furnizimi me para të gatshme-----	73
53.	Pranimi i parave të gatshme -----	73
54.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve -----	74
55.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	74
56.	Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve-----	74
57.	Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve -----	74
58.	Eksporti i parave të gatshme -----	75
59.	Importi i parave të gatshme -----	75
60.	Eksporti i parave të gatshme (vëllimi) -----	75
61.	Importi i parave të gatshme (vëllimi)-----	75
62.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (vëllimi)-----	75
63.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	75
64.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve) -----	76
65.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	76
66.	Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim -----	76
67.	Kartëmonedhave të reja të lëshuara në qarkullim nga gjithsej të furnizuara -----	76
68.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)-----	76
69.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara -----	76
70.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri-----	77
71.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro -----	77
72.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse-----	78
73.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse -----	78
74.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	78

75.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	78
76.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	78
77.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	78
78.	Numri i transaksioneve në SPN-----	80
79.	Vlera e transaksioneve në SPN-----	80
80.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
81.	Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
82.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN-----	81
83.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN -----	81
84.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	81
85.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	81
86.	Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit të vlerës së shlyer në RTGS -----	82
87.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit -----	83
88.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	83
89.	Numri i terminaleve ATM-----	84
90.	Numri i terminaleve POS-----	84
91.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	84
92.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	84
93.	Numri i transfereve të kreditit në formë elektronike në raport me transferet në formë letre -----	84
94.	Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse --	85
95.	Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së -----	88
96.	Saldo përfundimtare e mjeteve në EUR të investuara sipas gjendjes së tyre, më 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	88
97.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD -----	88
98.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit në EUR të BQK-së-----	89
99.	Shpërndarja e portofolios investuese në çdo fundvit -----	90
100.	Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit -----	91
101.	Struktura e investitorëve nën ankande -----	91
102.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2021 dhe 2022 -----	91
103.	Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë në vitin 2022 -----	92
104.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	93
105.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	93
106.	Numri i kërkesave për raportet kreditore-----	94
107.	Struktura sipas edukimit-----	99

LISTA E TABELAVE

1.	Indikatorët bazë makroekonomikë në eurozonë -----	26
2.	Të dhënat mbi treguesit makroekonomikë dhe bankarë për vendet e Ballkanit Perëndimor -----	28
3.	Numri i institucioneve financiare -----	38
4.	Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	39
5.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	41
6.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	48
7.	Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	49
8.	Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	50
9.	Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	50
10.	Rezultatet financiare -----	51
11.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	58
12.	Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve -----	58
13.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	59
14.	Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike -----	59
15.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK -----	60
16.	Numri i ekzaminimeve në banka -----	67
17.	Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB -----	67
18.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve -----	68
19.	Numri i ekzaminimeve -----	69
20.	Numri i ekzaminimeve -----	70
21.	Numri i ankesave ndër vite -----	71
22.	Numri i ankesave sipas statusit -----	71
23.	Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme -----	72
24.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	77
25.	Niveli i depozitave të klientëve kryesorë -----	79
26.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN -----	82
27.	Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare -----	82
28.	Numri i llogarive -----	85
29.	Numri i llogarive të parasë elektronike -----	85
30.	Numri dhe vlera e pagesave të parave elektronike -----	86

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit-Ushtrues detyre i Guvernatorit

Me nderin më të lartë prezantoj raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për vitin 2022. Në pajtim me kërkesat ligjore dhe standardet për transparencë dhe llogaridhënie, BQK ka hartuar raportin vjetor për 2022. Raporti, përveç një pasqyre mbi aktivitetet kryesore të institucionit, përmban edhe analizë mbi dinamikat kryesore makroekonomike në vend, rajon dhe më gjerë dhe stabilitetin e përgjithshëm financiar.

Në një vit të shënuar nga pasiguria globale, ngritja e çmimeve dhe çështjet e fragmentimit global si tensionet tregtare, konfliktet gjeopolitike dhe shtrëngimi i politikave monetare, ruajtja e balancave kryesore dhe stabilitetit të përgjithshëm ekonomik ka qenë sfidë e rëndë për politik-bërësit. Në këto rrethana, BQK në linjë me institucionet tjera vendore, ka ndërmarra masa dhe veprime adekuate në funksion të ruajtjes së stabilitetit të përgjithshëm financiar. Përqendrimi i BQK-së në ruajtjen e stabilitetit financiar, stabilitetit të çmimeve dhe sigurimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e aktivitetit ekonomik, në bashkërendim me masat e ndërmarra nga Qeveria, rezultuan në një rritje ekonomike prej 3.5 përqind në vitin 2022 – përkundër ambientit me rreziqe të rritura makroekonomike të brendshme dhe jashtme.

Përkundër rreziqeve të shtuara, sistemi financiar i Kosovës vazhdoi rritjen, duke reflektuar qëndrueshmëri në të gjithë sektorët e tij përbërës. Aktiviteti kreditor i sektorit bankar përshejtoi rritjen, duke shënuar shkallën më të lartë të rritjes në njëmbëdhjetë vitet e fundit prej 16.0 përqind, dhe duke mbështetur kështu, financimin e konsumit dhe investimeve të përgjithshme në vend. Ndërkohë, presionet e vazhdueshme inflacioniste si dhe pasiguritë rreth aktivitetit ekonomik në vitin 2023 rrezikojnë perspektiven ekonomike si për ekonomitë familjare ashtu edhe për bizneset. Me gjithë rritjen e përshejtuar të kreditimit gjatë vitit 2022, sektori bankar vazhdoi të ketë përmirësim të treguesit kyç të kualitetit të portofolit kreditor, respektivisht raportit të kredive-jo-performuese ndaj gjithsej kredive, në 2.0 përqind. Megjithatë, shkalla e lartë e inflacionit, sidomos atij bazë, rritë rrezikun dhe rrjedhimisht, nevojën për monitorim më të afërt të dinamikave në rrezikun kreditor në vitin 2023. Aktiviteti i përshejtuar kreditor, dhe si rrjedhojë rritja e mjeteve të peshuara me rrezik, rezulton të ketë ndikuar lehtësisht edhe pozitën e kapitalizimit të sektorit, megjithëse niveli i kapitalit qëndron mbi nivelet minimale rregullative në 15.5 përqind, nga 12 përqind sa kërkohet nga korniza ligjore në fuqi.

Edhe sektorët tjerë brenda sistemit financiar në Kosovë rezultojnë të kenë shënuar rritje dyshifrore përgjatë vitit 2022, përveç sektorit pensional që në vitin 2022 u karakterizua me ngadalësim më të theksuar të rritjes së asetëve dhe rënie të vlerës së investimeve krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e zhvillimeve jo të favorshme makroekonomike globale dhe tensioneve gjeopolitike që u përkthyen në luhajtje në tregjet financiare globale.

Ndryshimi i shpejtë dhe i vazhdueshëm i sektorit financiar në vend, Eurozonë dhe mbarë botën kërkon përshtatshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës dhe kornizës ligjore. Gjatë vitit 2022, BQK ka aprovuar rregullore në lidhje me menaxhimin e rrezikut në sektorin bankar, që janë në linjë me kërkesat e BASEL III, dhe rregullore tjera në funksion të stabilitetit financiar. BQK ndjekë me vëmendje transformimet digjitale në sistemin financiar që mbështesin inovacionin dhe rritjen e eficiencës. BQK është pjesëmarrëse në projekte të rëndësishme ndërkombëtare që modernizojnë sistemin e pagesave, promovojnë përfshirjen financiare dhe përmirësojnë rolin e mbikëqyrjes në sektorin financiar.

Në vitet në vazhdim, BQK së bashku me partnerët ndërkombëtar do të fokusohet të forcojë rolin e saj në politikat mjedisore, sociale dhe qeverisëse (ESG), që duhet të merren në konsideratë nga akterët e sektorit financiar. Investimi dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore me shkathtësitë e duhura, për ta përmbushur mandatin me ligj, janë të domosdoshme dhe në fokus të BQK-së. Rritja e rreziqeve me avancimet e vazhdueshme në teknologji, zgjerimi i vazhdueshëm i mandatit të

BQK-së në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe hendeku në shkathtësi që karakterizon tregun e punës në vend ka rritur presionet në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e atraktivitetit të BQK-së si punëdhënës në tërheqjen e shkathtësive të duhura dhe mbajtjen e tyre.

Përkushtimi jonë për të nxitë qeverisje të fortë dhe për të mirëmbajtur besimin e publikut mbetet i palëkundur. Objektivi e jona mbetet forcimi i kontroleve të brendshme, ngritja e kapaciteteve për monitorimin, analizimin dhe menaxhimin e rreziqeve që kanosin stabilitetin financiar, dhe promovimi i sjelljes etike. Me anë të komunikimit efektiv dhe transparent, BQK do të vazhdojë të bashkërendoj politikat në koordinim me akterët kryesor në vend si qeverinë, institucionet financiare, partnerët ndërkombëtar dhe publikun.

Për fund, të arriturat gjatë vitit 2022 tregojnë qëndrueshmërinë e sektorit financiar dhe përkushtimin e personelit, të cilëve ju shpreh mirënjohje nga zemra. Me vizion të qartë dhe përkushtim, BQK do të vazhdojë të navigoj në peizazhin ekonomik i cili çdoherë ndryshon, dhe të përmbush në mënyrë të shkëlqyer mandatin e saj.

Dr. Sc. Bashkim NURBOJA



**Kryetar i Bordit-Ushtrues detyre i Guvernatorit
i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës**

Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv

Bordi i Bankës Qendrore

Procesi i vendimmarrjes në Bordin e Bankës Qendrore udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Gjithashtu, Bordi i Bankës Qendrore, ka ushtruar mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2022, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur 12 mbledhje në të cilat janë marrë gjithsejtë 38 vendime.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv, si në vazhdim:

1. Rregullore për Instrumentet e Pagesave Elektronike;
2. Rregullore për Transferet dhe Pagesat e Transferit të Mjeteve të Pensionit;
3. Rregullore për Përcaktimin e Përfituesve të Pensioneve;
4. Rregullore për Përfitimet Pensionale të Fondeve Plotësueses Pensionale të Punëdhënësit;
5. Rregullore për Auditorët e Jashtëm të Fondeve Pensionale;
6. Rregullore për Treguesit e Mbulimit me Likuiditet;
7. Rregullore për Treguesit e Financimit Neto;
8. Rregullore për Qasje në Llogari Pagese me Shërbime Bazike.

Bordi i Bankës Qendrore, gjithashtu ka miratuar:

- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2021;
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2021 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Buxhetin e BQK-së për vitin 2023;
- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;
- Statutin e Komitetit të Auditimit;
- Statutin e Auditimit të Brendshëm;
- Manualin për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së Auditimit të Brendshëm;
- Kodin e Etikës për Auditorët të Brendshëm të BQK-së;
- Manualin për Auditimin e Brendshëm;
- Politikat Kontabël të Bankës Qendrore;
- Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Gjithashtu, Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2022, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët si më poshtë:

Flamur Mrasori, Kryetar;

Fehmi Mehmeti, Guvernator;

Nora Latifi Jashari, Anëtare;

Bashkim Nurboja, Anëtar; dhe

Nexhat Kryeziu, Anëtar.

Komiteti i Auditimit

Komiteti i Auditimit (KA) është emëruar nga Bordi i Bankës Qendrore në përputhje me Nenin 62 të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i Komitetit të Auditimit (KA) është që të ndihmojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në përmbushjen e përgjegjësive të saj, sa i përket menaxhimit të rrezikut të institucionit, kontrolleve, qeverisjes dhe aktiviteteve të ndërlidhura me to, si në vijim:

- Raportimit financiar dhe integritetit të Pasqyrave Vjetore Financiare;
- Pajtushmërisë me ligjet, rregullat dhe Kodin e Etikës;
- Funkcionimit të kontrollit të brendshëm;
- Menaxhimit të rrezikut;
- Efikasitetit dhe objektivitetit të funksionit të Auditimit të Brendshëm (AB); dhe
- Performancës së funksionit të AB-së dhe Auditorëve të Jashtëm (AJ).

Bordi i Bankës Qendrore ka përcaktuar përbërjen, përgjegjësitë dhe detyrat e Komitetit të Auditimit në Statutin e Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore. KA-ja i raporton periodikisht Bordit të Bankës Qendrore. Përderisa, veprimtarinë e vet mund ta rregullojë duke iu përmbajtur çdo kërkesë të Ligjit për Bankën Qendrore dhe çfarëdo urdhërese që i jepet këtij organi nga Bordi i Bankës Qendrore.

Prej datës 15.06.2020, Komiteti i Auditimit ka qenë jofunksional, si rrjedhojë e skadimit të mandatit të dy (2) anëtarëve joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, e të cilët ishin edhe anëtarë të KA-së. Bordi i Bankës Qendrore në takimin e mbajtur më datë 28.02.2022, ka emëruar dy (2) anëtarë joekzekutivë nga radhët e veta, në cilësinë e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore, duke e funksionalizuar këtë organ. Gjatë kësaj periudhe, KA-ja ka qenë mjaft aktiv, duke zhvilluar gjithsej tetë (8) takime.

Me 31 dhjetor 2022 Komiteti i Auditimit përbëhej nga anëtarët si më poshtë:

Nora Latifi-Jashari – Kryetare,;

Nexhat Kryeziu - Anëtar ;

Edona Perjuci-Uka - Anëtare e jashtme.

Për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat e tij, Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2022, ka kryer punët si në vijim:

- Ofrimi i këshillave në fushat e përgjegjësisë së Menaxhmentit për sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Diskutimi dhe mbështetja e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2023-2025;
- Diskutimi dhe mbështetja e planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 (dokument ky i cili është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore);
- Diskutimi dhe mbështetja e planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 (dokument ky i cili është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore);
- Rishikimi i raporteve përmbledhëse të auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet që kanë dalë nga këto auditime, si dhe ka kërkuar nga Bordi i Bankës Qendrore që t'i kërkojë Menaxhmentit të BQK-së, adresimin e këtyre të gjeturave;
- Rishikimi i deklaratave financiare, vlerësimi i çështjeve lidhur me opinionet e auditimit të jashtëm dhe të gjitha raportet e auditimit.
- Rishikimi i çështjeve të ngritura nga auditimi i jashtëm;
- Është siguruar se ekziston një marrëdhënie efektive në mes të Auditimit të Brendshëm dhe Auditorit të Jashtëm;
- Në vazhdimësi ka mbrojtur pavarësinë funksionale të Shefit të Auditimit të Brendshëm dhe funksionit të AB-së;
- Vlerësimi mbi përshtatshmërinë e burimeve të auditimit të brendshëm;
- Ofrimi i këshillave mbi çështjet lidhur me rreziqet e identifikuar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Ka mbajtur të dhëna për të gjitha takimet së bashku me raportet e ofruara nga funksioni i Auditimit të Brendshëm dhe të gjitha të dhënat e shkruara për të gjitha çështjet dhe dëshmitë që lidhen me këto raporte, si dhe veprimet që merren nga Komiteti i Auditimit.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me Shefin e Auditimit të Brendshëm kanë rishikuar të gjitha dokumentet të cilat ndërlidhen me funksionin e Auditimit të Brendshëm, si në vijim: Statutin e Komitetit të Auditimit, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës për Auditorët e Brendshëm të BQK-së, Manualin për Përmirësimin dhe Sigurimin e Cilësisë së Auditimit të Brendshëm, Manuali i Auditimit të Brendshëm, si dhe Formularët Standardë të Auditimit të Brendshëm. Këto dokumente janë përcjellë tek Bordi i Bankës Qendrore, ku pas diskutimeve dhe komenteve përkatëse, të njëjtat janë miratuar.

Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i BQK-së përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv dhe Zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2022, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Fehmi Mehmeti, Guvernator dhe Shkendije Nahi, U.D. Zëvendësguvernatore për Mbikëqyrje Financiare. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi Ekzekutiv është i ngarkuar me administrimin dhe ushtrimin e

operacioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa aktiviteti i tij mbikëqyret nga Bordi i Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2022, Bordi Ekzekutiv ka mbajtur 32 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij në relacion me Bordin e Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar dhe përgatitur për procedim rregullorë të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, raportin vjetor të BQK-së, si dhe raportet, pasqyrat dhe planet financiare të BQK-së. Në kontekstin e dhënë, nga Bordi Ekzekutiv po ashtu janë përgatitur dhe komunikuar raporte dhe informata të rregullta dhe ad hoc mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të dhëna.

Bordi Ekzekutiv në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2022 ka miratuar dy udhëzime metodologjike dhe një manual udhëzues të aplikueshëm për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën sferë të kompetencave, Bordi Ekzekutiv në sektorin bankar ka miratuar licencimin e një banke, ndërsa në sektorin financiar jobankar ka miratuar regjistrimin e pesë institucioneve me aktivitet të këmbimit valutor dhe një institucion me aktivitet të shërbimeve të pagesave dhe emetimit të parasë elektronike. Në anën tjetër, në sektorin e sigurimeve, gjatë vitit 2022 janë revokuar licencat e tre ndërmjetësuesve në sigurime. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave dhe duke u bazuar në detyrat mbikëqyrëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në katër raste janë miratuar masa ndëshkimore-administrative ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura.

Në vitin 2022, Bordi Ekzekutiv ka miratuar raportimin periodik lidhur me implementimin e planit strategjik të BQK-së për vitin 2021, si dhe miratimin e planit të ri strategjik për periudhën 2022-2024. Po ashtu Bordi Ekzekutiv ka miratuar nxjerrjen/ndryshimin dhe plotësimin e 14 politikave dhe rregullave të brendshme, si dhe ka mbikëqyrrur raportimet e organeve të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

1. Përmbledhje ekzekutive

Perspektiva ekonomike në eurozonë gjatë vitit 2022 u ndikua negativisht nga rritja e pasigurive gjeopolitike me fillimin e luftës në Ukrainë dhe presionet e rritura inflacioniste, presione që u pasuan me politika të shtrënguara monetare në gjysmën e dytë të vitit.

Bazuar në të dhënat preliminare nga Eurostati, aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2022 shënoi rritje reale prej 3.5 përqind, kundrejt rritjes prej 5.3 përqind në vitin paraprak. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2022 u ndikua edhe nga përkeqësimi i kushteve të tregtisë për shkak të përshpejtimit të çmimeve të importit krahas çmimeve më të ulëta të eksportit në eurozonë.

Projeksionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) të dhjetorit për rritje ekonomike në vitin 2023 janë rishikuar për lartë nga 0.5 përqind në dhjetor në 1.0 përqind në mars 2023, si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë së eurozonës kundrejt goditjeve nga ambienti i jashtëm.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë rezultoi 8.4 përqind në vitin 2022 krahasuar me 2.6 përqind në 2021, duke arritur nivelin më të lartë në muajin tetor kur shënoi rritje dyshifrore (10.6 përqind). Kontributi kryesor në inflacionin në eurozonë erdhi nga çmimet e larta të energjisë dhe ushqimit me 3.8 dhe 1.9 pikë përqindje respektivisht. Përveç efekteve direkte dhe indirekte të rritjes së kostos së energjisë, inflacioni gjatë vitit 2022 u nxit pjesërisht edhe nga zhvlerësimi i monedhës së euros.

Projeksionet e BQE-së për inflacion në vitin 2023 janë rishikuar për poshtë nga 6.3 përqind në dhjetor në 5.3 përqind në projeksionet e marsit, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë, lehtësimit të pengesave në zinxhirët e furnizimit, vlerësimit të euros, si dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik.

Ngjashëm me eurozonën edhe Ballkani Perëndimor u përball me rritje të ngadalësuar ekonomike në vitin 2022 kundrejt vitit paraprak. Në vitin 2022, rritja mesatare e BPV-së reale në rajon ishte 3.8 përqind, me rritjen më të lartë të shënuar në Mal të Zi prej 6.6 përqind dhe rritjen më të ulët të shënuar në Maqedoninë e Veriut prej 2.0 përqind.

Projeksionet e FMN-së për vitin 2023 sugjerojnë se rajoni pritet të karakterizohet me një rritje reale të BPV-së prej 2.7 përqind. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë, partneri kryesor tregtar dhe burim i rëndësishëm për investime dhe remitenca pritet të jetë faktor përcaktues në dinamikat e përgjithshme ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Norma mesatare e inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor ka arritur në 12.1 përqind rritje vjetore, ku më e larta u shënuar në Maqedoninë e Veriut prej 18.7 përqind, e ndjekur nga Bosnja dhe Hercegovina me 14.0 përqind, dhe Shqipëria me shkallën më të ulët të inflacionit me 6.7 përqind.

Sipas vlerësimeve të ASK-së, ekonomia e Kosovës shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik iu atribua kryesisht rritjes së përgjithshme të çmimeve, duke ndikuar në rritjen reale të BPV-së me vetëm 1.0 pikë përqindje. Sa i përket eksporteve neto, dinamikat që e kanë karakterizuar sektorin e jashtëm të ekonomisë, veçanërisht bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, kanë ndikuar që eksportet neto të kenë një kontribut pozitiv prej 2.6 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Rritja e vizitave të diasporës në Kosovë ka rezultuar në rritjen reale të eksportit të shërbimeve për 17.9 përqind. Edhe eksporti i mallrave ka shënuar rritje reale prej 15.5 përqind në vitin 2022. Në anën tjetër, importi i mallrave ka shënuar rritje reale të ngadalësuar prej 2.0 përqind dhe kjo ka reflektuar në zvogëlimin e deficitit të mallrave dhe shërbimeve për 8.0 përqind në terma realë.

Çmimet në vitin 2022 vazhduan të diktohen kryesisht nga faktorë të jashtëm që përcaktuan trajektoren e inflacionit nga gjysma e dytë e vitit paraprak, që përfshijnë rritjen e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, pengesat në zinxhirët e furnizimit të shkaktuara nga pandemia dhe rritjen e hovshme të kërkesës së përgjithshme. Një ndër faktorët kryesorë përcaktues të inflacionit gjatë vitit 2022 rezultoi të ketë qenë përsheptimi i hovshëm i çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht i çmimeve të energjisë dhe ushqimit me fillimin e luftës në Ukrainë, rritje e cila u transmetua në Kosovë përmes kanaleve të importit të këtyre mallrave. Mesatarja vjetore e inflacionit në vitin 2022 rezultoi 11.6 përqind, nga 3.4 përqind në vitin paraprak. Marrë parasysh peshën e konsiderueshme të mallrave ushqimore dhe energjetike në shportën e konsumatorit në Kosovë (46.7 përqind, duke përfshirë edhe energjinë elektrike), nxitësit dominantë të përsheptimit të inflacionit në vitin 2022 ishin çmimet e përsheptuara të ushqimit dhe energjisë në tregjet ndërkombëtare që u përkthyen në çmime të ngritura të importit dhe rrjedhimisht konsumit.

Të hyrat buxhetore në vitin 2022 shënuan rritje vjetore prej 13.7 përqind, si rezultat i normës së lartë të inflacionit, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për formalizimin e ekonomisë. Edhe shpenzimet buxhetore shënuan rritje dyshifrore prej 10.5 përqind duke bërë që Buxheti i Kosovës të regjistrojë deficit primar buxhetor prej 0.1 përqind të BPV-së. Borxhi publik arriti në rreth 1.8 miliard euro që është për 4.2 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2021. Përkundër rritjes në terma absolutë, si përqindje e BPV-së borxhi publik ra në 20.7 përqind nga 21.5 përqind sa ishte në vitin 2021.

Në vitin 2022, sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, përderisa pozicioni i llogarisë financiare u përmirësua. Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti vlerën prej 940.3 milionë euro në vitin 2022, një rritje vjetore prej 35.4 përqind dhe një pjesëmarrje prej 10.5 përqind në BPV-në e gjeneruar në vend (8.7 përqind në vitin 2021). Llogaria rrjedhëse dhe kapitale shënoi rritje të deficitit, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të mallrave dhe rënies së bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Në të njëjtën periudhë, bilanci pozitiv i llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave dytësore u karakterizua me rritje. Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte shënuan rritje vjetore prej 85.0 përqind dhe arritën vlerën prej 778.2 milionë euro. Sektori i patundshmërisë përbën 67.3 përqind të gjithsej IHD-ve apo 523.7 milionë euro dhe në vitin 2022 shënoi rritje vjetore prej 36.4 përqind. Ndërkohë që vlera e remitencave të pranuar në vitin 2022 ka arritur në 1.22 miliard euro, rritje prej 6.0 përqind krahasuar me vitin paraprak (13.7 përqind e BPV-së).

Sistemi financiar shënoi rritje të konsiderueshme të aktivitetit gjatë vitit 2022, përkundër rritjes së lartë të inflacionit, shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, si dhe luhatshmërive të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, rritja ishte më e ngadalësuar se vitin paraprak, si pasojë e ngadalësimit të theksuar të rritjes së aseteve të sektorit pensional.

Gjithsej vlera e aseteve të sistemit financiar arriti në 9.89 miliardë euro në dhjetor 2022, që përkon me rritje vjetore prej 10.7 përqind, përkatësisht 2.0 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend.

Asetet e sektorit bankar në vitin 2022 arritën vlerën 6.76 miliardë euro, që përkon me rritje të përsheptuar vjetore prej 13.4 përqind krahasuar me rritjen 11.3 përqind në vitin paraprak. Kontributin kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit, i cili shënoi rritjen vjetore më të lartë në njëmbëdhjetë vitet e fundit.

Portofoli kreditor i sektorit bankar u zgjerua për 16.0 përqind në vitin 2022, duke arritur vlerën prej 4.35 miliardë euro. Rritja vjetore e stokut të kredive paraqet rritjen më të lartë në 11 vitet e fundit. Faktorët me kontribut pozitiv në rritjen e aktivitetit kreditues ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, rritja e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga Fondi

Kosovar për Garanci Kreditorë. Ndërsa faktorët me kontribut negativ ishin rreziqet e shtuara në lidhje me perspektivën ekonomike dhe tregjet globale dhe reflektimi i tyre në përkeqësim të portofolit kreditor.

Në të njëjtën periudhë, depozitat në sektorin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 5.55 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore të përsheptuar prej 13.3 përqind (12.4 përqind në vitin 2021). Depozitat e ekonomive familjare, kategoria që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar, ngadalësuan rritjen në 8.2 përqind nga 14.6 përqind një vit më parë. Depozitat e ndërmarrjeve, shënuan rritje të ngjashme vjetore, përkatësisht ngadalësim të lehtë të shkallës së rritjes në 18.9 përqind nga 19.3 përqind në vitin 2021.

Treguesit e performancës dhe shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të qëndrojnë stabil, ku si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2022 zbriti në 2.0 përqind, për 0.3 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin paraprak. Njëkohësisht, raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione zbriti në nivel prej 149.8 përqind nga 151.9 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese krahasuar me rritjen e provizioneve.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Asetet e peshuara me rrezik shënuan rritje më të theksuar, si rezultat i rritjes së përsheptuar të kreditimit, në krahasim me rritjen më të ngadalësuar të kapitalit, dinamikë që u reflektua në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 15.5 përqind nga 16.4 përqind në vitin paraprak, megjithëse ky tregues qëndron mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ishte 36.5 përqind nga 37.2 përqind një vit më parë, por që mbetet lart mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

Sektori pensional në vitin 2022 u karakterizua me ngadalësim më të theksuar të rritjes së aseteve dhe rënie të vlerës së investimeve krahasuar me një vit më parë, si pasojë e zhvillimeve jo të favorshme makroekonomike që kanë afektuar njëkohësisht turbulencat e evidentuara në tregjet financiare. Vlera e aseteve të fondeve, që dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale me pjesëmarrje prej 99.6 përqind, arriti në 2.42 miliardë euro në fund të vitit 2022, e që përkon me një rritje të ngadalësuar vjetore prej 2.4 përqind (18.2 përqind një vit më parë). Rritja më e ngadalësuar ishte rrjedhojë e rënies së vlerës së kthimeve nga investimet, përderisa rritja e arkëtimeve prej kontributdhënësve ishte më e lartë se në vitin paraprak. Kthimi bruto kumulativ nga investimet përgjatë vitit 2022 pësoi rënie të vlerës duke zbritur në territorin negativ prej 119.7 milionë euro, krahasuar nga kthimet pozitive prej gjithsej 228.4 milionë euro një vit më parë.

Sektori i sigurimeve për të katërtin vit me radhë shënoi rritje vjetore dyshifrore të aseteve. Pavarësisht zgjerimit të sektorit, niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit është zgjeruar me ritëm më të ngadalësuar në këto katër vite. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren në Evropë, në 1.50 përqind (1.48 përqind në vitin 2021). Ngjashëm, i ulët mbetet edhe niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2022 shënoi vlerën prej 73.9 euro (64.8 euro në vitin 2021).

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në fund të vitit 2022. Vlera e gjithsej aseteve arriti në 269.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 12.1 përqind. Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 arriti në 134.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind (18.2 përqind në vitin 2021), derisa dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore për 5.4 përqind (24.4 përqind një vit më parë), duke arritur vlerën në 64.3 milionë euro në fund të vitit 2022 (61.0 milionë euro në vitin 2021).

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 2.1 milionë euro, performancë më e dobët kundrejt vitit të kaluar kur kishte shënuar fitim neto në vlerë prej 6.3 milionë euro. Zvogëlimi i fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve (ndikuar nga presionet inflacioniste në vitin 2022) dhe shpenzimeve administrative (kryesisht kompensimit për punëtor). Po ashtu, krahasuar me vitin e kaluar është evidentuar rritje e kategorisë së shpenzimeve për dëmet e ndodhura (vlerë dhe numër), e që është rezultat i rritjes së numrit dhe vlerës së primeve të shkruara.

Në vitin 2022, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën në 400.8 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 17.9 përqind. Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (71.5 përqind), pasuar nga lizingjet (18.4 përqind). Ndërsa, pjesa tjetër e aseteve (prej 10.1 përqind) përbëhet kryesisht nga paraja e gatshme në bankë dhe asetet tjera.

Vlera e stokut të kredive të lëshuara në vitin 2022 arriti në 286.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.8 përqind (rritje vjetore prej 17.1 përqind në vitin 2021), derisa aktiviteti i lizingut për të dytin vit me radhë shënoi rritje dyshifrore dhe arriti vlerën në 73.7 milionë euro në fund të vitit 2022.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2022 arriti të shënojë fitim neto në vlerë prej 17.2 milionë euro. Rritja më e theksuar e të hyrave (14.9 përqind) kundrejt nivelit të rritjes së shpenzimeve (12.0 përqind) të sektorit ka ndikuar që IFM/IFJB-të të realizojnë fitim më të lartë për 3.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Përderisa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2022 është rritur në 153.2 përqind (141.6 përqind në vitin 2021).

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2022 janë miratuar: rregulloret dhe udhëzimet lidhur me menaxhimin e likuiditetit në banka, përkatësisht treguesin e mbulueshmërisë së likuiditetit (LCR) dhe treguesin e financimit të qëndrueshëm neto (NSFR); rregullorja për qasje në llogaritë bazike dhe pagesave në shërbime, si dhe janë përpiluar një numër i drafteve të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e sektorit financiar. Përgjithësisht, gjatë vitit 2022, BQK ka vazhduar me rishikimin/plotësimin e kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, si dhe të siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime, me qëllim të përafrimit të legjislacionit tonë me standardet dhe praktikat më të mira të Evropës.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të mandatit të saj ligjor për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisve në funksion të mbikëqyrjes prudente, BQK-ja ka vazhduar me zbatimin e planit të ekzaminimeve të institucioneve financiare të licencuara, me anë të aplikimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

BQK luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë. Në këtë kontekst, në kuadër të procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave, gjatë vitit 2022 BQK ka shqyrtuar 873 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë), ku 518 ankesa kanë qenë të deponuara për banka, 87 për IMF dhe IFJB, 262 ankesa kanë qenë të deponuara për siguruesit, ndërsa 6 kanë qenë ankesa të tjera.

BQK-ja në kuadër të operacioneve të menaxhimit me para të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë vitit 2022 aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me para të gatshme shënuan një rritje grupore prej 28.2 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 26.9 përqind (shprehur në vëllim). Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2022, shënoi një rritje të moderuar prej 1.5 përqind krahasuar me vitin 2021. Struktura e

parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, pati një ndryshim të vogël nga viti 2021 në vitin 2022.

Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN) i ndërtuar dhe nën administrimin e BQK-së, gjatë vitit 2022 ka siguruar disponueshmëri maksimale, duke garantuar procesimin dhe shlyerjen e pagesave për të gjithë akterët ekonomik të vendit. Sistemi i pagesave ndërbankare i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa. Treguesit statistikor të aktivitetit të SPN-së kanë reflektuar me një rritje të transaksioneve në vëllim për 19.2 përqind dhe në vlerë për 18.6 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku gjatë vitit 2022 janë procesuar 17.4 milionë transaksione me vlerë totale mbi 20 miliardë euro.

Numri i pagesave elektronike ka vijuar me rritje domethënëse edhe gjatë vitit 2022, ku pagesat përmes shërbimit e-banking u rriten për 16.5 përqind në vëllim dhe rreth 29.5 përqind në vlerë. Rritje të rëndësishme patën edhe pagesat me kartelë ku kishin një rritje për 41 përqind të vëllimit dhe 35.3 përqind të vlerës në krahasim me vitin paraprak.

Edhe në vitin 2022, prioritet i BQK-së për mjetet që ka nën menaxhim ishte siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet. Rezervat në portofolin e BQK-së përbëhen nga instrumentet e portofolit që klasifikohen si likuide dhe me gradë investuese. Kategorizimin likuid të rezervave e përbëjnë instrumentet që mirëmbahen për të siguruar mjete të mjaftueshme për kryerjen e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitorëve të saj. Nga ana tjetër kategorizimin investues e përmbushin instrumentet financiare të sigurta me vlerësim kreditor investiv që gjithashtu janë lehtësisht të tregtueshme.

Sikurse në vitin paraprak, BQK gjatë vitit 2022 ka vazhduar të jetë pjesë e linjës kreditore të ofruar nga Eurosistemi përmes Deutsche Bundesbank. Përmes kësaj linje kreditore, Banka Qendrore Evropiane i ka ofruar mundësinë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të marrë hua nga pakoja e likuiditetit të Eurosistemit kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga letra me vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Kjo linjë kreditore adreson nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave eventuale, duke i mundësuar hua deri në 100 milion euro nga Banka Qendrore Evropiane. Linja kreditore do të qëndrojë në fuqi deri në mes të muajit janar 2024, me mundësi të zgjatjes së afatit.

Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2022, ku janë regjistruar 493 përdorues të ri, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditorë arriti në 1,009,083 hulumtime.

Në funksion të realizimit të objektivit primar të saj, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes monitorimit të rregullt të rrezikut sistemik, ndër të tjera BQK bën identifikimin, monitorimin dhe analizimin e rrezikut sistemik në baza të rregullta tremujore. Në këtë kontekst, identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve ciklike dhe strukturore makroekonomike. Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre potencial në stabilitetin financiar dhe për pasojë stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, bëhet përmes analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative përfshirë analizimin e ecurisë së treguesve ekonomikë dhe financiarë me frekuencë të lartë, parashikimet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë dhe aplikimin e modeleve, që adresojnë dimensionin ciklik, strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik.

Përveç analizave të ndryshme periodike dhe monitorimit të rregullt të treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës të ekonomisë, BQK ka vazhduar të azhurnojë modelet e zhvilluara për vlerësimin e rreziqeve, si modelin e Hartës së Stabilitetit Financiar, modelin e stres-

testit, modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, si dhe modelin e Kapitalit Shtesë Kundërciklik). Në vitin 2022, në bashkëpunim me një asistencë të fokusuar teknike të FMN-së, BQK-ja ka filluar një proces tejet të rëndësishëm për të rishikuar dhe avancuar një ndër veglat më të rëndësishme, që ka një bankë qendrore për të vlerësuar stabilitetin e sektorit financiar – modelin e stres testit. Modeli që pritet të finalizohet gjatë vitit 2023 do të ndihmojë politikbërjen e BQK-së përmes rritjes së kapaciteteve për të vlerësuar dimensionet e rreziqeve që kanosin stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar publikimin e rregullt të statistikave për sektorin monetar dhe financiar, si dhe statistikave për sektorin e jashtëm, në harmoni me kalendarin e publikimeve.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Perspektiva ekonomike në eurozonë gjatë vitit 2022 u ndikua negativisht nga rritja e pasigurive gjeopolitike me fillimin e luftës në Ukrainë dhe presionet e rritura inflacioniste, presione që u pasuan me politika të shtrënguara monetare në gjysmën e dytë të vitit.

Bazuar në të dhënat preliminare nga Eurostat, aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2022 shënoi rritje reale prej 3.5 përqind, kundrejt rritjes prej 5.3 përqind në vitin paraprak (tabela 1). Në pjesën e parë të vitit, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kërkesa e brendshme si rezultat i rihapjes totale të ekonomive brenda eurozonës, ku u evidentua rritje e konsumit mbështetur nga pakot fiskale dhe kursimet private të akumuluar gjatë pandemisë, si dhe ngritje e aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve jo të tregtueshme përfshirë ato të turizmit. Ndërsa në tremujorin e fundit të vitit, ndonëse rritja ekonomike arriti të shmangë tkurrjen e parashikuar në raport me tremujorin paraprak, ajo u ngadalësua dukshëm në 0.1 përqind pas rënies së të hyrave reale të ekonomive familjare dhe rritjes së kostos së prodhimit për ndërmarrje që zbutën prodhimin dhe kërkesën e brendshme. Sidoqoftë, disa ekonomi të mëdha si Gjermania, Italia, Austria, varësisht edhe nga ekspozimi ndaj krizës energjetike dhe efektiviteti i politikave të ndërmarrja për t'u ballafaquar me përshpejtimin e çmimeve të energjisë, shënuan recesion krahasuar me tremujorin paraprak. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2022 u ndikua edhe nga përkeqësimi i kushteve të tregtisë për shkak të përshpejtimit të çmimeve të importit krahas çmimeve më të ulëta të eksportit në eurozonë.

Projeksionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) të dhjetorit për rritje ekonomike në vitin 2023 janë rishikuar për lart nga 0.5 përqind në dhjetor në 1.0 përqind në mars 2023, si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë së eurozonës kundrejt goditjeve nga ambienti i jashtëm. Por, përkundër që rritja ekonomike pritet të jetë më e lartë në dy vitet vijuese, gjegjësisht 1.6 përqind në 2024 dhe 2025 si rezultat i tregjeve solide të punës dhe përmirësimit të fuqisë blerëse dhe besueshmërisë së konsumatorëve, këto projeksione në krahasim me ato të dhjetorit mbeten më të ulëta si pasojë e shtrëngimit të kushteve të financimit të cilat pritet të ngadalësojnë aktivitetin ekonomik përgjatë dy viteve të ardhshme. Megjithatë, në periudhën afatmesme, përkundër shtrëngimit të kushteve të financimit, faktorë lehtësues ndaj rritjes ekonomike pritet të jenë ulja e pasigurive rreth tensioneve gjeopolitike, forcimi i kërkesës së jashtme, si dhe eliminimi i pengesave të mbetura në ofertë.

Ndërsa, në periudhë afatshkurtër rreziqet e ndërlidhura me projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë, vazhdojnë të anojnë nga kahu i poshtëm dhe përfshijnë ndër të tjera pasiguritë e ndërlidhura me luftën në Ukrainë, përshpejtimin potencial të çmimeve të ushqimit dhe energjisë, si dhe ngadalësimin potencial të aktivitetit ekonomik global përtej niveleve të parashikuara.

Tregu i qëndrueshëm i punës vazhdoi të mbështesë aktivitetin ekonomik në eurozonë, me normën vjetore të papunësisë që rezultoi 6.7 përqind në vitin 2022. Në përgjithësi, u rrit pjesëmarrja në tregun e punës dhe shkalla e punësimit, ndërsa numri i orëve të punës shënoi rënie krahasuar me nivelet para pandemisë. Të ngjashme ishin edhe dinamikat nga ana e kërkesës në tregun e punës e cila po ashtu shënoi rritje me normën mesatare të pozitive të lira të punës që arriti në 3.1 përqind në 2022 nga 2.3 përqind para pandemisë.

Tabela 1. Indikatorët bazë makroekonomikë në Eurozonë

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)				Papunësia (%)		
	2020	2021	2022	2023p	2020	2021	2022	2023p	2020	2021	2022
Eurozona	-6.1	5.3	3.5	1.0*	0.3	2.6	8.4	5.3*	8	7.7	6.7
Austria	-6.5	4.6	5	0.5	1.4	2.8	8.6	6.6	6	6.2	4.8
Franca	-7.8	6.8	2.6	0.6	0.5	2.1	5.9	5.2	8	7.9	7.3
Gjermania	-3.7	2.6	1.8	0.2	0.4	3.2	8.7	6.3	3.7	3.7	3.1
Greqia	-9	8.4	5.9	1.2	-1.3	0.6	9.3	4.5	17.6	14.7	12.5
Italia	-9	7	3.7	0.8	-0.1	1.9	8.7	6.1	9.3	9.5	8.1
Spanja	-11.3	5.5	5.5	1.4	-0.3	3	8.3	4.4	15.5	14.8	12.9


*Të dhënat janë sipas vlerësimeve dhe parashikimeve të BQE (Mars 2023) dhe parashikimet për vitin 2023 për vendet e eurozonës janë bazuar në të dhënat e KE (Shkurt 2023).

Burimi: Eurostat, BQE (Mars 2023), Komisioni Evropian (Shkurt 2023)

Inflacioni në eurozonë në vitin 2022 vazhdoi të ndikohet nga një kombinim faktorësh që intensifikuan presionet inflacioniste nga gjysma e dytë e vitit 2021 si rritja e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, pengesat në zinxhirët e furnizimit nga pandemia dhe rimëkëmbja e hovshme e aktivitetit ekonomik pas largimit të masave kufizuese. Për më shumë, fillimi i luftës në Ukrainë, që rezultoi në reduktimin e furnizimit të Evropës me gaz natyror dhe mallra të tjera nga Rusia dhe Ukraina, shtoi presione të mëtejshme në çmimet e energjisë dhe ushqimit në eurozonë që u kthyen në përcaktuesit kryesorë të inflacionit me rritje mesatare vjetore prej 37.0 dhe 9.0 përqind respektivisht.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë rezultoi 8.4 përqind në vitin 2022 krahasuar me 2.6 përqind në 2021, duke arritur nivelin më të lartë në muajin tetor kur shënoi rritje dyshifrore (10.6 përqind) (grafik 1). Kontributi kryesor në inflacionin në eurozonë erdhi nga çmimet e larta të energjisë dhe ushqimit me 3.8 dhe 1.9 pikë përqindje respektivisht, ndërsa përgjatë vitit u evidentua edhe rritje e kontributit të mallrave industriale joenergjetike (me kontribut mesatar vjetor prej 1.2 pikë përqindje) dhe e shërbimeve (1.5 pikë përqindje). Në tremujorin e fundit u shënuar rënie e kontributit të inflacionit të energjisë që erdhi si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, inflacioni i ushqimit vazhdoi të përshpejtohet sidomos për mallrat e përpunuara ushqimore. Përveç efekteve direkte dhe indirekte të rritjes së kostos së energjisë, inflacioni gjatë vitit 2022 u nxit pjesërisht edhe nga zhvlerësimi i monedhës së euros.

Grafik 1. Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore



Burimi: Eurostat (2023)

Projeksionet e BQE-së për inflacion në vitin 2023 janë rishikuar për poshtë nga 6.3 përqind në dhjetor në 5.3 përqind në projeksionet e marsit, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë, lehtësimit të pengesave në zinxhirët e furnizimit, vlerësimit të euros, si dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik. Përderisa politikat e ndërmarrja fiskale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe ndërmarrjeve nga inflacioni pritet të zbusin presionet inflacioniste në vitin 2023, ndikimi pritet të jetë i kundërt në vitin 2024 kur pothuajse të gjitha këto masa pritet të ndërpriten. Projeksionet për inflacion në vitet 2024 dhe 2025 sugjerojnë për një normë prej 2.9 respektivisht 2.1 përqind, bazuar në supozimet për stabilizim të çmimeve të energjisë dhe ushqimit gjatë periudhës së projeksioneve, projeksione më të ulëta të aktivitetit ekonomik, si dhe në efektin gradual të shtrëngimit të kushteve të financimit nga politika monetare e BQE-së.

Në përpjekje për të kthyer inflacionin brenda objektivit prej 2.0 përqind BQE ndërmori një sërë masash gjatë vitit 2022. Blerjet e aseteve në kuadër të programit pandemik për blerje emergjente u ndërpre në mars 2022, ndërsa BQE vazhdon riinvestimin e pagesave të kryegjësë nga letrat me vlerë në kuadër të këtij programi deri në fund të vitit 2024. Këshilli Drejtues i BQE-së po ashtu vendosi të zvogëlojë shumën e blerjes së aseteve neto në 20 miliardë në qershor dhe ndërpreu blerjet në kuadër të këtij programi në korrik 2022, duke vazhduar riinvestimin e pjesës së pagesave të kryegjësë nga letrat me vlerë në kuadër të këtij programi deri në korrik 2023 për t'i lehtësuar kushtet e likuiditetit. Ndërsa, nga muaji korrik 2022 BQE filloi me rritjen e tri normave kyçe të interesit të BQE-së: normën e depozitave (-0.5 përqind në shtator 2019 në 2.0 përqind në dhjetor 2022), normën e operacioneve të rifinancimit (0.0 përqind në shtator 2019 në 2.5 përqind në dhjetor 2022) dhe normën marginale për huadhënie (0.25 përqind në 2.75 përqind). Këto vendime të BQE-së për shtrëngim të kushteve të financimit u përkthyen në rritje të normave të interesit dhe rrjedhimisht në rritje më të ngadalshme të kreditimit ndaj sektorit privat (nga 6.3 përqind rritje vjetore në qershor në 5.4 përqind në dhjetor 2022), ndonëse me rritje gjatë muajve gusht dhe shtator si rezultat i dinamikave pozitive në aktivitetin ekonomik gjatë tremujorit të tretë. Me ngadalësim të rritjes së kreditimit u karakterizua edhe segmenti i ekonomive familjare, nga 4.6 përqind në qershor në 3.8 përqind në dhjetor.

2.2. Ballkani Perëndimor


Ngjashëm me eurozonën edhe Ballkani Perëndimor u përball me rritje të ngadalësuar ekonomike në vitin 2022 kundrejt vitit paraprak. Në vitin 2022, rritja mesatare e BPV-së reale në rajon ishte 3.8 përqind, me rritjen më të lartë të shënuar në Mal të Zi prej 6.6 përqind, e mbështetur nga performanca e mirë gjatë sezonit turistik dhe rritjen më të ulët të shënuar në Maqedoninë e Veriut prej 2.0 përqind, ndikuar nga çmimet e larta të energjisë dhe ushqimit.

Projeksionet e FMN-së për vitin 2023

sugjerojnë se rajoni pritet të karakterizohet me një rritje reale të BPV-së prej 2.4 përqind. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë, partneri kryesor tregtar dhe burim i rëndësishëm për investime dhe remitencat pritet të jetë faktor përcaktues në dinamikat e përgjithshme ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Performanca ekonomike e gjashtë vendeve vazhdon të jetë e prekur nga kriza e çmimeve të ushqimit dhe energjisë. Eksporti nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka filluar të ngadalësohet dhe kostoja e importit është rritur ndjeshëm për shkak të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, e që paraqet rrezik për përkeqësim të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vendet e rajonit shënuan rritje të konsumit privat, e ndikuar kryesisht nga rritja e pagave, remitencat dhe kreditimi privat.

Norma mesatare e inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor ka arritur në 11.6 përqind rritje vjetore, ku më e larta u shënuar në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnje dhe Hercegovinë me 14.0 përqind, ndërsa Shqipëria me shkallën më të ulët të inflacionit me 6.6 përqind. Kundrejt inflacionit bankat qendrore nga vendet e rajonit të cilat kanë valutat e tyre kanë rritur normën bazë të interesit. Shqipëria ka rritur normën bazë prej 2.75 pikë përqind që nga fillimi i luftës në Ukrainë (rritja e fundit në nëntor 2022, 0.5 pikë). Në fund të vitit 2022, Maqedonia e Veriut vendosi të rrisë normën e interesit me 0.5 pikë duke arritur nivelin në 4.75 pikë përqind. Ndërsa të dhënat e fundit nga banka qendrore e Serbisë treguan që norma e interesit është rritur në 5.5 pikë përqind.

Grafik 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Eurostat, dhe Agjencitë Statistike të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2023).

*Projeksionet e FMN-së (WEO Prill 2023).

Tabela 2. Të dhënat mbi treguesit makroekonomik dhe bankarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)				Balanci i llogarisë rrjedhëse (% e BPV)*				Rritja e kreditimit (%)!				Kreditë jo-performuese (%)!				Papunësia (%)*			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
Kosova	4.8	(5.3)	10.7	3.5	2.7	0.2	3.4	11.6	(5.7)	(7.0)	(8.8)	(10.5)	10.0	7.1	15.5	16.1	2.0	2.7	2.3	2.0	25.7	26.0	20.8	n/a
Maqedonia e Veriut	3.9	(4.7)	3.9	2.0	0.7	1.2	3.4	14.0	(3.0)	(2.9)	(3.1)	(6.0)	5.7	4.8	8.4	10.0	4.6	3.3	3.1	2.8	17.3	16.4	15.7	14.5
Mali i Zi	4.1	(15.3)	13.0	6.6	0.5	(0.5)	2.5	11.9	(14.3)	(26.1)	(9.2)	(13.3)	4.5	3.2	6.4	8.9	5.1	5.9	6.8	6.3	15.1	17.9	24.7	n/a
Shqipëria	2.1	(3.5)	8.9	4.2	1.7	2.2	2.3	6.6	(7.6)	(8.7)	(7.7)	(7.8)	(0.8)	5.8	10.3	6.5	8.4	8.1	5.7	5.0	11.5	11.7	11.4	11.1
Bosnja dhe Hercegovina	2.9	(3.0)	7.4	4.0	0.6	(1.1)	2.0	14.0	(2.6)	(3.3)	(2.4)	(3.8)	6.6	(2.0)	3.0	4.4	6.5	6.1	5.6	4.5	15.7	15.9	17.4	17.3
Serbia	4.3	(0.9)	7.5	2.3	1.9	1.8	4.0	11.7	(6.9)	(4.1)	(4.3)	(6.9)	8.1	14.5	8.3	4.5	4.1	3.7	3.6	3.0	11.2	9.7	11.0	9.4

* IMF (WEO) Prill 2023

! Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse

Burimi: IMF (WEO) tetor 2021

Kreditimi shënoi rritje në pothuajse të gjitha vendet e rajonit prej mesatarisht 4.2 përqind. Norma më e lartë e rritjes së kreditimit u shënua në sektorin bankar të Kosovës me 16.1 përqind, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut 11.6 përqind dhe Mali i Zi 9.0 përqind. Ekonomia e Kosovës vazhdon ta mbajë shkallën më të ulët të kredive joperformuese prej 2.0 përqind, ndërsa Mali i Zi raporton nivelin më të lartë të kredive joperformuese prej 6.7 përqind, pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina me 5.2 përqind. Depozitat kanë shënuar rritje në të gjitha vendet e rajonit: më e larta në Mal të Zi (24.4 përqind), Kosovë (13.3 përqind), Serbi (7.0 përqind) dhe në Shqipëri (5.9 përqind). Shtrëngimi i politikave monetare pritet të reflektohet në kosto më të lartë për financim dhe për pasojë, në ngadalësim të kërkesës për kredi dhe rritje të kostonë së financimit për sektorin bankar.

Rritja e normave bazë të interesit nga BQE ka ndikuar në rivlerësimin e monedhës së euros kundrejt valutave të partnerëve kryesorë tregtarë veçanërisht në pjesën e dytë të vitit 2022, efekti i rivlerësimit pritet të ketë më shumë efekt në vitin e ardhshëm. Në tregun e këmbimit valutor, euro u zhvlerësua përgjatë vitit 2022 kundrejt, frangut zviceran me 7.0 përqind, lekut shqiptar prej 2.8 përqind dhe dollarit amerikan me 10.9 përqind.


3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

3.1.1 Bruto Prodhimi Vendor

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve të ASK-së, shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022 (grafik 3). Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vitin 2022 iu atribuua kryesisht rritjes së përgjithshme të çmimeve, që ndikoi negativisht në kërkesën e përgjithshme dhe për pasojë aktivitetin ekonomik. Kërkesa e brendshme kontribuoi pozitivisht në rritjen reale të BPV-së me vetëm 1.0 pikë përqindje (11.0 pikë përqindje në vitin 2021), ndërkaq kontributi i neto eksporteve ishte pozitiv me 2.6 pikë përqindje (-0.3 pikë përqindje në vitin 2021).

Grafik 3. Norma e rritjes së BPV-së reale



Burimi: ASK (2023)

Konsumi si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme kontribuoi me 3.2 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së në vitin 2022 (7.5 pikë përqindje në vitin 2021). Ngadalësimi i evidentuar në rritjen e konsumit kryesisht i është atribuar dobësimit të fuqisë blerëse si pasojë e rritjes së përgjithshme të çmimeve përgjatë gjithë vitit, si dhe ngadalësimit të rritjes së burimeve të financimit të konsumit, si: remitanca, kredive konsumuese, konsumit publik, etj. Për dallim nga konsumi, investimet kontribuuan negativisht në rritjen reale të BPV-së me 2.2 pikë përqindje, kryesisht si pasojë e rënies së shpenzimeve kapitale publike, si dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në sektorin e ndërtimit.

Sa i përket eksporteve neto, dinamikat që e kanë karakterizuar sektorin e jashtëm të ekonomisë, veçanërisht bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, kanë ndikuar që eksportet neto të kenë një kontribut pozitiv prej 2.6 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi me 5.7 pikë përqindje, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi negativisht në normën reale të BPV-së me 3.2 pikë përqindje. Rritja e vizitave të diasporës në Kosovë ka rezultuar në rritjen reale të eksportit të shërbimeve për 17.9 përqind. Edhe eksporti i mallrave ka shënuar rritje reale prej 15.5 përqind në vitin 2022. Në anën tjetër, si rezultat i rritjes së çmimeve që ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së kërkesës vendore, importi i mallrave ka shënuar rritje reale të ngadalësuar prej 2.0 përqind dhe kjo ka reflektuar në zvogëlimin e deficitit të mallrave dhe shërbimeve për 8.0 përqind në terma realë.

Rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2022 është mbështetur kryesisht nga industria përpunuese (8.7 përqind), aktivitetet financiare dhe të sigurimit (7.6 përqind), tregtia (7.6 përqind), transporti dhe magazinimi (5.6 përqind), etj. Ndërsa, rënie prej 7.9 përqind vlerësohet se ka shënuar sektori i ndërtimit, kryesisht si rezultat i rritjes së kostos së ndërtimit.

3.1.2 Çmimet

Çmimet në vitin 2022 vazhduan të diktohen kryesisht nga faktorë të jashtëm që përcaktuan trajektoren e inflacionit nga gjysma e dytë e vitit paraprak, që përfshijnë rritjen e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, pengesat në zinxhirët e furnizimit të shkaktuara nga pandemia dhe rritjen e hovshme të kërkesës së përgjithshme. Një ndër faktorët kryesorë


përcaktues të inflacionit gjatë vitit 2022 rezultoi të ketë qenë përshpejtimi i hovshëm i çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht i çmimeve të energjisë dhe ushqimit me fillimin e luftës në Ukrainë, rritje e cila u transmetua në Kosovë përmes kanaleve të importit të këtyre mallrave. Po ashtu, inflacioni u përshpejtua edhe nga presione të brendshme inflacioniste të nxitura nga kërkesa e brendshme që u ndjenë më së shumti në tremujorin e parë të vitit, si dhe në shkallë më të madhe nga rëndimi i presioneve globale inflacioniste në sektorë të ndryshëm të prodhimit të brendshëm.

Mesatarja vjetore e inflacionit në vitin 2022 rezultoi 11.6 përqind, nga 3.4 përqind në vitin paraprak. Marrë parasysh peshën e konsiderueshme të mallrave ushqimore dhe energjetike në shportën e konsumatorit në Kosovë (46.7 përqind, duke përfshirë edhe energjinë elektrike), nxitësit dominantë të përshpejtitimit të inflacionit në vitin 2022 ishin çmimet e përshpejtuara të ushqimit dhe energjisë në tregjet ndërkombëtare që u përkthyen në çmime të ngritura të importit dhe rrjedhimisht konsumit. Trajektorja e inflacionit tregon IÇK-në të ketë arritur pikun në TM3 2022 kur shënoi rritje vjetore prej 13.3 përqind, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit 2022 shfaqti ngadalësim të inflacionit në 12.1 përqind, që i atribuohet reduktimit të pengesave në zinxhirët e furnizimit dhe rënies së çmimit të energjisë.

Çmimet e mallrave ushqimore, që përbënë 33.7 përqind të shportës së konsumit në 2022, shënuan rritje mesatare vjetore prej 17.9 përqind, me normën vjetore të inflacionit që rezultoi 19.4 përqind në dhjetor 2022 kundrejt 8.9 përqind në dhjetor të vitit paraprak. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritje e dukshme u shënuan në çmimet e vajrave dhe yndyrave me rritje mesatare vjetore prej 44.3 përqind, bukës dhe drithërave (25.3 përqind), qumështit, djathit dhe vezëve (21.9 përqind), mishit (17.3 përqind), e të tjera. Në përgjithësi me përjashtim të frutave që shënuan rënie të çmimeve prej 5.1 përqind, të gjitha mallrat ushqimore në shportën e konsumit shënuan rritje mesatare vjetore të çmimeve më të lartë se 6.0 përqind.

Ngjashëm, çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse në kuadër të kategorisë së strehimit shënuan rritje vjetore prej 17.2 përqind, që përbën rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak kur kjo kategori shënoi rritje prej vetëm 0.6 përqind (grafik 4). Ndërsa, çmimet e transportit shënuan rritje mesatare vjetore prej 16.9 përqind, me kategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rritje të lartë të çmimeve prej 26.3 përqind, e cila pastaj u përkthye në rritjen e çmimit të shërbimeve të transportit që rezultoi 13.6 përqind.

Grafik 4. Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore



Burimi: ASK (2023)

Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit ishte 6.2 pikë përqindje, me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të bukës dhe drithërave prej 2.3 pikë përqindje, mishit prej 1.6 pikë përqindje kurse qumështit, djathit dhe vezëve prej 1.3 pikë përqindje. Ndërsa, sa i përket transportit, kontributi i kësaj kategorie në gjithsej inflacionin e përgjithshëm në vitin 2022 ishte 2.7 pikë përqindje, e që u gjenerua kryesisht nga nënkategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal ku përfshihet pjesa më e madhe e karburanteve me kontribut prej 2.1 pikë përqindje.

Intensifikimi i presioneve të brendshme inflacioniste përgjatë vitit 2022 u pasqyrua në zgjerimin e bazës së inflacionit, ku 80.5 përqind e shportës së konsumit shënoi rritje mesatare vjetore mbi 5.0 përqind. Ky zhvillim u nxit fillimisht nga vazhdimi i rritjes së kërkesës së brendshme në TM1

2022 kundrejt pengesave të vazhdueshme nga ana e ofertës, si dhe nga bartja e kostos së ngritur të prodhimit të brendshëm nga ndërmarrjet tek konsumatorët. Rrjedhimisht, viti 2022 u karakterizua me përshpejtim të çmimeve të mallrave tjera (përjashtuar ushqimin dhe energjinë) dhe shërbimeve. Kontributi nga sektori i mallrave tjera dhe shërbimeve në gjithsej inflacionin e përgjithshëm arriti në 1.1 pikë përqindje për secilën kategori në vitin 2022, nga 0.4 respektivisht 0.7 pikë përqindje në vitin 2021. Dinamikat e çmimeve të shërbimeve në veçanti të atyre jo të tregtueshme japin indikacione rreth trendit në rritje të inflacionit të brendshëm, ku u evidentua rritje e çmimeve të shërbimeve të transportit (13.6 përqind), hotelerisë (11.2 përqind) dhe kujdesit personal (rreth 7.0 përqind).


Forcimi i presioneve të brendshme inflacioniste u konfirmua edhe nga trajektorja e inflacionit bazë sipas metodës së përjashtimit të përhershëm të kategorive me lëkundje të shpeshta të çmimeve (ushqimi dhe pijet joalkoolike, pijet alkoolike dhe duhani, energjia elektrike dhe lëndët tjera djegëse dhe karburantet) (grafik 5). Në vitin 2022, inflacioni bazë shënoi rritje vjetore prej 4.9 përqind kundrejt 2.1 përqind në vitin 2021. Rritja e inflacionit bazë në vitin 2022 pasqyron rritjen e çmimeve të shërbimeve të transportit që shënuan kontribut prej 1.5 pikë përqindje në inflacionin bazë, orendive me kontribut prej 1.2 pikë përqindje ndërsa restoranteve dhe hoteleve prej 0.9 pikë përqindje.

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe norma e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që norma e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në vitin 2022, 10.1 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 1.5 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 6). Ngjashëm me inflacionin bazë, në terma mesatare vjetore edhe inflacioni i brendshëm

tregon për trend në rritje përgjatë vitit, duke ofruar sinjale rreth intensifikimit të inflacionit të gjeneruar në vend që po ashtu anon kryesisht nga inflacioni i shërbimeve.


Luhatjet e mëdha të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, të pasqyruara në Kosovë përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara, përmbledhen përmes indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili arriti në 18.9 përqind në vitin 2022 krahasuar me 11.1 përqind sa ishte në 2021. Çmimet e i) produkteve minerale, ii) artikujve të gurit, llaçit dhe produkteve të qeramikës dhe qelqit, si dhe iii) plastikës, kauçikut dhe artikujve të tyre, që paraqesin kategoritë më të mëdha në kuadër të IÇIMP, shënuan rritje mesatare vjetore prej 51.9 përqind, 36.8 përqind, respektivisht 18.9 përqind në vitin 2022. Në anën tjetër, nga gjysma e dytë e vitit vërehet

Grafik 5. Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2023)

Grafik 6. inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2023)

ngadalësim i rritjes së çmimeve të mallrave industriale të importuara, posaçërisht në çmimet e metaleve bazë dhe artikujve përkatës.

Rritje gjatë vitit 2022 shënoi edhe indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) i cili arriti në 9.4 përqind nga 4.9 përqind në 2021. Në kuadër të këtij indeksi, kategoritë me pjesëmarrjen më të lartë që përfshijnë i) energjinë elektrike, gazin, avullin dhe furnizimin me ajër të kondicionuar, ii) produktet minerale jometalike, dhe iii) përpunimin e produkteve ushqimore shënuan rritje mesatare prej 15.8 përqind, 6.9 përqind, dhe 13.2 përqind respektivisht. Ndërsa, rënie u shënuan në çmimet e nxjerrjes së xehes së metalit prej 16.1 përqind.

Ngjashëm rritje të lartë regjistroi edhe indeksi i kostos së ndërtimit (IKN) që rezultoi në mesatare vjetore prej 20.1 përqind kundrejt 12.2 përqind në vitin 2021. Pjesa më e madhe e inflacionit në këtë kategori i atribuohet çmimeve të ngritura të materialeve ndërtimore përfshirë ato elektrike dhe hidro-sanitare që shënuan rritje vjetore prej 22.6 përqind. Indeksi i përgjithshëm i kostos së ndërtimit shfaqë shenja ngadalësimi përgjatë vitit, sidoqoftë u evidentua rritje në çmimet e pagave (me rritje vjetore prej 9.1 përqind) dhe makinerive (13.0 përqind).

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2023 të ngadalësohet në 4.9 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë lehtësimet e mëtejshme të pengesave në zinxhirët e furnizimit, trendin zbritës të inflacionit të përgjithshëm në eurozonë, ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe në vend, e të tjera. Sidoqoftë, rreziqet e ndërlydhura me inflacionin vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit si pasojë e luftës në Ukrainë, rritja potenciale e çmimeve të energjisë, metaleve bazë dhe mallrave tjera nga rihapja e ekonomisë së Kinës, zhvendosja e pritjeve të konsumatorëve për inflacionin, presionet për rritje të pagave, e të tjera.

3.1.3 Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Sektori i tregtisë së bashku me sektorin e industrisë përbëjnë dy sektorët ekonomikë me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve, indekset e të cilave¹ kanë shënuar rritje gjatë vitit 2022. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë ka shënuar rritje mesatare prej 9.1 përqind në vitin 2022, ndërsa indeksi i vëllimit të prodhimit industrial ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.3 përqind.

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, në vitin 2022 janë regjistruar më shumë

ndërmarrje të reja si dhe janë mbyllur më shumë ndërmarrje. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 11,024 apo 3.5 përqind më shumë sesa në vitin 2021, ndërsa u mbyllën 1,784 ndërmarrje apo 10.9 përqind më shumë sesa në vitin 2021 (grafik 7).

Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 23.6 përqind të gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara, pasuar nga sektori i

Grafik 7. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2023)

¹ Publikim i ASK-së: Raporti 'Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë, Nëntor 2022', dhe 'Statistikat Afatshkurtra të Industrisë, Nëntor 2022'.

shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (rreth 40.1 përqind), ndërsa më e ulët për personat që kishin të përfunduar arsimin terciar (15.5 përqind).

3.2. Sektori fiskal

Të hyrat buxhetore⁵ në vitin 2022 arritën vlerën neto prej 2.48 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.7 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte si rezultat i normës së lartë të inflacionit, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për formalizimin e ekonomisë. Edhe shpenzimet buxhetore⁶ shënuan rritje dyshifrore prej 10.5 përqind dhe arritën vlerën prej 2.49 miliardë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 0.1 përqind të BPV-së (0.9 përqind e BPV-së ishte deficitin primar buxhetor në vitin 2021).

Në kuadër të të hyrave tatimore, të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje. Rritja më e lartë është shënuar te të hyrat tatimore direkte, të cilat arritën vlerën prej 413.8 milionë euro apo 20.9 përqind më shumë krahasuar me vitin 2021. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 12.3 përqind dhe arritën vlerën 1.87 miliardë euro. Të hyrat jotatimore shënuan rritje prej 13.0 përqind dhe arritën vlerën 266.8 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, kategoria që shënoi rritje më të lartë ishte ajo e shpenzimeve rrjedhëse të cilat shënuan rritje prej 13.0 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rënie të lehtë prej 0.1 përqind. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 26.3 përqind dhe arritën vlerën prej 1.06 miliardë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rritje për 9.7 përqind dhe arritën vlerën 359.3 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për paga shënuan rënie për 2.2 përqind dhe arritën vlerën prej 652.6 milionë euro.

Borxhi publik në vitin 2022 ka arritur në rreth 1.8 miliardë euro që është për 4.2 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2021. Përkundër rritjes në terma absolutë, si përqindje e BPV-së borxhi publik ra në 20.7 përqind nga 21.5 përqind sa ishte në vitin 2021. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit ndërkombëtar prej 11.2 përqind (i cili ka arritur në 641.2 milionë euro), si dhe rritjes së lehtë të borxhit të brendshëm prej 0.5 përqind. Borxhi ndërkombëtar publik ka arritur nivelin prej 641.2 milionë euro apo 36.6 përqind e gjithsej borxhit publik. Në vitin parapandemik 2019, niveli i borxhit publik ndaj BPV-së ishte 17.6 përqind, kundrejt një mesatare katërvjeçare prej 15.1 përqind. Borxhit publik pas përhapjes së pandemisë është rritur me ritëm më të lartë, dinamikë që i atribuohet kryesisht rritjes së nevojave për të financuar bizneset dhe ndihmuar ekonominë familjare për tejkalim të krizës shëndetësore dhe ekonomike, ndërsa në vitin 2022 është rritur me ritëm më të ngadalësuar për shkak të rritjes së likuiditetit të Qeverisë.

Në vitin 2022, shuma e shpallur në ankande arriti vlerën prej 245.0 milionë euro që është për 26.9 përqind më pak krahasuar me vitin 2021, përderisa shuma e pranuar ishte 223.7 milionë euro apo 27.1 përqind më pak krahasuar me vitin 2021. Edhe kërkesa për të investuar në bono dhe obligacione qeveritare ishte më e ulët për 37.7 përqind, ndërkohë që norma mesatare e interesit në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rritje duke arritur në 2.81 përqind krahasuar me 2.07 përqind sa ishte në vitin 2021. Rritja e normës së interesit ndërlidhet me vazhdimin e rritjes së pjesëmarrjes së letrave me vlerë afatgjatë. Përderisa në të kaluarën struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës dominohej nga bonot e Thesarit me afat maturimi më të shkurtër, në vitin 2022 kategoria kryesore ishte ajo e obligacioneve me afat maturimi prej mbi pesë vitesh.

⁵ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të pranimit nga financimi, si dhe pranimit nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

⁶ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim, si dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

3.3. Sektori i jashtëm


Në vitin 2022, sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të pozicionit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, përderisa në të njëjtën periudhë, pozicioni i llogarisë financiare u përmirësua. Llogaria rrjedhëse dhe kapitale shënoi rritje të deficitit, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Në të njëjtën periudhë, bilanci pozitiv i llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave dytësore u karakterizua me rritje.

Llogaria e mallrave, si një ndër kategoritë përcaktuese të dinamikave në llogarinë rrjedhëse, shënoi rritje vjetore prej 20.2 përqind dhe mbylli vitin me deficit tregtar prej 4.3 miliardë euro. Efekt negativ në bilancin e llogarisë rrjedhëse rezultoi në këtë pasur edhe llogaria e të ardhurave parësore, që u zvogëlua për 40.5 përqind dhe shënoi vlerën prej 90.1 milionë euro në vitin 2022. Në të njëjtën kohë, rritja e bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve për 32.9 përqind në 1.4 miliardë euro dhe bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave dytësore për 11.6 përqind në 1.9 miliardë euro, zbuten deri në një masë ndikimin negativ të dinamikave në tregtinë e mallrave. Megjithatë, deficitin e llogarisë rrjedhëse arriti vlerën prej 940.3 milionë euro në vitin 2022, një rritje vjetore prej 35.4 përqind dhe një pjesëmarrje prej 10.5 përqind në BPV-në e gjeneruar në vend (8.7 përqind në vitin 2021).

Eksporti i mallrave në vitin 2022 shënoi rritje vjetore prej 21.7 përqind dhe arriti vlerën prej 920.4 milionë euro (grafik 9). Kjo rritje kryesisht iu atribuua kryesisht rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe rritjes së sasisë së eksportuar (vetëm sasia e mallrave të eksportuara shënoi rritje prej 8.3 përqind). Struktura e eksporteve sipas kategorive mbeti e pandryshuar, ku kategoria e metaleve bazë shënoi rritjen më të lartë, e ndjekur nga kategoria e plastikës, gomës dhe artikujve tjerë


relevant dhe produktet minerale. Partnerët kryesorë në vitin 2022 për eksportin e mallrave janë vendet e BE-së me 33.9 përqind dhe vendet e Ballkanit Perëndimor me 36.2 përqind të gjithëj eksportit të mallrave. Të dhënat nga Dogana e Kosovës ilustruan se në vitin 2022, struktura e mallrave të eksportuara nga Kosova mbeti relativisht e koncentruar në dy kategori më të rëndësishme: dyshekë dhe artikuj prej tyre në vlerë prej 129.2 milionë euro (14.0 përqind e eksportit të përgjithshëm), të eksportuara kryesisht në tregun amerikan, dyer dhe dritare në vlerë prej 65.5 milionë euro (7.0 përqind e gjithëj eksporteve) dhe energji elektrike në vlerë prej 63.2 milionë euro (6.8 përqind), kryesisht për tregun e BE-së. Ndërkohë që struktura e mallrave të eksportuara mbeti e koncentruar, gjeografikisht, Kosova rezultoi në këtë rritur shtrirjen në tregje të reja: nga 127 shtete ku eksportohej në vitin 2021, tashmë Kosova eksporton në 140 shtete.

Grafik 9. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar



Burimi: ASK (2023)


Grafik 10. Struktura e eksporteve sipas kategorive



Burimi: BQK (2023)

Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 5.6 miliardë euro (63.0 përqind e BPV-së), një rritje vjetore prej 20.4 përqind. Rritja e shënuar në mallrat e importuara gjatë vitit 2022 kryesisht i është atribuar rritjes së lart që karakterizoi çmimet e importit përgjatë vitit, ndërkohë që sasia e importuar dhe pesha e përgjithshme e mallrave të importuara rezultojnë të ketë shënuar rënie për 0.3 respektivisht 14.5 përqind – në linjë me dinamikat në kërkesën e përgjithshme në vend. Struktura e kategorive të mallrave të importuara

Grafik 11. Struktura e importeve sipas kategorive



Burimi: BQK (2023)

mbeti e pa ndryshuar, me produktet minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake që dominuan pjesëmarrjen. Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale prej 9.5 përqind mbetet e ulët, megjithëse në 2022 u karakterizuan me një rritje vjetore prej 5.8 përqind. Rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e aktivitetit të shënuar në sektorin e industrisë përpunuese dhe transportit, përkthyer edhe në rritje të vlerës së shtuar në BPV nga këta dy sektorë, mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së importit të mallrave të ndërmjetme, kategori që shënoi rritje prej 30.7 përqind. Ndërkohë që vlera e importit të mallrave të konsumit gjatë kësaj periudhe është rritur për 15.3 përqind. Mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të strukturës së gjithsej mallrave të importuara në vend (52.9 përqind), përderisa mallrat për konsum kanë një pjesëmarrje prej rreth 30.8 përqind. Për dallim prej viteve të kaluara, në vitin 2022 është shënuar rënie e sasisë e importit të auto veturave dizel me 25.0 përqind, naftës dhe benzinës me 6.4 dhe 5.2 përqind. Importi i mallrave vazhdon të ruaj strukturën gjeografike të njëjtë. Rreth 42.3 përqind e importeve të mallrave ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian, 25.5 përqind, ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania me 10.8 përqind të gjithsej importeve. Ndërkohë, jashtë Bashkimit Evropian, Kosova vazhdon të importojë mallra nga Turqia (842.9 milionë euro apo 14.9 përqind e gjithsej importeve), e ndjekur nga Kina (548.6 milionë euro përkatësisht 9.7 përqind gjithsej importet).

Tregtia në shërbime u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv në vitin 2022, komponentë që arriti vlerën prej 1.3 miliard euro. Kontribut kryesor në rritjen e eksportit të shërbimeve kishte kategoria e udhëtimeve, që u karakterizua me rritje prej 25.8 përqind dhe arriti në 1.87 miliard euro. Dinamikat në këtë kategori kryesisht reflektojnë shpenzimet e diasporës në Kosovë (1.02 miliard euro gjatë muajve qershor-shtator), por edhe rritja e numrit të udhëtarëve me 37.3 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak (të dhënat nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës). Rritje vjetore të theksuar rezultojnë të ketë shënuar kategoria e shërbimeve kompjuterike me vlerë prej 210.1 milionë euro (98.8 milionë euro në 2021), e ndikuar nga rritja e kërkesës së jashtme për këto shërbime. Në anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve iu atribuua rritjes së komponentës së udhëtimit dhe transportit për 30.4 përkatësisht 39.1 përqind, dinamikë kryesisht e ndikuar nga çmimet e rritura të produkteve minerale në tregjet ndërkombëtare.


Bilanci i të ardhurave parësore shënoi rënie prej 40.5 përqind, duke arritur vlerën prej 90.1 milionë euro (151.4 milionë euro 2021). Rënia e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga bilanci i investimeve direkte, si pasojë e kthimit të dividendës në vlerë prej 218.0 milionë euro (107.3 milionë euro në vitin 2021). Ndërsa, bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve ka shënuar rritje prej 8.7 përqind, e ndikuar nga rritja e të hyrave nga punëtorët rezidentë jashtë vendit.

Në kuadër të të hyrave dytësore në bilancin e pagesave, vlera e remitencave të pranuar në vitin 2022 ka arritur në 1.22 miliard euro, rritje prej 6.0 përqind krahasuar me vitin paraprak (13.7 përqind e BPV-së). Rritja më e ngadalësuar e remitencave të pranuar në vend, kundrejt viteve paraprake, mund të jetë pasojë e dobësimit të pozicionit financiar të diasporës kosovare, veçanërisht në vendet e BE-së, si pasojë e keqësimit të dinamikave makroekonomike me rritjen e çmimeve të përgjithshme përgjatë vitit 2022.

Struktura sipas shteteve mbetet e pandryshuar: Gjermania (40.4 përqind e remitencave të dërguara), Zvicra (19.3 përqind) dhe SHBA (8.4 përqind). Dërgesat e emigrantëve sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje në vlerë prej 66.2 milionë euro, ndërsa është shënuar rënie e lehtë e dërgesave në kanale joformale. Duke konsideruar që pjesa më e madhe e remitencave janë nga vendet e eurozonës (60.2 përqind), pasiguritë që shoqërojnë pritjet rreth dinamikave të përgjithshme makroekonomike në vitin 2023, mund të përkthehen në zvogëlim të këtij burimi të rëndësishëm financues për ekonominë e vendit.


Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte rezultojnë të kenë shënuar rritje vjetore prej 85.0 përqind dhe të kenë arritur vlerën prej 778.2 milionë euro. Rritja e IHD-ve në Kosovë, në vitin 2022 është evidentuar kryesisht në sektorët patundshmërisë, xehetaria përfshirë guroret dhe ndërtimtaria, njëkohësisht, sektor që edhe kanë pjesëmarrjen më të lartë në portofolin e përgjithshëm të këtyre investimeve. Sektori i patundshmërisë mbulon 67.3 përqind e përgjithshme të IHD-ve apo 523.7 milionë euro dhe në vitin 2022 shënoi rritje vjetore prej 36.4 përqind. Pavarësisht rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimit (mesatarisht 7.6 përqind vitin 2022), rritja e inputeve bazë dhe kostove tjera përcjellëse në këtë sektor mund të ketë ndikuar në rritjen e IHD-ve në sektorin e ndërtimit për 70.0 përqind. Ndërsa, rritja e IHD-ve në sektorin e patundshmërisë vlerësohet se u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve në këtë sektor (35.0 përqind rritje e çmimeve të përgjithshme për metër katror bazuar nga shoqata e ndërtuesve). IHD-të e rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje të lartë prej 75.0 përqind në vitin 2022, duke arritur vlerën prej 175.6 milionë euro (100.3 milionë euro në vitin 2021), investime të destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë.

Grafikk 12. Remitancat



Burimi: BQK (2023)

Grafikk 13. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK (2023)

IHD-ve apo 523.7 milionë euro dhe në vitin 2022 shënoi rritje vjetore prej 36.4 përqind. Pavarësisht rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimit (mesatarisht 7.6 përqind vitin 2022), rritja e inputeve bazë dhe kostove tjera përcjellëse në këtë sektor mund të ketë ndikuar në rritjen e IHD-ve në sektorin e ndërtimit për 70.0 përqind. Ndërsa, rritja e IHD-ve në sektorin e patundshmërisë vlerësohet se u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve në këtë sektor (35.0 përqind rritje e çmimeve të përgjithshme për metër katror bazuar nga shoqata e ndërtuesve). IHD-të e rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje të lartë prej 75.0 përqind në vitin 2022, duke arritur vlerën prej 175.6 milionë euro (100.3 milionë euro në vitin 2021), investime të destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë.

3.4. Sektori financiar


3.4.1 Karakteristikat e përgjithshme

Sistemi financiar shënoi rritje të konsiderueshme të aktivitetit gjatë vitit 2022, përkundër rritjes së lart të inflacionit, shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, si dhe luhatshmërive të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, rritja ishte më e ngadalësuar se vitin paraprak, si pasojë e ngadalësimit të theksuar të rritjes së asetëve të sektorit pensional.

Gjithsej vlera e asetëve të sistemit financiar arriti në 9.89 miliardë euro në dhjetor 2022, që përkon me rritje vjetore prej 10.7 përqind, përkatësisht 2.0 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak (grafik 14). Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend.

Numri i institucioneve financiare u shtua gjatë vitit 2022, në 131 nga 127 një vit më parë. Gjatë kësaj periudhe filloi operimin një bankë e re me kapital vendor, duke shtuar numrin e gjithsej bankave në 12. Numri i ndihmësve financiarë (këmbimoreve) - me pjesëmarrje marginale në asetet e sistemit financiar prej 0.4 përqind - u rrit në 59 nga 53 vitin e kaluar. Ndërsa, numri i ndërmjetësuesve në sigurime u zvogëlua në 16 nga 19 një vit më parë (tabela 3).

Grafik 14. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2023)

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Bankat komerciale	10	10	10	11	11	12
Siguruesit	15	14	13	13	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2
Ndhmësit financiar	43	50	50	57	53	59
Ndërmjetësuesit në sigurime	16	16	18	18	19	16
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	25	29	29	29	30	30

Burimi: BQK (2023)

3.4.2 Sektori Bankar


Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2022 arritën vlerën 6.76 miliardë euro (grafik 14), që përkon me rritje të përshpejtuar vjetore prej 13.4 përqind krahasuar me rritjen 11.3 përqind në vitin paraprak. Kontributin kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit, i cili shënoi rritjen vjetore më të lartë në njëmbëdhjetë vitet e fundit (tabela 4). Bilanci me bankat tjera ishte komponenta e dytë radhazi për nga kontributi në përshpejtimin e rritjes së asetëve, përderisa zërat tjerë ngadalësuan ritmin rritës.

Përkatësisht, investimi në letra me vlerë shënoi rritje vjetore të ngadalësuar prej 9.8 përqind krahas rritjes prej 17.2 përqind në vitin paraprak. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënuan gjithashtu ngadalësim të rritjes vjetore në 4.5 përqind nga 6.2 përqind në vitin paraprak (grafik 15).

Shkalla e koncentrimin në sektorin bankar ka vazhduar rënien edhe gjatë këtij viti, duke reflektuar presionet e konkurrencës në rritje përbrenda sektorit bankar, të evidentuara edhe përmes Anketës së Kreditimit Bankar. Konkretisht, asetet e tri bankave më të mëdha kanë zbritur peshën në 51.9 përqind të aseteve të sektorit nga 52.6 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, indeksi Herfindal-Hirschman për asetet e sektorit bankar zbriti në 1,392 nga 1,416 në vitin e kaluar.

Grafik 15. Zërat kryesorë të aseteve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2023)

Shtimi i një banke të re me kapital vendor, si dhe rritja e pjesëmarrjes në treg të njëjës bankë vendore, ndikoi që shkalla e aseteve në pronësi vendore të rritet lehtësisht në 15.1 përqind nga 14.5 përqind.

Tabela 4. Struktura e aseteve të sektorit bankar


Përshkrimi	2019		2020		2021		2022	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	622.5	13.1%	790.6	14.8%	839.9	14.1%	877.4	13.0%
Bilanci me bankat komerciale	440.6	9.3%	562.2	10.5%	496.1	8.3%	575.2	8.5%
Letrat me vlerë	526.5	11.1%	584.3	10.9%	685.0	11.5%	752.1	11.1%
Kreditë bruto	3,031.9	63.7%	3,246.6	60.6%	3,748.6	62.9%	4,348.5	64.3%
Asetet Fikse	98.9	2.1%	116.4	2.2%	127.4	2.1%	136.1	2.0%
Asetet Tjera	40.1	0.8%	53.2	1.0%	62.7	1.1%	71.4	1.1%
Gjithsej	4,760.5	100%	5,353.4	100%	5,959.6	100%	6,760.6	100.0%

Burimi: BQK (2023)

Kreditë

Portofoli kreditor i sektorit bankar u zgjerua për 16.0 përqind në vitin 2022, duke arritur vlerën prej 4.35 miliardë euro. Rritja vjetore e stokut të kredive paraqet rritjen më të lartë në 11 vitet e fundit. Gjysma e parë e vitit u karakterizua me rritje më të theksuar, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit është shënuar ngadalësim i trendit rritës. Kreditë e reja, pas rritjes së lartë në vitin 2021, shënuan ngadalësim të trendit rritës duke u kthyer në nivelet e rritjes së viteve parapandemike. Përderisa rritja në kreditë e reja ishte e lartë në tremujorin e parë të vitit, në pjesën pasuese të vitit, pas shpërthimit të luftës në Ukrainë dhe rritjes së presioneve inflacioniste, ato u karakterizuan me rënie vjetore. Sipas Anketës së Kreditimit Bankar, rritja e kreditimit gjatë vitit 2022 është nxitur kryesisht nga kërkesa, përderisa oferta, përkatësisht standardet e kreditimit janë shtrënguar veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit ose nuk kanë ndryshuar fare. Faktorët me kontribut pozitiv në rritjen e aktivitetit kreditues ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, rritja e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Ndërsa faktorët me

Grafik 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2023)


kontribut negativ ishin rreziqet e shtuara në lidhje me perspektivën ekonomike dhe tregjet globale, dhe reflektimi i tyre në përkeqësim të portofolit kreditor.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej 15.7 përqind (grafik 16). Të gjithë sektorët ekonomikë shënuan rritje vjetore të përshpejtuar të kreditimit, me përjashtim të sektorit të shërbimeve financiare, patundshmërive, qerave, etj.. Ky sektor shënoi ngadalësim të rritjes vjetore, përkundër rritjes së lart prej 33.9 përqind (46.2 përqind në vitin paraprak). Sektori i tregtisë, me pjesëmarrje prej 42.7 përqind në gjithsej kreditë sipas sektorëve ekonomikë (grafik 18), shënoi rritje prej 11.8 përqind. Sektori i dytë me pjesëmarrjen më të lartë, sektori i prodhimit, shënoi rritje të lartë vjetore prej 29.4 përqind dhe rezultoi sektori me kontributin më të madh në rritjen e gjithsej kreditimit sipas sektorëve ekonomik. Ndërtimtaria u karakterizua me rritje vjetore prej 25.8 përqind, që përkon me pothuajse trefishim të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, sektori i bujqësisë, i cili u karakterizua me rënie vjetore të kreditimit prej 6.8 përqind në vitin 2021, në vitin 2022 shënoi rritje prej 9.9 përqind (grafik 19).

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve u rritën për 9.6 përqind. Për dallim nga viti paraprak ku kreditë e reja industriale shënuan rënie, këtë vit kjo nënkategori shënoi rritje prej 17.1 përqind. Kreditë e reja për bujqësinë shënuan rritjen më të lartë, prej 34 përqind. Ndërsa kreditë e reja të sektorit të shërbimit, që kanë pjesëmarrjen më të madhe, shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind.


Kreditimi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vazhdoi të mbështetet nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë në vitin 2022, por në shkallë më të ulët krahasuar me vitin paraprak për shkak të mbylljes së dritares së Rimëkëmbjes Ekonomike (pako e ofruar nga Qeveria e Kosovës, në kuadër të masave për mbështjetjen e bizneseve për tejkalimin e sfidave të krijuara nga gjendja pandemike) në fund të vitit 2021. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK që nga fillimi i funksionimit, arriti në 12,084 në fund të vitit 2022 (10,064 në fund të vitit 2021), ndërsa shuma kumulative e kredive të garantuara arriti në 506.3 milionë euro (408.7 milionë euro

Grafik 17. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2023)

Grafik 18. Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2023)

Grafik 19. Stoku i kredive sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2023)

në fund të vitit 2021). Struktura e kredive të garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar.

Kreditë për ekonomitë familjare shënuan ngadalësim të lehtë të rritjes vjetore në 16.7 përqind nga 18.6 përqind në dhjetor 2021 (grafik 16). Ngadalësimi i rritjes së kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet dinamikës së kredive të reja të këtij sektori, të cilat gjatë kësaj periudhe shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes vjetore në 2.4 përqind nga 45.0 përqind në vitin 2021. Kreditë e reja konsumuese shënuan rënie vjetore prej 6.3 përqind (rritje 40.3 përqind në vitin 2021), ndërsa kreditë hipotekare ngadalësuan rritjen në 13.5 përqind nga 56.5 përqind rritje një vit më parë.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat në dhjetor 2022 përbënin 82.1 përqind të gjithsej detyrimeve dhe mjeteve vetanake (tabela 5).

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2019		2020		2021		2022	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	67.0	1.4%	90.4	1.7%	113.2	1.9%	199.9	3.0%
Depozitat	3,908.1	82.1%	4,360.7	81.5%	4,901.8	82.2%	5,553.3	82.1%
Huatë tjera	42.1	0.9%	43.1	0.8%	39.1	0.7%	31.6	0.5%
Detyrimet tjera	179.8	3.8%	202.2	3.8%	220.1	3.7%	252.0	3.7%
Borxhi i ndërvarur	43.4	0.9%	46.9	0.9%	42.3	0.7%	23.0	0.3%
Mjetet vetanake	520.1	10.9%	610.2	11.4%	643.1	10.8%	701.3	10.4%
Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake	4,760.5	100%	5,353.4	100%	5,959.6	100.0%	6,760.6	100.0%


Burimi: BQK (2023)

Mjetet vetanake të sektorit bankar përbejnë komponentën e radhës me pjesëmarrjen më të lartë. Në vitin 2022, pjesëmarrja e tyre u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje në 10.4 përqind, përkundër rritjes së përsheptuar vjetore prej 9.1 përqind (5.4 përqind në vitin 2021). Kjo si rezultat i rritjes më të lartë të komponentëve tjera në strukturën e detyrimeve, me përjashtim të borxhit të varur dhe huave tjera, të cilat shënuan rënie vjetore.

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore të përsheptuar, 13.3 përqind krahasuar me rritjen prej 12.4 përqind në dhjetor 2021. Depozitat e ekonomive familjare, kategoria që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar, ngadalësuan rritjen në 8.2 përqind nga 14.6 përqind një vit më parë (grafik 20). Depozitat e ndërmarrjeve⁷, të dytat për nga pjesëmarrja në strukturën e depozitave, shënuan rritje të ngjashme vjetore, përkatësisht ngadalësim të lehtë të

Grafik 20. Struktura e depozitave, në përqindje



shkallës së rritjes në 18.9 përqind nga 19.3 përqind në vitin 2021. Me rritje të theksuar vjetore u karakterizuan depozitat e korporatave financiare, korporatave publike, si dhe depozitat nga jorezidentët, të cilat edhe përcaktuan trendin e përsheptuar rritës të gjithsej depozitave.

Sa i përket strukturës së depozitave sipas maturitetit, rritja e normave të interesit ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara për 4.8 pikë përqindje në 23.9 përqind në dhjetor 2022,


⁷ Ndërmarrjet private jofinanciare.

ndërsa depozitat e transferueshme zvogëluan pjesëmarrjen për 3.2 pikë përqindje në 64.8 përqind të gjithsej depozitave.

Normat e interesit


Presionet inflacioniste që filluan qysh nga fundi i vitit 2021, fillimisht nxitur nga pasojat e pandemisë dhe pastaj kriza gjeopolitike përgjatë vitit 2022, kanë krijuar presion edhe tek politikbërësit kundrejt shtrëngimit të politikave monetare. Përderisa Rezerva Federale e SHBA-ve vendosi qysh në muajin mars 2022 për rritjen e normave bazë të interesit prej 0.25 pikë bazë (duke vazhduar edhe disa herë përgjatë vitit), Banka Qendrore Evropiane veprroi më vonë dhe në korrik vendosi për rritjen e normës bazë të interesit prej 0.50 pikë bazë.

Grafik 21. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2023)

Grafik 21a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit




Burim: BQK (2023)

Aplikimi i politikave të shtrënguara monetare për të luftuar inflacionin kanë krijuar ambient me norma të rritura të interesit, situatë që është përcjellur edhe në sistemin financiar të vendit. Transmetimi i ndryshimeve në normat bazë të interesit është reflektuar në të gjitha segmentet e tregut bankar e financiar por në nivele të ndryshme.

Në tregun bankar normat e interesit në depozitat e reja janë ndikuar në nivel më të lartë se normat e interesit në kreditë e reja. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 3.9 pikë përqindje nga 4.5 pikë përqindje Në dhjetor 2022, norma e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind nga 5.8 përqind një vit më parë, dhe 6.0 përqind sa ishte në qershor 2022, atëherë kur inflacioni u intensifikua dhe diskutimet mbi ndërhyrjen e politikës monetare në eurozonë filluan.


Për më tepër rritja më e lartë e normave të interesit në kredi erdhi kryesisht nga bankat që kanë bankat amë në vendet e eurozonës, por deri në një masë edhe nga bankat që sapo kanë hyrë në treg. Norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në 2.4 përqind nga 1.3 përqind një vit më parë dhe që të gjitha bankat aplikuan rritje në norma të interesit në depozita (grafik 21). Po ashtu edhe norma ndërbankare e riblerjes (repo rate) e përcaktuar nga BQK në tregun ku linjat kreditore lëshohen ndërmjet bankave bazuar në letrat me vlerë të Qeverisë si kolateral, ka ndjekur vendimet e politikës monetare në BQE duke qenë kështu në të njejtën linjë me nivelin e normave bazë të përcaktuara në eurozonë.

Grafik 22. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2023)

Grafik 23. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2023)


Këto zhvillime përveç që kanë shtyer bankat drejt rritjes së normave të interesit, në të njëjtën kohë kanë ndikuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit. Përderisa në vitin e kaluar dhe në vitin 2020, kreditë me norma variable të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 19.6 përqind të portofolit kreditor dhe 16.5 përqind respektivisht, kjo përbërje këtë vit është ngritur në 24.1 përqind. Po ashtu, disa banka që kanë aplikuar vetëm norma fikse, këtë vit filluan aplikimin e normave variable (grafik 21a).

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u ngrit në 6.5 përqind nga 5.7 përqind sa ishte në dhjetor 2021 (grafik 22). Në kuadër të kësaj kategorie, norma e interesit në kreditë investuese dhe jointestuese po ashtu shënuan rritje në 6.5 përqind nga viti i kaluar që ishin 5.7 përqind dhe 5.8 përqind, respektivisht.


Sipas sektorëve ekonomikë, kreditë për sektorin e industrisë shënuan rritjen më të theksuar prej 1.13 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe të bujqësisë shënuan rritje prej 0.5 pikë përqindje dhe 0.83 pikë përqindje, respektivisht (grafik 23).

Grafik 24. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2023)

Grafik 25. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2023)

Norma mesatare e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare, mbeten pothuajse në nivelin e njëjtë me vitin paraprak prej 5.9 përqind.

Norma mesatare e interesit në depozita u rrit më shumë në depozitat e ekonomive familjare prej 0.9 pikë përqindje në raport me normën mesatare të interesit në depozitat e ndërmarreve që u rrit për 0.5 pikë përqindje (grafikët 24, 25 dhe 26).

Performanca e sektorit bankar


Sektori bankar, përkundër sfidave nga dy krizat më të mëdha globale, e mbylli vitin 2022 me rezultat financiar të rritur pozitiv. Profiti neto i realizuar në vitin 2022 ishte 140.3 milionë euro apo 19.4 përqind më i lartë se në vitin paraprak, megjithëse rritja duket më e ulët se e vitit paraprak që ishte viti pas-pandemik me rritje shumë të theksuar (grafik 27).

Rezultati financiar u mundësua nga rritja më e lartë e të hyrave krahas rritjes së shpenzimeve. Të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën prej 370.4 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 15.0 përqind (grafik 28).

Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 71.1 përqind të gjithë të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit. Për më tepër, këtë vit, të hyrat nga interesi prej plasmanëve në bankat tjera dhe nga investimet në letra me vlerë janë rritur theksueshëm krahasuar me rënien në vitin paraprak. Në rritjen e të hyrave nga interesi (jo-kredi) ka ndikuar rritja e normave të interesit në depozitat e mbajtura jashtë vendit; ndikuar nga politikat e BQE-së për rritjen e normave bazë të interesit.


Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën në 230.0 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.4 përqind që paraqet një rritje më të lartë se në vitin paraprak (ritje vjetore prej 2.6 përqind në dhjetor 2021) (grafik 28). Në rritjen më të lartë të shpenzimeve ndikoi rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, e po ashtu por në masë më të ulët edhe rritja e shpenzimeve për tarifa e komisione dhe shpenzimeve për provizionet e ndara për humbje të mundshme nga kreditë.

Grafik 26. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2023)

Grafik 27. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2023)

Grafik 28. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2023)

Rritja më e lartë e të hyrave krahasuar me rritjen e shpenzimeve ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të jetë më e ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 28). Treguesit e profitabilitetit po ashtu shënuan rritje dhe kthimi në kapital kishte rritje relativisht më të lartë. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) arritën në 2.5 përqind dhe 23.0 përqind nga 2.3 përqind dhe 19.5 përqind, respektivisht (grafik 29).


Treguesit e shëndetit financiarë

Dinamika kryesore që karakterizoi aktivitetin e përgjithshëm ekonomik përgjatë vitit 2022, shkalla e lartë e inflacionit, konsiderohet se është përkthyer në uljen potenciale të të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke rrezikuar potencialisht kapacitetin ripagues të huamarrësve dhe rrjedhimisht rritjen potenciale të rrezikut kreditor. Megjithëse të dhënat në nëntë muajt e parë të vitit nuk tregojnë për materializim të rrezikut në aktivitetin dhe performancën e sektorit,

në tremujorin e katërt, vlera e kredive joperformuese pësoi rritje krahasuar me dy vitet e fundit që ishte në trend të rënies. Qasja prurëse e bankave dhe monitorimi vigilent i performancës së klientëve, si dhe aktiviteti i rritur ekonomik në fillim të vitit, si dhe rritja e remitencave, mund të kenë ndikuar në performancë pozitive të pagesës përgjatë këtyre nëntë muajve. Ndërsa në tremujorin e katërt, rritja vjetore e vlerës së kredive joperformuese prej 4.3 përqind dhe rritja tremujore prej 1.2 përqind, ishte në linjë me pritjet që sugjeronin për rritje deri në një masë të kredive joperformuese si pasojë e zhvillimeve makroekonomike, si dobësimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e inflacionit. Për më tepër, rritja e çmimeve të energjisë ka prekur më shumë ata sektorë që kanë nivel më të lartë të shfrytëzueshmërisë së energjisë elektrike (si ndërtimtaria, prodhimtaria, tregtia) duke ndikuar potencialisht në aftësinë ripaguese të bizneseve kredimarrëse të këtyre sektorëve. Gjithsesi për shkak të rritjes së lartë të kreditimit, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2022 zbriti në 2.0 përqind, për 0.3 pikë përqindje më e ulët sesa në vitin paraprak. Njëkohësisht, raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione zbriti në nivel prej 149.8 përqind nga 151.9 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive joperformuese krahasuar me rritjen e provizioneve (grafik 30).


Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Asetet e peshuara me rrezik shënuan rritje më të theksuar, si rezultat i rritjes së përshpejtuar të kreditimit, në krahasim me rritjen më të ngadalësuar të kapitalit, dinamikë që u reflektua në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK) në 15.5 përqind nga 16.4 përqind në vitin paraprak,

Grafik 29. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2023)

Grafik 30. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2023)


megjithëse ky tregues qëndron mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 12 përqind. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivel të lartë. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ishte 36.5 përqind nga 37.2 përqind një vit më parë, por që mbetet lart mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind. Rënia e nivelit të likuiditetit krahasuar me një vit më parë është rezultat i rritjes së detyrimeve afatshkurtëra prej 9.2 përqind, ndikuar nga rritja e depozitave kryesisht gjatë fundit të vitit, krahas rritjes së mjeteve likuide prej 7.0 përqind. Përderisa, rritja më e ngadalësuar e aseteve likuide (7.0 përqind nga 5.9 përqind një vit më parë), ishte rezultat i rritjes së nivelit të kreditimit në ekonominë vendore.

3.4.3 Sektori pensional

Sektori pensional në vitin 2022 u karakterizua me ngadalësim më të theksuar të rritjes së aseteve dhe rënie të vlerës së investimeve krahasuar me një vit më parë, si pasojë e zhvillimeve jo të favorshme makroekonomike që kanë afektuar njëkohësisht turbulencat e evidentuara në tregjet financiare. Vlera e aseteve të fondeve, që dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale me pjesëmarrje prej 99.6 përqind, arriti në 2.42 miliardë euro në fund të vitit 2022, e që përkon me një rritje të ngadalësuar vjetore prej 2.4 përqind (18.2 përqind një vit më parë) (grafik 31). Rritja më e ngadalësuar ishte rrjedhojë e rënies së vlerës së kthimeve nga investimet, përderisa rritja e arkëtimeve prej kontributdhënësve ishte më e lartë se në vitin paraprak. Përpjekjet e bankave qendrore drejt kontrollimit të inflacionit përmes shtrëngimit të politikave monetare përçuan sinjale në korrelacion të zhdrejtë me çmimet e aksioneve e obligacioneve dhe për pasojë, ndikuan negativisht në kthimet e investimeve duke filluar qysh nga tremujori i parë i vitit që u theksua tutje në tremujorin e dytë. Megjithëse në të tre tremujorët e parë të vitit kthimet ishin negative, në tremujorin e katërt të vitit të dy fondet pensionale arritën të realizojnë kthime pozitive. Kthimi bruto kumulativ nga investimet përgjatë vitit 2022 pësoi rënie të vlerës duke zbritur në territorin negativ prej 119.7 milionë euro, krahasuar nga kthimet pozitive prej gjithsej 228.4 milionë euro një vit më parë. Ndërsa vetëm në tremujorin e katërt të vitit, vlera e kthimeve u rikthye në territorin pozitiv prej 51.72 milionë euro.


Ndaras, FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë negative prej 118.9 milionë euro, me çmim të njësisë prej 1.63 euro nga 1.72 euro sa ishte në ditën e fundit të muajit dhjetor 2021 (grafik 31A). FSKP-ja gjatë vitit 2022 realizoi kthim bruto në investime në vlerë negative prej 788.6 mijë euro, përderisa çmimi i njësisë u rrit në 1.81 euro nga 2.03 euro sa ishte në fund të dhjetorit 2021.

Grafik 31. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2023)

Grafik 31a. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2023)


Vlera e kontributeve të reja të arkëtuara gjatë vitit 2022 shënoi rritje për 13.1 përqind dhe arriti në 242.1 milionë euro (214.0 milionë euro në vitin 2021). Vlera e arkëtimeve të FKPK-së arriti në 241.5 milionë euro, ndërsa ajo e FSKP-së arriti në 608.4 mijë euro.

Të dy fondet pensionale u karakterizuan me tkurrje të portfolios investuese në tregun e jashtëm krahas rritjes së investimeve në atë të brendshëm, duke qenë të afektuara nga luhatjet negative që kanë prekur tregjet financiare. Investimet e FKPK-së në tregun e brendshëm shënuan rritje vjetore prej 32.1 përqind duke arritur vlerën prej 719.5 milionë euro, të ndikuar theksueshëm nga investimet në certifikata të depozitit dhe atë kryesisht në tremujorin e fundit, që mund të jenë nxitur nga normat në rritje të interesit në depozita. Ndërsa, investimet në tregun e jashtëm pësuan rënie prej 6.5 përqind në vlerën 1.69 miliard nga 1.81 miliard euro, që kryesisht janë fonde investuese (grafik 32&34). Në vitin 2022, investimet e FKPK-së në instrumentin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rritje vjetore 12.7 përqind, duke vazhduar të kenë rolin kryesor pjesëmarrës në portofolin e Letrave me Vlerë të Qeverisë. Sektori pensional në fund të vitit 2022 përfaqësoi 49.0 përqind të gjithsej portofolit të borxhit të brendshëm qeveritar në formë të letrave me vlerë. Ngjashëm me FKPK-në edhe mjetet e investuara prej FSKP-së shënuan rritje vjetore prej 11.7 përqind në tregun e brendshëm - të mbajtura në formë të parasë së gatshme dhe rënie prej 13.3 përqind në tregun e jashtëm, kryesisht në formë të aksioneve (grafik 33&34).

3.4.4 Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve për të katërtin vit me radhë shënoi rritje vjetore dyshifrore të aseteve. Pavarësisht zgjerimit të sektorit, niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit është zgjeruar me ritëm më të ngadalësuar në këto katër vite. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren në Evropë, në 1.50 përqind (1.48 përqind në vitin 2021). Ngjashëm, i ulët mbetet edhe

Grafik 32. Investimet e FKPK-së




Burimi: FKPK (2023)

Grafik 33. Investimet e FSKP-së



Burimi: FSKP (2023)

Grafik 34. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP (2023)


niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2022 shënoi vlerën prej 73.9 euro (64.8 euro në vitin 2021).⁸

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me atë në sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar. Mirëpo, në tri vitet e fundit kemi rritje të lehtë të koncentrimit, veçanërisht në asete, si rezultat i likuidimit të dy siguruesve (një në vitin 2019 dhe një tjetër gjatë vitit 2021). Krahasuar me një vit më parë, Indeksi Herfindahl⁹ për primet e shkruara bruto (PSHB) mbeti i pandryshuar në 981 pikë. Po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë

për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, por krahasuar me një vit më parë, rezultojnë të jetë rritur për 15 pikë bazë në 928 pikë për vitin 2022. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5¹⁰ për vitin 2022, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve, rezultojnë 58.2 përqind (56.6 përqind në vitin 2021), ndërsa i llogaritur në raport me asetet, rezultojnë 53.5 përqind (53.3 përqind në vitin 2021). Pra, rritja e lehtë e koncentrimit si në raport me asetet ashtu edhe primet e shkruara bruto reflekton zvogëlimin e numrit të siguruesve në vitet e fundit, ndërsa koncentrimi është më i lartë në tregun e siguruesve të cilat ofrojnë shërbime të sigurimit 'jetë' për shkak të numrit të ulët të tyre.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të vitit 2022. Vlera e gjithsej asetëve arriti në 269.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 12.1 përqind (grafik 35). Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara – të cilat rrjedhin nga shitja e primeve.

Grafik 35. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2023)

Tabela 6. Asetet e sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022
Paraja dhe depozitat në BQK	4.9	4.9	0.1%	2.1%	1.8%
Depozitat në bankat komerciale	110.1	126.2	14.6%	45.8%	46.8%
Letrat me vlerë	42.9	45.6	6.3%	17.8%	16.9%
Huatë dhe të arkëtueshmet	20.0	20.2	1.1%	8.3%	7.5%
Pjesa e risiguruesit për rezerva teknike	22.6	28.9	27.6%	9.4%	10.7%
Investimet në prona	7.2	7.1	-2.0%	3.0%	2.6%
Asetet tjera	32.7	36.8	12.3%	13.6%	13.6%
Gjithsejtë tregu	240.6	269.7	12.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2023)

⁸ Sipas statistikave të publikuara në databazën e Insurance Europe, niveli i densitetit në vitin 2020 në 32 vende të Evropës ishte 3,679 Euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 6.80 përqind.

⁹ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S paraqet pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) të tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

¹⁰ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 siguruesve me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

Në vitin 2022 edhe kategoria e dytë për nga pesha shënoi rritje, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, megjithëse më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë si rezultat i nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës. Po ashtu edhe konkurrenca për të blerë borxh shtetëror të Kosovës nga sektori bankar dhe ai pensional, kanë ndikuar në rritjen më të ngadalësuar të kësaj kategorie në kuadër të aseteve të sektorit të sigurimit. Zërat tjerë bilancorë shënuan rritje, me përjashtim të investimeve në prona, që është njëra nga dy kategoritë me peshën më të ulët në kuadër të aseteve (tabela 6).

Sigurimet “jojetë” shënuan rritje vjetore prej 12.4 përqind dhe përfaqësuan 91.6 përqind të gjithëj aseteve të sektorit në fund të vitit 2022. Ndërsa sigurimet “jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithëj 64.0 përqind, pasuar nga ekuiteti me 25.2 përqind dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (tabela 7). Vlera e kapitalit ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë si rrjedhojë e fitimit më të ulët të realizuar në vitin 2022, por që operimi me fitim për të tretin vit me radhë ka ndikuar në zvogëlim të mëtejme të humbjeve të bartura nga vitet e kaluara. Si rrjedhojë, vlera e humbjeve të akumuluarra ndër vite nga sektori u zvogëlua për 5.4 milionë euro, në 36.9 milionë euro në fund të vitit 2022.

Tabela 7. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022
Rezervat teknike	153.0	172.5	12.7%	63.6%	64.0%
Kreditë dhe detyrimet nga letrat me vlerë të pavaruara	0.1	0.0	-29.6%	0.0%	0.0%
Llogarite tjera të pagueshme	18.4	23.8	28.8%	7.7%	8.8%
Detyrimet tjera	5.6	5.5	-1.0%	2.3%	2.0%
Gjithëj kapitali i aksionarit	63.4	67.9	7.0%	26.4%	25.2%
Gjithëj të tregu	240.6	269.7	12.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2023)

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 arriti në 134.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind (18.2 përqind në vitin 2021). Rritja më e ngadalësuar e primeve të shkruara krahasuar me vitin 2021 kryesisht është rrjedhojë e bazës më të ulët të primeve të shkruara në vitin 2020 (si rezultat i shpërthimit të pandemisë Covid-19). Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 95.2 përqind të gjithëj primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jojetë” në vitin 2022 arriti në 127.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.5 përqind (tabela 8). Kjo rritje e primeve të shkruara të kategorisë “jojetë” është reflektuar edhe në rritjen e volumit të policave të shitura në vitin 2022, përkatësisht në 1.32 milionë sosh, një rritje vjetore prej 15.1 përqind.¹¹ Sigurimet “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 58.9 përqind në gjithëj bruto primet e shkruara “jojetë”, ndërsa pjesa tjetër përfshin sigurimet vullnetare. Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 7.1 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (tabela 8). Kurse, në kuadër të sigurimit vullnetar, kemi rritje të theksuar të kategorisë ‘Aksident dhe shëndet’, për 29.3 përqind, në 28.4 milionë euro prime të shkruara. Për më tepër, vetëm tek nënkategoria ‘Sigurimi i Sëmundjeve’ në kuadër të ‘Aksident dhe shëndet’, numri i polisave të shitura në vitin 2022 është rritur për 86.8 përqind krahasuar me vitin e kaluar në 265.7 mijë sosh, e që është një sinjal pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve të cilët posedojnë sigurim shëndetësor. Për më tepër, niveli i primeve për kokë banori sa i përket

¹¹ Përfshihet vetëm sigurimi i jojetës.

sigurimit të shëndetit është rritur në 14.81 euro në vitin 2022, nga 11.30 euro sa ishte në vitin 2021.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 6.4 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 31.5 përqind krahasuar me vitin 2021, kryesisht si rezultat i rritjes së primeve të kategorisë ‘Jeta e debitorit’ (“sigurimi i jetës”), nga 1.6 milionë euro në 3.1 milionë euro.

Tabela 8. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2021	Pjesëmarrja: 2022
<i>Gjithsejtë Jo-jetë</i>	112.5	127.7	13.5%	95.9%	95.2%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	60.0	63.2	5.4%	51.1%	47.1%
TPL+	3.0	3.6	18.8%	2.6%	2.7%
Sigurime kufitare	7.3	8.4	16.1%	6.2%	6.3%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	21.9	28.4	29.3%	18.7%	21.1%
Kasko	7.2	8.6	19.5%	6.1%	6.4%
Kredi dhe garancione	6.5	7.6	16.8%	5.6%	5.7%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	4.9	6.0	23.4%	4.1%	4.5%
Përgjegjësi e përgjithshme	1.8	1.9	7.2%	1.5%	1.4%
<i>Gjithsej jetë</i>	4.8	6.4	31.5%	4.1%	4.8%
Gjithsejtë tregu	117.4	134.0	14.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2023)

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore për 5.4 përqind (24.4 përqind një vit më parë), duke arritur vlerën në 64.3 milionë euro në fund të vitit 2022 (61.0 milionë euro në vitin 2021). Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 55.5 milionë euro ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 8.8 milionë euro dëme të paguara nga BKS. Dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me 19.5 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga siguruesit¹². Rritja më e ulët e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve në vitin 2022 për 5.4 përqind kryesisht reflekton bazën më të lartë të vlerës së dëmeve të paguara një vit më parë dhe jo domosdoshmërisht, ngadalësim të dëmeve të ndodhura në këtë vit.

Tabela 9. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2021	Pjesëmarrja: 2022
<i>Gjithsejtë Jojetë</i>	59.9	63.2	5.4%	98.2%	98.2%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	29.4	30.9	5.2%	48.2%	48.1%
TPL+	0.2	0.3	39.9%	0.4%	0.5%
Sigurime kufitare, FG, MoU	10.2	8.8	-13.3%	16.7%	13.7%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	10.6	13.0	22.3%	17.5%	20.3%
Kasko	4.6	5.5	19.9%	7.5%	8.5%
Kredi dhe garancione	1.0	1.8	86.2%	1.6%	2.9%
Sigurime në pronë	3.4	2.7	-20.3%	5.6%	4.2%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0		0.0%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.5	0.0	-97.4%	0.8%	0.0%
<i>Gjithsej jetë</i>	1.1	1.1	3.3%	1.8%	1.8%
Gjithsejtë tregu	61.0	64.3	5.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2023)

¹² Nuk përfshihet BKS-ja.

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jetë” në vitin 2022 arriti vlerën prej 1.15 milionë euro (1.11 milionë euro një vit më parë), që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqind.

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara në vitin 2022 në kuadër të sigurimit “jojetë” u ndikua kryesisht prej pagesave të dëmeve të sigurimeve vullnetar ‘Aksident dhe Shëndet’; si dhe ‘MTPL-së’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm (tabela 9). Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare u rrit për 3.0 milionë euro krahasuar me vitin paraprak, në 23.1 milionë euro. Kurse, vlera e dëmeve të paguara nga sigurimit i detyrueshëm u rrit për 0.2 milion euro, në 40.1 milionë euro në vitin 2022.

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në vitin 2022 u përmirësua për 4.0 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke zbritur në 48.0 përqind (grafik 36). Kjo erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (primeve të arkëtuara) krahasuar me normën e rritjes së shpenzimeve (dëmeve të paguara) në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë (tabela 8 dhe 9).

3.4.4.1 Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 2.1 milionë euro, performancë më e dobët kundrejt vitit të kaluar kur kishte shënuar fitim neto në vlerë prej 6.3 milionë euro (tabela 10). Siguruesit “jojetë” shënuan fitime në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 5.8 milionë euro në vitin 2021. Ndërsa, siguruesit “jetë” shënuan humbje në vlerë prej 413.1 mijë euro krahasuar me fitimet prej 492.4 mijë euro në vitin 2021. Zvogëlimi i fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve (ndikuar nga presionet inflacioniste në vitin 2022) dhe shpenzimeve administrative (kryesisht kompensimit për punëtor).

Grafik 36. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara




Tabela 10. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022
Sigurimet Jojetë	-5.1	2.0	5.8	2.5
Sigurimet Jetë	0.5	0.3	0.5	-0.4
Gjithsejtë tregu	-4.7	2.3	6.3	2.1

Burimi: BQK (2023)

Po ashtu, krahasuar me vitin e kaluar, është evidentuar rritje e kategorisë së shpenzimeve për dëmet e ndodhura (vlerë dhe numër), e që është rezultat i rritjes së numrit dhe vlerës së primeve të shkruara.

3.4.5 Sektori mikrofinanciar

Në vitin 2022, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën në 400.8 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 17.9 përqind (grafik 37).


Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (71.5 përqind), pasuar nga lizingjet (18.4 përqind). Ndërsa, pjesa tjetër e aseteve (prej 10.1 përqind) përbëhet kryesisht nga paraaja e gatshme në bankë dhe asetet tjera.

Kreditë


Vlera e stokut të kredive të lëshuara në vitin 2022 arriti në 286.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.8 përqind (rritje vjetore prej 17.1 përqind në vitin 2021) (grafik 38). Rritja e theksuar e kreditimit për të dytin vit me radhë reflekton kërkesën për kredi nga të dy segmentet, atë të ekonomive familjare (që kishin kontributin kryesor në rritjen e përgjithshme të kredive) dhe korporatave jofinanciare.

Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 16.4 përqind dhe arriti vlerën prej 182.1 milionë euro në fund të periudhës. Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore prej 26.2 përqind dhe arritën në 104.4 milionë euro.

Grafik 38. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive




Grafik 39. Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka ndjekur trendin e përgjithshëm, duke shënuar rritje në secilin segment. Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin për korporatat jofinanciare të IMF/IFJB-të prej 25.8 përqind. Për më tepër, ky segment kishte kontributin e dytë më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, duke shënuar rritje vjetore prej 25.4 përqind në vitin 2022 dhe arritur vlerën prej 26.9 milionë euro. Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancia e ofruar nga FKGG-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të¹³. Krahasuar me një

Grafik 37. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2023)

Grafik 40. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2023)

¹³ Ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme (NMVM-të)

vit më parë, shuma e miratuar e kredive nga FKGK-ja arriti në 506.3 milionë euro, një rritje kundrejt vitit paraprak për 23.9 përqind. Si rrjedhojë e garancive prej FKGK-së, IMF-të i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për kredi për këtë sektor, që vlerësohet si sektor që bart rrezik më të lartë. Me rritje dyshifrore gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe segmenti i industrisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë. Kreditimi ndaj segmentit të shërbimeve tjera¹⁴, kishte kontributin dhe rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe (grafik 39).

Lizingjet


Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar. Aktiviteti i lizingjeve për të dytin vit me radhë shënuan rritje dyshifrore dhe arritën vlerën në 73.7 milionë euro në fund të vitit 2022 (grafik 40). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë të kenë korporatat jofinanciare, përdërisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar.

Normat e interesit

Normat e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënuan rënie të lehtë vjetore në 18.6 përqind, nga 19.4 përqind sa ishte në dhjetor 2021. Për dallim nga sektori bankar, që ka norma pothuajse trefish më të ulëta për shkak të kostos së ulët të financimit të aktiviteteve (përmes depozitave), IMF/IFJB-të kryesisht financohen nga kreditë e marra nga sektori i jashtëm, që kanë norma më të larta të interesit. Zhvillimet e fundit në sektorin financiar, përkatësisht rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore, pritet të reflektohet në koston e financimit të sektorit dhe potencialisht, të përkthehet në rritje të normës së interesit të ofruar nga ky sektor.


Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare ishin më të larta krahasuar me ato për korporatat jofinanciare. Norma mesatare e interesit në dhjetor 2022 për ekonomitë familjare zbriti në 20.7 përqind, rënie vjetore për 0.2 pikë përqindje. Kurse, norma mesatare e interesit ndaj korporatave jofinanciare, në dhjetor 2022 zbriti në 15.3 përqind, rënie vjetore për 2.1 pikë përqindje, (grafik 41).

Grafik 41. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2023)

Grafik 42. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2023)

Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, normat mesatare të interesit, në bazë vjetore u zvogëluan për të gjitha veprimtaritë ekonomike, me theks të veçantë për sektorin e shërbimeve (grafik 42). Norma e interesit për kreditë për sektorin e bujqësisë dhe atë të industrisë u zvogëluan për 1.7 dhe 1.9 pikë përqindje përkatësisht, duke qëndruar në 17.3 përqind në dhjetor 2022. Kurse, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve kishin normën më të ulët të interesit, prej 13.8 përqind, rënie vjetore për 2.1 pikë përqindje.

¹⁴ Hotelet dhe Restorante, Tregti tjetër, Shfrytëzimi i shërbimeve financiare, patundshmëri, qera, Shërbime tjera etj.

Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar në vitin 2022 arriti të shënoj fitim neto në vlerë prej 17.0 milionë euro.

Rritja më e theksuar e të hyrave (14.9 përqind) kundrejt nivelit të rritjes së shpenzimeve (12.6 përqind) të sektorit ka ndikuar që IFM/IFJB-të të realizojnë fitim më të lartë për 2.9 milionë euro krahasuar me një vit më parë (grafik 43 dhe 44).

Në kuadër të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominuese të të hyrave (89.8 përqind), shënuan rritje vjetore prej 15.9 përqind (rritje për 3.0 përqind në vitin 2021), si rezultat i rritjes së theksuar të kreditimit në dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointerеси në vitin 2022 shënuan rritje për 6.6 përqind, por që kontributi i tyre në rritjen e gjithsej të hyrave ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej të hyrat (10.2 përqind).


Në kuadër të shpenzimeve, rritja e evidentuar në nënkategorinë e shpenzimeve të jointerесit kryesisht i'u atribua shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 18.9 përqind (7.7 përqind një vit më parë), e që kryesisht i është atribuar rritjes së shpenzimeve për punëtorë dhe në masë më të ulët, atyre administrative.

Grafik 43. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2023)

Grafik 44. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2023)

Rritja e numrit të personelit përgjatë vitit 2022 dhe rritja e pagave në sektor (si kundërpërgjigje ndaj shkallës së inflacionit) rezultojnë të kenë kontribuar në rritjen e kësaj nënkategorie të shpenzimeve të jointerесit. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (21.4 përqind të gjithsej shpenzimeve) shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind në vitin 2022 (-37.0 përqind një vit më parë), që kryesisht reflekton rritjen e nivelit të huazimeve prej sektorit të jashtëm.

Niveli i kredive joperformuese¹⁵ ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Përderisa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2022 është rritur në 153.2 përqind (141.6 përqind në vitin 2021) (grafik 45).

Grafik 45. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



*Përfshihen kreditë dhe lizingjet

Burimi: BQK (2023)

¹⁵ Në nivelin e kredive joperformuese janë të përfshira kreditë dhe lizingjet, në mungesë të disagregimit të tyre.

3.4.6 Ndhimësit financiarë

Sektori i ndihmësve financiarë përfaqëson vetëm 0.4 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, por përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP). Vlera e aseteve të ndihmësve financiarë në vitin 2022 arriti në 35.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 45.1 përqind (21.1 përqind një vit më parë).

Struktura e aseteve të ndihmësve financiar kryesisht përbëhet nga paraja e gatshme dhe ajo e mbajtur në sektorin bankar, që përbëjnë rreth 65.2 përqind të gjithsej aseteve. Kurse, pjesa tjetër prej 6.8 dhe 28.0 përqind përbëhet nga asetet fikse, përkatësisht asetet tjera. Sektori kryesisht financohet nga kapitali vetanak dhe huamarrjet, që përbëjnë 55.1 përkatësisht 40.8 përqind të gjithsej detyrimeve. Të hyrat e ndihmësve financiarë shënuan rritje vjetore prej 10.5 përqind dhe arritën vlerën në 11.3 milionë euro në fund të dhjetorit 2022. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiarë dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 59.3 përqind), të cilat u karakterizuan me rënie vjetore prej 1.3 përqind. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha, ajo e të hyrave tjera (39.9 përqind), shënoi rritje për 1.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë, në 4.5 milionë euro në vitin 2022, dhe njëherit kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej të hyrave. Shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 20.9 përqind, duke arritur vlerën në 8.4 milionë euro, e që është kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve të përgjithshme operative për 26.3 përqind krahasuar me një vit më parë. Kjo kategori përbën rreth 90.2 të gjithsej shpenzimeve të sektorit, dhe pjesa tjetër përbëhet nga shpenzimet për interesa dhe shpenzimet për transferet. Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt ecurisë së të hyrave, sektori realizoi fitim prej 2.9 milionë euro në vitin 2022, që paraqet një rënie vjetore prej 11.5 përqind.

3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2023

Norma dyshifrore e rritjes së BPV-së reale në vitin 2021 si dhe lufta në Ukrainë, e cila u shoqërua me rritje të inflacionit, ndikuan që aktiviteti ekonomik të shënoj rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022. Sa i përket vitit 2023, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej rreth 4.0 përqind. Rritja e aktivitetit ekonomik pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe eksportet neto me një kontribut prej 2.0 pikë përqindje secila.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 1.1 përqind, ndërsa rritja nominale pritet të jetë 6.1 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave, kompensimi i punëtorëve, rritja e kredive konsumuese si dhe rritja e konsumit publik. Investimet në vitin 2023 parashihet të shënojnë rritje reale prej 2.6 përqind (6.1 përqind rënie në vitin 2022). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve pritet të ketë edhe rritja e investimeve publike.

Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2023 pritet të ndikojnë pozitivisht në rritjen e BPV-së. Kontributi pozitiv i eksportit neto pritet të jetë për shkak të pritjeve për rritje të çmimeve të importit edhe në vitin 2023. Ky projektion mbështetet në parashikimet e rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 7.1 përqind në terma real, ndërkohë që importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një normë më të ulët prej 1.0 përqind. Rrjedhimisht, deficitit tregtar i mallrave dhe shërbimeve në terma real pritet të jetë më i ulët për 6.3 përqind krahasuar me vitin 2022.

Sa i përket inflacionit, norma mesatare pritet të ngadalësohet në rreth 4.9 përqind (11.6 përqind në vitin 2022). Ky nivel i inflacionit është në përputhje me parashikimet e inflacionit në Eurozonë, si dhe zhvillimit të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të cilat janë duke shënuar rënie, ndërkohë që edhe shtrëngimi financiar pritet të ndikoj negativisht kërkesën rrjedhimisht ngadalësimin e rritjes së inflacionit.

4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektiv parësor i saj është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e këtij objekti përmes përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësi ligjore si autoritet licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

- Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike.
- Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të aplikueshme ndaj institucioneve financiare, në harmoni me legjislacionin primar, Direktivat Evropiane si dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar; si dhe ndërmarrjen e masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat, që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.


4.1. Licencimi

Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2022, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 46.

Figura 46. Struktura e sistemit financiar në Kosovë



Struktura e sistemit financiar përbëhet nga gjithsej 127 institucione financiare, të cilat janë licencuar dhe regjistruar, si dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të BQK-së.


4.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2022, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 46 degë dhe 158 zyra brenda territorit të vendit (figura 48). Gjatë këtij viti me miratim të BQK-së janë rritur degët e Pribank SH.A ndërsa numri i zyrave ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit ishte pothuajse e njëjtë me vitin paraprak në raport me numrin e degëve dhe zyrave (tabela 10). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në regjionin e Prishtinës (33.0 përqind), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (28.8 përqind) siç edhe shihet në figurën 49.

Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik. Pra, nuk ka ndryshim të theksuar në regjionet tjera gjatë kësaj periudhe në raport me përqindjen e

Grafik 47. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2023)

Grafik 48. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (2023)

degëve dhe zyrave bankare sipas regjioneve dhe është bërë pothuajse në mënyrë proporcionale në të gjitha regionet.

Tabela 11. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave


Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238
2018	74	33%	35	16%	38	17%	44	20%	31	14%	222
2019	71	33%	35	16%	37	17%	44	20%	30	14%	217
2020	70	33%	34	16%	32	15%	41	19%	34	16%	211
2021	67	33%	34	17%	28	14%	38	19%	34	17%	201
2022	67	33%	35	17%	29	14%	39	19%	33	16%	203

Burimi: BQK (2023)

Siguruesit veprimtarinë e tyre e ushtrojnë përmes 60 degëve njëjtë si në vitin paraprak, 407 zyrave dhe 62 agjentëve brenda territorit të vendit (shih figurën 50). Gjatë vitit 2022, kemi zgjerim të rrjetit të përgjithshëm të zyrave të siguruesve në vend.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, megjithatë nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë. Përderisa përqëndrimi më i madh i popullsisë është në regjionin e Prishtinës (28.8 përqind, shih figurën 49) përqëndrimi i rrjetit të siguruesve është në regjionin e Pejës, pasuar me regjionin e Gjilanit që janë nga regjionet më pak të përfaqësuar në gjithsej popullatën në vend (shih figurën 49) dhe kjo strukturë është konsistente gjatë pesë viteve të fundit (tabela 11).

Grafik 49. Rrjeti i siguruesve



Burimi: BQK (2023)

Tabela 12. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjilanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74
2019	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2020	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2021	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2022	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60

Burimi: BQK (2023)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë.

Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2022, aktivitetin e tyre e ushtrojnë përmes 136 zyrave të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2022 është aprovuar hapja e 6 zyrave, si dhe zhvendosja e 7 zyrave të tjera të IMF-ve. Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të jetë e përqëndruar vetëm në dy regjione të territorit të vendit konkretisht në regjionin e Prishtinës dhe të Prizren (tabela 12).

Tabela 13. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsejtë
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	27	26%	24	23%	23	22%	19	18%	12	11%	105
2017	29	26%	26	23%	24	21%	20	18%	14	12%	113
2018	32	27%	28	23%	24	20%	22	18%	14	12%	120
2019	37	29%	30	23%	24	19%	23	18%	14	11%	128
2020	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2021	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2022	39	29%	33	24%	26	19%	24	18%	14	10%	136

Burimi: BQK (2023)

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2022, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 1008 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të institucioneve financiare jobankare është e përqendruar në pothuajse gjithë territorin e vendit, ku prinë regjioni i Prishtinës me pjesëmarrje të shtrirjes së tyre, dhe regjioni i Mitrovicës që ka një pjesëmarrje më të ultë (shih tabela 13). Këtij ritmi të rritjes së zyrave dhe agjentëve të rinjë të institucioneve financiare jobankare i ka kontribuar hyrja në treg dhe regjistrimi i institucioneve të reja financiare që merren me shërbimin e pagesave, emetimit të parasë elektronike dhe me këmbim valutor.

Tabela 14. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsejtë
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	136	29%	86	18%	101	22%	103	22%	41	9%	467
2017	158	30%	97	18%	109	21%	114	22%	52	10%	530
2018	181	30%	112	19%	122	20%	129	22%	53	9%	597
2019	223	31%	127	18%	139	19%	159	22%	65	9%	713
2020	290	33%	151	17%	165	19%	191	22%	82	9%	879
2021	344	36%	164	17%	170	18%	196	21%	80	8%	954
2022	364	36%	178	18%	174	17%	211	21%	81	8%	1008

Burimi: BQK (2023)

4.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe funksionimit normal të veprimtarive financiare, BQK-ja gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar gjithsej 519 kërkesa nga të cilat 10 aplikacione (dy në proces të bartura në 2023) për licencim/regjistrim dhe 512 kërkesa të institucioneve financiare për miratim të transaksioneve, të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak të BQK-së (tabela 15). Këtu përfshihen edhe: i) kërkesat e shqyrtuara në vitin 2022 të bartura për vendimmarrje në vitin 2023; ii) shprehjet e interesimit për licencim/regjistrim, iii) kërkesat të cilat vlerësohen mirëpo nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së dhe iv) pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet tjera të shqyrtuara nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2022 ngjashëm me vitin e kaluar, BQK-ja kryesisht ka pranuar kërkesa për regjistrim të IFJB-ve.

Në përgjithësi struktura e kërkesave për licencim mbetet e ngjashme, një rënie e lehtë e shënuar në krahasim me vitet paraprake.

Tabela 15. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2021						2022					
	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime/ tjetër	Gjithsej	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime/ tjetër	Gjithsej
Aplikacionet	2	0	5	0	0	7	1	0	8	0	1	10
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	2	0	7	1	1	11	4	0	13	3	5	25
Drejtorë dhe menaxherë të lartë dhe delegim funksioneve	21	0	33	30	11	95	22	0	45	26	6	99
Auditori i jashtëm	10	2	25	14	6	57	10	1	30	14	5	60
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statuti/ emrit	7	0	7	0	1	15	6	0	10	2	4	22
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	2	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0	1
Zgjerim i veprimtarive financiare	1	1	0	3	0	5	1	0	5	1	0	7
Hapja, zhvendosja dhe rryllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	27	0	41	30	1	99	11	0	44	15	0	70
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve/brokerëve	47	0	92	10	13	162	35	0	81	4	53	173
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	0	0	51	10	3	64	0	0	47	4	2	53
Tjetër	0	0	0	2	0	2	0	0	1	0	1	2
Gjithsej	119	3	261	100	36	519	91	1	284	69	77	522

Burimi: BQK (2023)

Në kuadër të këtyre 10 aplikacioneve për licencim/regjistrim të vitit 2022, BQK-ja ka procesuar 8 aplikacione, 7 me miratime, 1 refuzim dhe 2 tjera janë bartur për vitin 2023. Aplikacionet për licencim/regjistrim financiar të realizuar në vitin 2022 janë si në vijim:

- Miratimi i regjistrimit të “Pribank” SH.A., për ushtrimin e veprimtarisë bankare;
- Miratimi i regjistrimit të “Global Exchange” SH.P.K., për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- Miratimi i regjistrimit të “Convert Euro” SH.P.K., për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- Miratimi i regjistrimit të “Orchide Exchange” L.L.C., për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- Miratimi i regjistrimit të “FinInvestire” L.L.C., për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- Miratimi i regjistrimit të “KSG” SH.P.K., për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- Miratimi i regjistrimit të “OneFor Kosova” L.L.C., për ushtrimin e veprimtarisë së Shërbimit të Pagesa, dhe Emitim të Parasë Elektronike;
- Refuzimi i Licencimit të “Star Broker” Sh.A. – Dega Kosovë., si kompani ndërmjetësuese për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime.

Në procesin licencues, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive, duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Gjatë vitit 2022 janë proceduar kërkesat për miratim paraprak nga institucionet financiare si në vijim:

- Miratimi i 9 kërkesave për ndryshim në aksionar kryesor;
- Miratimi i 60 kërkesave për miratim të auditorit të jashtëm;
- Miratimi i 4 kërkesave për miratim të anëtarit të jashtëm të komitetit të auditimit;
- Miratimi i 30 kërkesave për miratim të emërimit të anëtarëve të rinj të bordit të drejtorëve në institucione financiare;
- Miratimi i 54 kërkesave për emërim të menaxherëve të lartë;
- Miratimi i hapjes së 38 degëve dhe/ose zyrave të reja të institucioneve financiare, 1 kërkesë e tillë është tërhequr gjatë procesit të shqyrtimit nga institucioni parashtrues, gjithashtu janë miratuar 22 kërkesa për zhvendosje të degëve dhe/ose zyrave të reja të institucioneve financiare;
- Miratimi i mbylljes së 6 zyrave të institucioneve financiare;
- Miratimi i licencimit të 11 brokerëve të rinj të ndërmjetësuesve në sigurime;
- Miratimi i licencimit/regjistrimit të 134 agjentëve të rinj të institucioneve financiare, gjithashtu janë miratuar 53 kërkesa për tërheqje licence/regjistrimit të agjentëve të institucioneve financiare;

- Miratimi i 18 kërkesave për ndryshime në akte të themelimit dhe/apo statute të institucioneve financiare;
- Miratimi i 2 kërkesave për ndryshim të emrit të Institucioni Financiar Jobankar;
- Miratimi i 7 kërkesave për ndryshime në kapital;
- Miratimi i 5 kërkesave për zgjerim të veprimtarisë;
- Refuzuar një kërkesë për miratim si menaxher të lartë të një siguruesi jo jetë;
- Janë tërhequr/ anuluar njëanshëm 12 kërkesa që kërkojnë miratime paraprake për regjistrim/licencim të Institucioneve Financiare;
- Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 47 kërkesa të pranuar, që janë pranuar në gjysmën e dytë të muajit dhejtor 2022, por që kanë mbetur në proces për vitin 2023. Këto kërkesa janë nga të gjitha llojet e kërkesave të sipërpërmendura, ku dy kërkesë janë kërkesa për likuidim vullnetar: një Ndërmjetësuesit në Sigurime dhe një Institucioni Financiare Jo - Bankar.

Totali i kërkesave të proceduara brenda vitit 2022 është 522 kërkesa. Koha mesatare e shqyrtimit të tyre nga dita e pranimit të kërkesës është 21 ditë, dhe për aplikacione 122 ditë, për tërheqje/anulim të njëanshëm për mos kompletim dokumentacioni nga Institucionet financiare është 67 ditë.

4.2. Rregullimi

4.2.1 Korniza ligjore dhe rregullative e sistemit financiar

Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe rishikimi i kuadrit rregullativ në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për institucionet financiare të licencuara/regjistruara dhe të mbikëqyrura nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), nëpërmjet përafrimit me aktet rregullative të Bashkimit Evropian dhe me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive të institucione tjera ndërkombëtare relevante.

Deri më tani, BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar me procesin gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave të nxjerra nga BIS – Bank for International Settlements dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguruesve të nxjerra nga IAIS – International Association for Insurance Supervision. Meqenëse direktivat, standardet ndërkombëtare dhe parimet e lartcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të karakterit dinamik, kjo ndikon që hartimi i kornizës juridike të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare për nevojat e sektorit financiar në Kosovë.

4.2.2 Korniza ligjore dhe rregullative për mbikëqyrjen e bankave

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2022 janë realizuar aktivitetet si në vijim.

4.2.2.1 Draft Ligji i ri për Banka

Grupi punues brenda BQK-së, gjatë vitit 2019, ka hartuar draftin e Ligjit të ri për banka i cili përfshinë edhe komentet e pranuar nga Shoqata e Bankave dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ligji i ri është ristrukturuar në harmoni me Direktivat Evropiane, kornizën ligjore regjionale si dhe standardet ndërkombëtare bankare. Ligji i ri rregullon në kapitull të veçantë edhe procesin e rimëkëmbjes dhe përmbylljes (ang. recovery and resolution) të bankave duke transpozuar kështu Direktivën e Bashkimit Evropian dhe Rregulloret përkatëse dhe duke avancuar rregullimin bankar paralelisht me vendet e regjionit dhe vendet e zhvilluara Evropiane. Draftimi i tij është mbështetur nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës bankare të angazhuar në kuadër të Thesarit Amerikan si dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Gjatë vitit 2022 Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës ka themeluar grupin punues për hartimin e këtij Ligji.

4.2.2.2 Korniza Rregulluese për Rimëkëmbje, Përmbyllje (Recovery and Resolution) dhe Likuidim të Bankave

Grupi punues brenda BQK-së ka hartuar Kapitullin e Ligjit të ri për banka që adreson pjesën e rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit bankar me mbështetjen e asistencës teknike të BERZH. Me miratimin e Ligjit të ri për Banka, në zbatim të tij planifikohet të miratohen rregulloret në vijim të cilat janë draftuar nga grupi punues dhe që rrjedhin nga pjesa e re e draftuar në ligj që rregullon procesin e rimëkëmbjes dhe likuidimit bankar të bazuar në Direktivën Evropiane për të njëjtin proces. Këto rregullore definojnë se si do të zhvillohet ky proces, akterët kryesor gjatë këtij procesi, kualifikimet e personave të caktuar si administratorë zyrtar apo likuidatorëve dhe çdo proces tjetër të nevojshëm dhe të kërkuar në zbatim të Ligjit të ri të bankave.

4.2.2.3 Përafrimi me rregullativën e BE lidhur me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në banka

Gjatë vitit 2022 janë miratuar dy rregulloret dhe dy udhëzimet si në vijim:

- Rregullore për treguesin e mbulueshmërisë së likuiditetit (LCR);
- Rregullore për treguesin e financimit të qëndrueshëm neto (NSFR);
- Udhëzimi metodologjik për zbatimin e rregullores për treguesin e mbulimit me likuiditetit (LCR);
- Udhëzimi metodologjik për zbatimin e rregullores për treguesin e financimit të qëndrueshëm neto (NSFR);

Rregulloret dhe udhëzimet e lartpërmendura janë hartuar me qëllim të përafrimit me kërkesat e rregullative të BE-së lidhur me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në banka. Rregullore për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet (LCR) është bazuar në Rregulloren e BE-së 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet të datës 10 tetor 2014 si dhe Rregulloren e BE-së 2018/1620 mbi plotësimin e rregullores 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet e datës 13 korrik 2018. Ndërsa Rregullore për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) - është bazuar në Rregulloren e BE-se 2019/876 e datës 20 maj 2019 (Regulation (EU) 2019/876 of the European Parliament and of the Council of 20 May 2019 amending Regulation (EU) No 575/2013 as regards the leverage ratio, the net stable funding ratio, requirements for own funds and eligible liabilities, counterparty credit risk, market risk, exposures to central counterparties, exposures to collective investment undertakings, large exposures, reporting and disclosure requirements, and Regulation (EU) No 648/2012).

Këto rregullore dhe udhëzime metodologjike janë në fuqi nga data 1 janar 2023.

4.2.2.4 Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit

Gjatë vitit 2022 është finalizuar rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të bankave sipas standardeve të Bazelit dhe Rregullores së BE-së për të reflektuar zhvillimet e fundit në menaxhimin e këtij rreziku. Rregullorja është dërguar për miratim tek organet vendimmarrëse në BQK.

4.2.2.5 Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme

BQK-ja ka rishikuar kornizën rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikatat e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet e reja të Evropës (European Valuation Standards - EVS 2016). Ky projekt është zhvilluar me mbështetjen e këshilltarit nga Thesari Amerikan, ekspert me përvojë të gjatë në fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme për nevojat e bankave. Kjo draft rregullore është finalizuar si dhe është proceduar për miratim tek organet vendimmarrëse të BQK-së.

4.2.2.6 Rregullorja për rrezikun e vendit dhe rrezikun e transferit

Gjatë vitit 2022 është finalizuar draft rregullore për rrezikun e vendit dhe të transferit e cila e adreson rrezikun e vendit që i referohet mundësisë ose rrezikut që një huamarrës i huaj (shtetëror ose tjetër) të mos jetë në gjendje ose mos të dëshirojë të përmbushë obligimet për shkak të kushteve specifike të vendit, që mund të jenë ekonomike, politike, sociale, natyrore ose ngjarje tjera si dhe rrezikun e transferit që është një nga rreziqet e vendit dhe i referohet rrezikun që huamarrësi nuk do të jetë në gjendje të konvertojë valutën vendore në valutë të huaj dhe në këtë mënyrë të mos jetë në gjendje të kryejë shërbimet e pagesave të borxhit në valutë të huaj. Gjatë vitit 2023 pritet miratimi i kësaj rregullore nga organet vendimmarrëse të BQK-së.

4.2.2.7 Rregullorja për qasje në llogaritë bazike dhe pagesave në shërbime

Me qëllim të përafrimit të legjislacionit tonë me standardet dhe praktikatat më të mira të Evropës, gjatë vitit 2022 është miratuar kjo rregullore, e cila do të hyn në fuqi nga muaji gusht 2023. Kjo rregullore është e bazuar në Direktivën Evropiane 2014/92/EU mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, kalimin e llogarisë së pagesave dhe qasjen në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike. Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 1 gusht 2023.

4.2.2.8 Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të likuiditetit të bankave (ILAAP)

Gjatë vitit 2022 ka filluar hartimi i rregullores për procesin e vlerësimit të brendshëm të likuiditetit të bankave (ILAAP) e cila bazohet në Kornizën e Bazelit dhe Direktivat Evropiane. Kjo rregullore pritet të finalizohet gjatë vitit 2023 dhe të dërgohet për miratim nga Bordi i BQK-së.

4.2.2.9 Rregullore për qeverisjen korporative të bankave

Gjatë vitit 2022 është finalizuar drafti i rregullores për qeverisjen korporative të bankave e cila e plotëson/ndryshon rregulloren ekzistuese për qeverisjen korporative të bankave, me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të projektit për qeverisjen korporative të mbështetur nga BERZH. Në kuadër të rregullimit të qeverisjes korporative të bankave është hartuar edhe Letra Këshilluese e cila do të shërbejë si një udhëzues që tregon pritshmëritë e BQK-së për zbatimin e kësaj Rregullore dhe që nuk do të ketë qëllimin urdhërues por vetëm informues. Gjatë vitit 2022 gjithashtu janë organizuar punëtoritë për stafin e BQK-së si dhe të industrisë bankare lidhur me ndryshimet dhe kërkesat e reja të cilat rrjedhin nga drafti i ri kësaj rregullore. E njëjta pritet që të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së, brenda vitit 2023.

4.2.2.10 Rregullore për auditimin e jashtëm të bankave

Gjatë vitit 2022 ka filluar plotësim/ndryshimi i rregullores për auditimin e jashtëm të bankave duke u bazuar në elementet e standardit më të ri të Bazelit lidhur me këtë fushë (Supplemental note to External audits of banks – audit of expected credit loss). Kjo rregullore pritet të finalizohet gjatë vitit 2023.

4.2.2.11 Aktivitete tjera lidhur me kornizën rregullative në fushën e bankave

Gjatë vitit 2022 ka filluar angazhimi në Projektin me Bankën Botërore (FinSAC) lidhur me avansimin e akteve rregullative për menaxhimin e rreziqeve të klimës dhe ambientit. Për këtë qëllim ka pasur takime me përfaqësues të Bankës Botërore dhe palët tjera të interesit.

4.2.3 Korniza rregullative për Institucionet Mikrofinanciare (IMF) dhe Institucionet Financiare Jobankare (IFJB).

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare si dhe institucioneve financiare jobankare gjatë vitit 2022 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore si në vijim:

4.2.3.1 Draft Ligji për IMF dhe IFJB

Gjatë vitit 2022, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka themeluar grupin punues për hartimin e këtij Ligji. Pjesë e këtij grupi punues është edhe një përfaqësues nga BQK. Ky grup punues ka filluar punimet e tij në finalizimin e draftit të këtij Ligji.

4.2.3.2 Rregullorja për qeverisjen korporative të IMF dhe IFJB

Gjatë vitit 2022 është finalizuar drafti i rregullores së re për qeverisjen korporative të IMF-ve dhe IFJB-ve, me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të projektit për qeverisjen korporative të mbështetur nga BERZH. Në kuadër të rregullimit të qeverisjes korporative të IMF-ve dhe IFJB-ve është hartuar edhe Letra Këshilluese, e cila do të shërbejë si një udhëzues që tregon pritshmëritë e BQK-së për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe që nuk do të ketë qëllimin urdhërues por vetëm informues. Gjatë vitit 2022 gjithashtu janë organizuar punëtoritë për stafin e BQK-së si dhe të industrisë përkatëse lidhur me kërkesat të cilat rrjedhin nga kjo rregullore. E njëjta pritet që të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së, brenda vitit 2023.

4.2.3.3 Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për IFJB-të

Për të rregulluar çështjen e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit për IFJB-të gjatë vitit 2022 BQK ka hartuar është finalizuar drafti e rregullores për menaxhimin e këtij rreziku. Kjo rregullore është në fazën e procedimit, brenda BQK-së, për miratim nga organet vendimmarrëse.

4.2.3.4 Rregullore për auditimin e jashtëm të IFJB-ve

Kjo rregullore është ndryshuar/plotësuar për arsye të përafritit me zhvillimet e fundit në këtë fushë. Ndryshim/plotësimet kanë filluar dhe përfunduar gjatë vitit 2022. Drafti final është i gatshëm për procedim të mëtutjeshëm.

4.2.3.5 Rregullore për auditimin e jashtëm të IMF-ve

Rregullore për auditimin e jashtëm të IMF-ve është ndryshuar/plotësuar për arsye të përafritit me zhvillimet e fundit në këtë fushë, njësoj sikurse edhe rregullore për auditimin e jashtëm të IFJB-ve. Ndryshim/plotësimet kanë filluar dhe përfunduar gjatë vitit 2022. Drafti final është i gatshëm për procedim të mëtutjeshëm.

4.2.4 Korniza rregullative për siguruesit

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime gjatë vitit 2022 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore si në vijim:

4.2.4.1 Rregullore për qeverisjen korporative të siguruesve

Gjatë vitit 2022 është finalizuar drafti i rregullores së re për qeverisjen korporative të siguruesve e cila e plotëson/ndryshon rregulloren ekzistuese për qeverisjen korporative të siguruesve, me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të projektit për qeverisjen korporative të mbështetur nga BERZH. Në kuadër të rregullimit të qeverisjes korporative të siguruesve është hartuar edhe Letra Këshilluese e cila do të shërbejë si një udhëzues që tregon pritshmëritë e BQK-së për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe që nuk do të ketë qëllimin urdhërues por vetëm informues. Gjatë vitit 2022 gjithashtu janë organizuar punëtoritë për stafin e BQK-së si dhe industrisë së sigurimeve lidhur me kërkesat të cilat rrjedhin nga kjo rregullore. E njëjta pritet që të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së, brenda vitit 2023.

4.2.4.2 Rregullore mbi kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të siguruesve

Në kuadër të projektit për qeverisjen korporative të institucioneve financiare të mbështetur nga BERZH, gjatë vitit 2022 është finalizuar drafti i rishikuar i cili pritet të miratohet së bashku me rregulloret për qeverisjen korporative të institucioneve financiare.

4.2.4.3 Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesve

Drafti i kësaj rregullore është finalizuar gjatë vitit 2022. Drafti i kësaj rregulloreje është në fazën e procedimit, brenda BQK-së, për miratim nga organet vendimmarrëse.

4.2.4.4 Rregullore për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit

Gjatë vitit 2022 është plotësuar/ndryshuar rregullorja ekzistuese ku janë adresuar problematikat e identifikuara nga BQK-ja gjatë zbatimit të kësaj rregullore nga ana e siguruesve. Kjo rregullore është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së.

4.2.4.5 Rregullore për Investimin e Aseteve në Mbulim të Provizioneve Teknike dhe Matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar të Siguruesve

Gjatë vitit 2022 është hartuar drafti i kësaj rregullore dhe aktualisht është në fazën e diskutimit brenda departamenteve përkatëse në BQK. Gjatë vitit 2023, pritet që e njëjta të finalizohet.

4.2.4.6 Rregullore për menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve

Gjatë ekzaminimeve të realizuara tek siguruesit, është parë si e nevojshme rregullimi i menaxhimit të rrezikut operacional të siguruesve. Gjatë vitit 2022 është finalizuar drafti i kësaj rregullore dhe pritet që e njëjta të finalizohet brenda vitit 2023. Kjo rregullore do të adresojë kërkesa shtesë për siguruesit lidhur me menaxhimin e këtij rreziku.

4.2.4.7 Rregullore për Sistemet e Informacionit për Siguruesit

Drafti i kësaj rregullore është finalizuar gjatë vitit 2022. Rregullorja përcakton kriteret dhe kushtet minimale që duhet të plotësojnë siguruesit për organizimin dhe për funksionimin e sistemeve të tyre të informacionit, të cilat mundësojnë uljen e rreziqeve që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i sistemeve të informacionit si dhe të ruajë besueshmërinë e këtyre sistemeve,

në mbështetje të veprimtarisë së siguruesve. Kjo rregullore pritet të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së, brenda vitit 2023.

4.2.4.8 Rregullore për transaksionet me persona të ndërlidhur të siguruesve

Drafti i kësaj rregullore është finalizuar gjatë vitit 2022. Kjo rregullore rregullon transaksionet e siguruesve me personat e ndërlidhur. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore do të shfuqizohet Rregulla 27 e sigurimeve. Kjo rregullore pritet të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së, brenda vitit 2023.

4.2.4.9 Rregullore për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve operative të siguruesve

Gjatë vitit 2022 është plotësuar/ndryshuar rregullorja ekzistuese ku janë adresuar problematikat e identifikuara nga BQK-ja gjatë zbatimit të kësaj rregullore nga ana e siguruesve. Kjo rregullore është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së.

4.2.4.10 Udhëzimi mbi kalkulimin dhe regjistrimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” (ang. DAC) në Pasqyrat Financiare

Gjatë vitit 2022 është plotësuar/ndryshuar udhëzimi ekzistues. Ky Udhëzim është gati për procedim dhe miratim.

4.2.5 Korniza Rregullative për Fondet Pensionale

Gjatë vitit 2022, janë finalizuar dhe miratuar rregulloret në fushën e fondeve pensionale, si në vijim:

- Rregullore për transferet dhe pagesat e transferit të benefiteve të pagesave;
- Rregullore për përcaktimin e përfituesve të pensioneve;
- Rregullore për auditimin e jashtëm të fondeve pensionale dhe ofruesve të pensionit;
- Rregullore për përfitimet pensionale të fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit.

Gjatë vitit 2022 janë finalizuar dhe proceduar me tutje për miratim rregulloret në fushën e fondeve pensionale, si në vijim:

- Rregullore mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar Punëdhënësi;
- Rregullore mbi pjesëmarrjen në Fondin e Pensionit dhe Kategoritë profesionale të nëpunësve (Rregulla 19);
- Rregullore mbi shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare (Rregulla 22);
- Rregullore mbi përfundimin e Fondit Plotësues Pensional të punëdhënësit (Rregullën 21);
- Rregullore për mbikëqyrjen e fushës së teknologjisë informative në fondet pensionale është në proces të hartimit dhe pritet të finalizohet gjatë vitit 2023.

5. Mbikëqyrja e sistemit financiar

Në funksion të pasqyrimin të aktivitetit të saj në fushën e mbikëqyrjes financiare, konform kërkesave që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar përkatës, në vazhdim është paraqitur aktiviteti i mbikëqyrjes financiare sipas natyrës së institucioneve financiare.

Sektori bankar

Gjatë vitit 2022 ka vazhduar aktiviteti i ekzaminimeve të bankave, përmes ekzaminimeve në vend të bankave, me anë të aplikimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik sipas Manualit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka. Gjatë ekzaminimeve të plota në vend të bankave është vlerësuar profili i rrezikut të bankave, mënyra e qeverisjes, apetitet e bankave për të marrë rreziqe, sistemin e vendosur nga ana e tyre për të menaxhuar rreziqet, si dhe është bërë përcjellja e përmbushjes së rekomandimeve të dala nga ekzaminimet paraprake të BQK-së.

Gjatë vitit 2022, në banka janë kryer ekzaminime si në vijim:

Tabela 16. Numri i ekzaminimeve në banka

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	2 ekzaminime të plotë 4 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2023)

Raportet e ekzaminimeve të plota janë përgatitur sipas llojit të rreziqeve bankare siç janë: rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Përveç ekzaminimeve të plota janë mbajtur ekzaminime të fokusuar në bankë, si SNRF 9, teknologji informative, si pjesë integrale e ekzaminimeve, janë dhënë rekomandime përkatëse me afate kohore për zbatim, varësisht nga pesha, ndikimi dhe ndjeshmëria e gjetjeve. Në vazhdimësi është bërë përcjellja e përmbushjes së tyre nga banka, ku është verifikuar se ato rekomandime janë përmbushur sipas afateve të specifikuara kohore.

Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare

Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend të IMF-ve dhe IFJB-ve në vazhdimësi ka përcjellë performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare përmes raporteve mujore që ato kanë dorëzuar në BQK dhe në varësi të nevojave ka ndërmarrë veprime të nevojshme, pasuar me rekomandime konkrete, për t'u zbatuar nga këto institucione. Theks të veçantë i është dhënë përcjelljes dhe ekzaminimeve të institucioneve fin-tech dhe atyre të emetimit të parasë elektronike.

Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare ka vazhduar të karakterizohet me rritje përgjatë vitit 2022 si nga aspekti i operimit të institucioneve të reja në këtë treg, e po ashtu dhe në aspekt të performancës financiare. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2022 janë kryer ekzaminime si në vijim:

Tabela 17. Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB.

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
IMF	5 ekzaminim të fokusuar
IFJB	1 ekzaminim i plotë dhe 3 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2023)

Qëllimi i ekzaminimeve të plota ishte vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve duke përfshirë përshtatshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, menaxhimin e institucionit, pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, vlerësimin e politikave dhe procedurave të brendshme, pasqyrave financiare të institucionit dhe fushat tjera relevante, përfshirë edhe sistemin e funksionimit të teknologjisë informative, ndërsa qëllimi i ekzaminimit të fokusuar ishte vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit konform rregullativës në fuqi si dhe/apo vlerësimi lidhur me zhvillimin e aktivitetit të institucioneve përkatëse.

E arritur e veçantë gjatë 2022 ka qenë rasti i IuteCredit, ku si rrjedhojë e angazhimit të madh dhe një menaxhimi profesional dhe tejet koordinues gjatë gjithë procesit, reflektoi që procesi i arbitrazhit ndërkombëtar lidhur me padinë e IuteCredit ndaj Republikës së Kosovës të jetë në favorin tonë, ku gjykata ndërkombëtare në procesin e arbitrazhit hodhi poshtë të gjitha pretendimet e paraqitura nga IuteCredit.

Në funksion të të qenit proaktiv në mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare me aktivitet të kredidhënies, është bërë monitorimi dhe përcjellja e zbatimit të planeve strategjike dhe projeksioneve financiare për periudhën 2022-2024, me qëllim të vlerësimit të këtyre planeve të biznesit, si dhe pritjet mbi zhvillimet në sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë kësaj periudhe.

Sektori i sigurimeve

BQK-ja ka vazhduar aktivitetin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në funksion të mbikëqyrjes prudente për sektorin e sigurimeve. Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar përmes sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare, si dhe të dhënave tjera të raportuara nga siguruesit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe mbikëqyrjes në vend - ekzaminimeve. BQK-ja është angazhuar me kapacitet të plotë në realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuar. Qëllim i ekzaminimeve ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve përkatëse në raport me profilin e rrezikut dhe pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, në funksion të mbrojtjes së policembajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve. Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë duke filluar nga analizat e treguesve financiarë nga raportimet e institucioneve, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, ekzaminimeve paraprake të realizuara, ankesave të policembajtësve në BQK, si dhe faktorë tjerë. Kjo ka ndikuar në priorizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK-ja dhe si rrjedhojë në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

Tabela 18. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve

Institucioni	Lloji i ekzaminimit
Sigurues	3 ekzaminime të plota 5 të fokusuar
Trajtes të dëmeve	2 ekzaminime
Ndërmjetësues	3 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2023)

BQK-ja gjatë vitit 2022 në funksion të harmonizimit me parimet bashkëkohore të mbikëqyrjes së sigurimeve, të zgjerimit dhe nxitjes së identifikimit të hershëm të rreziqeve të pranishme tek siguruesit, si dhe hartimin e rekomandimeve mbikëqyrëse prudente në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesve, ka vazhduar me implementimin e Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit, i cili përbën një kornizë konceptuale të avancuar lidhur me mbikëqyrjen. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, BQK u angazhua edhe në projekte me ndikim material në kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse të siguruesve. BQK gjatë vitit 2022, përkrahur nga asistenca e ofruar nga Banka Botërore (BB), ka filluar projektin afatgjatë për përafrimin me

kërkesat për kapital sipas Solvencës II. Gjatë vitit 2022 në BQK kanë qenë dy vizita nga ekip i BB ku janë prezantuar elementet bazë të draft udhërrëfyesit për përafrimin me kërkesat e kapitalit sipas Solvencës II. Po ashtu, pjesë e kësaj asistence është edhe përcaktimi i primit për produktin e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia sipas faktorëve të rrezikut dhe procesi i përgatitjes për liberalizimin e tregut.

Spektori i sigurimeve jojetë, në fund të vitit 2022, ka arritur pajtueshmëri me kërkesat ligjore në raport me fondin garantues, aftësinë paguese dhe asete të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike, duke shënuar një përmirësim të rëndësishëm krahasuar me periudhat e mëhershme. Ky përmirësim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, vjen edhe si rezultat i një performace më të mirë të siguruesve si dhe plotësimit/injektimit të kapitalit në shumë prej 6.1 milion euro nga ana e aksionarëve. Rrjedhimisht, kapitali në raport me fondin garantues për siguruesit jojetë rezulton në 129.3 përqind mbi normën e pranuar prej 100%, përderisa për siguruesit jetë raporti rezulton 148.1 përqind. Mbulueshmëria e provizioneve teknike me asete të pranueshme arriti në 113.0 përqind për siguruesit jojetë dhe 107.4 përqind për siguruesit jetë.

Fondet pensionale

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë të sektorit financiar, në vitin 2022 janë zhvilluar ekzaminimet në fonde pensionale sipas planit vjetor. Mbikëqyrja e pensioneve ka zbatuar qasjen e mbikëqyrjes bazuar në rrezik, vëmendje e theksuar i është kushtuar, zbatimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi, menaxhimit të fondeve, strategjisë së investimeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme, ruajtjes së likuiditetit adekuat dhe rreziqeve tjera.

Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve pensionale, gjatë vitit 2022 janë realizuar dy ekzaminime të plota në fondet pensionale dhe dy ekzaminime të fokusuar në fondet pensionale dhe TEB Bankë, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale, duke vlerësuar pajtueshmërinë me ligjet relevante dhe rregulloret e BQK-së, efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve të ngritura në raportet e ekzaminimit të BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve.

Tabela 19. Numri i ekzaminimeve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet Pensionale	2 ekzaminime të plota
TEB banka	1ekzaminim i fokusuar
Fond Pensional	1ekzaminim i fokusuar

Burimi: BQK (2023)

Parandalimi i pastrimit të parasë

BQK-ja bazuar në paragrafin 4 të nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, zbaton kompetencat mbikëqyrëse në institucionet financiare për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregulloret përkatëse. Gjatë vitit 2022 BQK-ja ka vazhduar me realizimin e funksionit mbikëqyrës në institucionet financiare sa i përket pajtueshmërisë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke i realizuar gjithsej trembëdhjetë ekzaminime. Në institucionet bankare janë realizuar dy ekzaminime të plota. Në institucionet mikrofinanciare dhe ato jo bankare janë realizuar pesë ekzaminime, prej tyre tri të plota dhe dy të fokusuar. Ndërsa siguruesit janë mbuluar me një ekzaminim të plotë. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë realizuar pesë ekzaminime në zyret e

këmbimit të valutave. Tabela në vazhdim paraqet numrin e ekzaminimeve të realizuara për vitin 2022.

Tabela 20. Numri i ekzaminimeve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka, IMFJB dhe Sigurues	7 ekzaminime të plota 6 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2023)

Në aspektin e fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime me komitetin për pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave dhe me bankat komerciale, në të cilat takime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë organizuar takime të përbashkëta me institucionet mikrofinanciare dhe kompanitë e sigurimeve.

Ndërsa në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), BQK-ja ka vazhduar me pjesëmarrje aktive në takimet e Këshillit Drejtues dhe aktivitetet tjera të projektit. Në këtë aspekt vlen të ceket që BQK gjatë vitit 2022 në kuadër të projektit PECK III ka përfituar asistencën teknike nga ekspertët e Këshillit të Evropës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Gjatë vitit 2022 janë pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në pajtueshmëri me rregulloren përkatëse, si dhe janë bërë raportimet e rregullta lidhur me aktivitetet për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare.

Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 873 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizik e juridik):

- Gjithsej ankesat për banka komerciale të adresuara në BQK për vitin 2022 kanë qenë 518, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktet kreditore (kredi), përkatësisht klasifikimin në RKK si dhe ankesa lidhur me keqpërdorimin e kredit kartelës.
- Gjithsej ankesat për IMF-të dhe IFJB-të të adresuara në BQK për vitin 2022 kanë qenë 87. Edhe tek këto institucione, ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë, përkatësisht klasifikimin në RKK.
- Gjithsej ankesat ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2022 kanë qenë 262. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me mos kompensim të dëmit material dhe jomaterial nga sigurimi i autopërgjegjesisë TPL, mos respektimi i afateve kohore për pagesë tek marrëveshjet jashtëgjyqësore si dhe mos kompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor.

Tabela 21. Numri i ankesave ndër vite

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve		
	2020	2021	2022
Bankat komerciale	1,048	542	518
IMF / IFJB	376	121	87
Kompanitë e sigurimeve	409	339	262
Fondet pensionale	5	3	0
Kërkesa të tjera	8	20	6
Gjithsej ankesa	1,846	1,025	873

Burimi: BQK (2023)

Në tabelën e mësipërme është i paraqitur numri i ankesave të shqyrtuara gjatë tri viteve të fundit, ku vërehet se numri i ankesave të pranuar dhe trajtuara në vitin 2022 është më i ulët në krahasim me dy vitet paraprake, e sidomos kur krahasojmë me vitin 2020 kur ka qenë vit sfidues në çdo aspekt e që ka prekur edhe divizionin e ankesave në aspektin e volumit të punës, dhe arsyeja e rritjes së numrit të ankesave të pranuar dhe trajtuara ka qenë ndikimi i pandemisë në industrinë financiare, përkatësisht ofrimi i mundësisë së moratoriumit.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, 28 përqind e ankesave kanë rezultuar të zgjidhura në favor të palëve.

Tabela 22. Numri i ankesave sipas statusit

Industria financiare	Gjithsej ankesa	Të mbështutura	Të refuzuara	Në proces
Bankat komerciale	518	155	362	1
IMF / IFJB	87	13	74	0
Kompanitë e sigurimeve	262	75	187	0
Fondet pensionale	0	0	0	0
Kërkesa të tjera	6	0	6	0
Gjithsej ankesa	873	243	629	1

Burimi: BQK (2023)

6. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK-ja në kuadër të operacioneve të menaxhimit me para të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Për realizimin e këtij funksioni mban dhe administron rezervat valutore, rregullon dhe përcakton standardet për institucionet financiare në lëminë e operacioneve me para të gatshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave, obligimin për tërheqjen nga qarkullimi të parave të dyshuara si të falsifikuara dhe atyre të papërshtatshme për riqarkullim si dhe kriteret për këmbimin e parave të dëmtuara.

Gjatë vitit 2022 BQK-ja përbushi në mënyrë të suksesshme furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro.

Tabela 23. Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme

Llojet e transaksioneve	2018	2019	2020	2021	2022
Shuma e transaksioneve me para të gatshme (në euro)	2,384,960,326	3,582,508,222	3,145,892,125	4,066,951,506	5,212,926,592
Rritja vjetore e shumës së transaksioneve me para të gatshme	12.19%	50.21%	-12.19%	29.28%	28.18%
Pranimi i kartëmonedhave	1,186,742,135	1,697,553,870	1,449,545,855	2,087,439,200	2,499,965,400
Furnizimi me kartëmonedha	542,462,255	731,312,360	1,093,937,800	967,243,590	981,543,770
Eksport i kartëmonedhave	600,000,000	1,050,000,000	475,000,000	950,000,000	1,700,000,000
Import i kartëmonedhave	53,000,000	100,000,000	125,000,000	60,000,000	28,500,000
Pranimi i monedhave	1,152,859	888,000	0	290,000	180,362
Furnizimi me monedha	1,603,077	1,324,992	1,045,470	1,367,716	1,616,060
Eksport i monedhave	0	0	0	0	0
Import i monedhave	0	1,429,000	1,363,000	611,000	1,121,000
Vëllimi i transaksioneve me para të gatshme (në copë)	60,309,489	82,844,588	77,997,553	95,447,465	121,075,678
Rritja vjetore e vëllimit të transaksioneve me para të gatshme	6.72%	37.37%	-5.85%	22.37%	26.85%
Pranimi i kartëmonedhave	22,261,117	29,285,567	29,268,128	40,173,242	45,151,268
Furnizimi me kartëmonedha	13,166,830	16,783,917	25,258,425	19,627,266	19,016,775
Eksport i kartëmonedhave	11,326,000	15,586,000	9,672,000	18,128,000	32,333,000
Import i kartëmonedhave	4,200,000	3,590,000	4,420,000	3,715,000	2,700,000
Pranimi i monedhave	2,567,196	670,000	0	160,500	180,185
Furnizimi me monedha	6,788,346	7,229,104	5,379,000	7,743,457	10,544,450
Eksport i monedhave	0	0	0	0	0
Import i monedhave	0	9,700,000	4,000,000	5,900,000	11,150,000


Burimi: BQK (2023)

Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë vitit 2022 aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me para të gatshme shënuan një rritje grupore prej 28.2 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 26.9 përqind (shprehur në vëllim).

Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2022, shënoi një rritje të moderuar prej 1.5 përqind krahasuar me vitin 2021. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, pati një ndryshim të vogël nga viti 2021 në vitin 2022.


Gjatë vitit 2022, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me mbi 19.02 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej afër 981.54 milionë euro) dhe me mbi 10.54 milionë copë monedha euro (në vlerë prej afër 1.62 milion euro).

Grafik 50. Furnizimimi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Grafik 51. Pranimi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2022 shënuan një rënie të moderuar prej 3.1 përqind krahasuar me vitin 2021 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet me prerje prej 5, 20 dhe 100 euro, të cilat përbënin rreth 80.4 përqind të kërkesës për furnizim.

Grafik 52. Furnizimimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë



Burimi: BQK (2023)

Grafik 53. Pranimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Përderisa gjatë vitit 2022 kërkesa për denominimet në vlerë prej 200 euro shënoi rritje prej 46.6 përqind, kërkesa për denominimet në vlerë prej 100 euro shënoi rritje prej 20.1 përqind dhe kërkesa për denominimet në vlerë prej 5 euro shënoi rritje prej 22.0 përqind përderisa kërkesa për denominimet në vlerë prej 50 euro shënoi një rënie prej 63.1 përqind dhe ajo e denominimeve në vlerë prej 10 euro shënoi një rënie prej 12.1 përqind krahasuar me vitin 2021. Kërkesat për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 20 euro shënoi një rritje të moderuar prej 7.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar.

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2022 shënuan një rritje prej rreth 36.2 përqind krahasuar me vitin 2021. Kërkesa për furnizim me monedha euro në vitin 2022 u dominua nga monedhat me vlerë të vogël prej 1, 2 dhe 5 euro cent, të cilat përbenin rreth 67.4 përqind të kërkesës për furnizim. Krahasuar me vitin paraprak kërkesat për denominimet prej 1, 2 dhe 5 euro cent kanë shënuar një rritje grupore prej 40.8 përqind, ndërsa kërkesat për furnizim me denominimet prej 2 euro, 1 euro dhe 50, 20 dhe 10 euro cent kanë shënuar një rritje grupore prej 27.5 përqind në raport me vitin paraprak.

Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 19.8 përqind në vitin 2022 krahasuar me vitin paraprak. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën shumat prej afër 2.5 miliardë kartëmonedha euro dhe mbi 0.2 milionë monedha euro, përkatësisht. BQK-ja pranoi nga sektori bankar mbi 45.2 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 181,330 copë kartëmonedha në ditë), ndërsa depozitat e monedhave ishin vetëm 180,000


copë. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuara gjatë vitit 2022 shënuan një rritje prej rreth 12.4 përqind krahasuar me vitin 2021.

Grafik 54. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2023)


Grafik 55. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2023)


Struktura e kartëmonedhave euro të pranuara gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak kurse siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm depozitat e monedhave ishin në nivel mjaft të ulët në vitin 2022.

Grafik 56. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas deno-minimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2023)

Grafik 57. Pranimi i monedhave euro sipas denomi-meve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2023)

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2022 paratë e gatshme të pranuara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, gjatë vitit 2022 paratë e gatshme neto (tepricat) ishin rreth 1.52 miliardë euro e që ishin dukshëm më të larta se sa në vitin e kaluar kur paratë e gatshme neto ishin rreth 1.12 miliardë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i rritjes së vëllimit të depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërën anë dhe kërkesës së pandryshuar nga viti paraprak për para të gatshme në anën tjetër.


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepricat dërgohen në eurozonë, ku pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2022 arritën shumë prej 1.67 miliardë euro duke qenë më të larta për 87.7 përqind se sa një vit më parë kur ishin 890.00 milionë euro. Kjo rritje neto e dërgesave në vitin 2022 erdhi si rezultat i rritjes së depozitimeve nga sektori bankar në njërën anë dhe kërkesës së pandryshuar për para të gatshme në anën tjetër.

Grafik 58. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Grafik 59. Importi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Gjatë vitit 2022 rreth 45.15 milionë copë kartëmonedha euro të pranuar nga sektori bankar u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe duke u klasifikuar sipas shkallës së përshtatshmërisë. Kontrolli për autenticitet dhe klasifikimi sipas shkallës së përshtatshmërisë ka kontribuar dukshëm në mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro si dhe mundësimin e detektimit të falsifikimit duke siguruar kështu që të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të futura në qarkullim të kishin një gjendje të mirë kualitative (të përshtatshme për riqarkullim) në mënyrë që të sigurohej se këto të fundit mundën lehtë të kontrollohen për vërtetësinë e tyre.

Grafik 60. Eksporti i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2023)


Grafik 61. Importi i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2023)


Rreth 18.97 milionë copë kartëmonedha euro (42.0 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2022 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi kontriboi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës.

Grafik 62. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (vëllimi), në milionë copë




Burimi: BQK (2023)

Grafik 63. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar, në përqindje




Burimi: BQK (2023)

Grafik 64. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2023)


Grafik 65. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (në përqindje)



Burimi: BQK (2023)


Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 91.7 përqind të kartëmonedhave të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët.

Grafik 66. Kartëmonedha të reja te futura ne qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2023)


Grafik 67. Kartëmonedha te reja te futura ne qarkullim nga gjithsej të furnizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2023)


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu edhe përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2022, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 2.39 milionë copë kartëmonedha të reja euro (12.5 përqind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara).

Grafik 68. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2023)

Grafik 69. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara (në përqindje)



Burimi: BQK (2023)

Rreth 94.6 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2022 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat komerciale me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme. Për më tepër, edhe të

gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim euro, me të cilat u furnizuan bankat komerciale ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për riqarkullim).

6.1.1 Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së.

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Edhe gjatë vitit 2022 sikurse në vitet paraprake, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit KIPS, duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


Tabela 24. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2018	2019	2020	2021	2022
Transaksionet me para të gatshme	+643,831	+965,364	+354,562	+1,119,117	+1,516,986
Depozita në para të gatshme	1,187,889	1,697,993	1,449,546	2,087,729	2,500,146
Terheqje të parave të gatshme	544,057	732,629	1,094,984	968,612	983,160
Transferet vendor	+1,050,203	+425,715	+70,305	+30,021	+34,037
Transferet vendor ardhës	1,882,670	693,428	110,763	76,421	92,164
Transferet vendor dales	832,467	267,714	40,458	46,400	58,127
Transferet ndërkombëtar	-642,864	-954,036	-424,086	-1,068,449	-1,444,209
Transferet ndërkombëtar ardhës	1,054,765	1,971,668	1,794,963	1,727,337	1,728,325
Transferet ndërkombëtar dales	1,697,629	2,925,705	2,219,049	2,795,786	3,172,534

Burimi: BQK (2023)


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2022 u kryen në emër të/dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të/dhe për llogari të AKP-së.

Grafik 70. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2023)

Grafik 71. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2023)

BQK-ja gjatë vitit 2022 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 11.30 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një rritje prej 15.4 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 9.60 mijë urdhërpagesa hyrëse (një rritje prej 16.3 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 58.13 milionë euro (një rritje prej 25.3 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse


vendore arrinin shumën mbi 92.16 milionë euro (një rritje prej 20.6 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për AKP-në.

Grafik 72. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri



Burimi: BQK (2023)


Grafik 73. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2023)


Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse siguruesit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

Grafik 74. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2023)


Grafik 75. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse, shuma



Burimi: BQK (2023)


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për llogari të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferët e fondeve të bankave komerciale dhe Trustit Pensional të Kosovës.

Grafik 76. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, numri



Burimi: BQK (2023)

Grafik 77. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, shuma



Burimi: BQK (2023)

BQK-ja gjatë vitit 2022 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 2,451 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rritje prej 4.97 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 1,607 urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rritje prej 83.9 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare kapnin shumën prej mbi 3.17 miliardë euro (një rritje prej 13.5 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare kapnin shumën mbi 1.73 miliardë euro (një rritje e lehte prej 0.06 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Më 31 dhjetor 2022, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej 419.66 milionë euro ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 165.85 milionë euro. Së bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 45.5 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2022.

Tabela 25. Niveli i depozitave klientëve kryesorë (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2018	2019	2020	2021	2022
Gjithsej gjendja	1,217,914	1,187,685	1,214,559	1,275,801	1,288,150
Institucionet Qeveritare	374,663	444,301	316,897	423,322	419,664
Agjencia Kosovare e Privatizimit	388,116	275,160	191,457	184,737	165,854
Bankat Komeriale + Kompanitë e Sigurimeve	347,931	419,659	571,114	593,910	575,043
Të tjera	107,205	48,566	135,091	73,832	127,589

Burimi: BQK (2023)

Bankat komerciale dhe siguruesit kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e depozitave në BQK. Këto depozita kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore dhe rregullatore të bankave komerciale dhe siguruesve. Ato përbënin 44.6 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2022. Më 31 dhjetor 2022, depozitat e bankave komerciale dhe siguruesve ishin në shumën prej 575.04 milionë euro.

6.2. Sistemi i Pagesave

Ofrimi i sistemeve të pagesave të sigurta dhe efikase është një ndër objektivat kryesore të BQK-së. Sistemi i pagesave ndërbankare, i ndërtuar dhe nën administrimin e BQK-së, gjatë vitit 2022 ka siguruar disponueshmëri maksimale, duke garantuar procesimin dhe shlyerjen e pagesave për të gjithë akterët ekonomik të vendit. Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti, përveç operimit të sistemit ndërbankar të pagesave, BQK i kushton vëmendje të veçantë edhe rolit mbikëqyrës dhe katalizator të mirëmbajtjes së sigurisë së sistemit dhe zhvillimit të mëtejshëm të tregut të pagesave, duke implementuar në këtë drejtim edhe Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël 2021-2026.

Numri i pagesave elektronike ka vijuar me rritje domethënëse edhe gjatë vitit 2022, ku pagesat përmes shërbimit e-banking u rriten për 16.5 përqind në vëllim dhe rreth 29.5 përqind në vlerë. Rritje të rëndësishme patën edhe pagesat me kartelë ku kishin një rritje për 41 përqind të vëllimit dhe 35.3 përqind të vlerës në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu, gjatë 2022 kishte një dyfishim të llogarive dhe transaksioneve të parasë elektronike të ofruara nga institucionet financiare jobankare të regjistruara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe parave elektronike. Kjo rritje është mbështetur edhe me anë të ndryshimeve të fundit rregullative të realizuara në kuadër të Programit për Pagesat dhe Remitancat (RPP) nën udhëheqjen e Ekipit të Bankës Botërore, si dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së konkurrencës të mundësuar me anë të këtyre ndryshimeve të kornizës rregullative përgjatë viteve të fundit.


Gjatë vitit 2022, tregut të pagesave të Kosovës i është shtuar edhe një bankë e re, si pjesëmarrës i drejtpërdrejt në sistemin e pagesave ndërbankare (SPN), si dhe një IFJB e regjistruar për

emetimin e parave elektronike dhe ofrimin e shërbimeve të pagesave, përmes të cilave pritet një zgjerim i mundësive për pagesat elektronike dhe rritje e konkurrencës në ofrimin e shërbimeve të pagesave.

6.2.1 Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare


Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN) i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa. Grafikët në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes SPN-së për periudhat përkatëse.

Grafik 78. Numri i transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2023)

Grafik 79. Vlera e transaksioneve në SPN (në mijëra)




Burimi: BQK (2023)

Treguesit statistikore të aktivitetit të SPN-së kanë reflektuar me një rritje të transaksioneve në vëllim për 19.2 përqind dhe në vlerë për 18.6 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku gjatë vitit 2022 janë procesuar 17.4 milionë transaksione me vlerë totale mbi 20 miliardë euro.


Në kuadër të SPN-së realizohen pagesat përmes dy komponentëve: RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10 mijë euro, si dhe pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve, ndërsa në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro ku përfshihen këto lloje të pagesave: pagesat e rregullta-normale, pagesat masive, pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro dhe Debitimi Direkt. Krahasimi i vëllimit dhe vlerës së këtyre kategorive të pagesave për vitet e caktuara është paraqitur në grafikët në vijim.

Grafik 80. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2023)

Grafik 81. Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre (në mijëra)




Burimi: BQK (2023)

Pagesat e rregullta (normale dhe masive) përbëjnë rreth 46.2 përqind të vëllimit dhe 17.2 përqind të vlerës së transaksioneve të SPN-së. Transaksionet RTGS, procedohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2022 numri i tyre përbënte mbi 3.1 përqind


të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në SPN, ndërsa vlera e tyre rreth 44.5 përqind të vlerës së transaksioneve përmes SPN-së.

Në kategorinë e pagesave për paga/pensione kemi një rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve, nëse marrim për krahasim vitin paraprak, kemi rritje prej 38 përqind në numër dhe 13.3 përqind në vlerë të transaksioneve. Krahas rritjes në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve në krahasim me vitin paraprak, nga grafikët në vazhdim vërehet një rritje edhe e mesatares ditore të transaksioneve të procesuara, si në vëllim ashtu edhe në vlerë, prej 20 përqind respektivisht 19 përqind.

Grafik 82. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN




Grafik 83. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN




Pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes sistemit ACH gjatë vitit 2022, sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë dhe të dytë të kliringut, krahasuar me sesionin e fundit. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave, prandaj aplikohen tarifa më të ulëta për transaksionet e procesuara në dy sesionet e para.

Grafik 84. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Grafik 85. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SPN gjatë vitit 2022 ka qenë afër 20.3 miliardë euro, ku përfshihen transaksionet e të gjithë pjesëmarrësve, përfshirë edhe Thesarin. Nga vëllimi dhe vlera e transaksioneve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në sistem, tre pjesëmarrësit me numrin më të madh të transfereve të iniciuara zënë 60.9 përqind të vëllimit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë pjesëmarrësit tjerë zënë 39.1 përqind.

Sa i përket vlerës të transfereve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse, nga vlera e përgjithshme e tyre prej 20.3 miliardë transaksione, tri institucionet e para pjesëmarrëse në sistem me vlerën më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 42.1 përqind të vlerës të përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 57.9 përqind.


Tabela 26. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN

Sistemi SPN	Vëllimi	Vlera
3 pjesëmarrës në sistem	60.90%	42.10%
17 pjesëmarrësit e tjerë	39.10%	57.90%
Gjithsejt	17,453,703	20,334,977,252

Burimi: BQK (2023)

Huaja brenda-ditore për likuiditet - nënkupton një hua të kolateralizuar që BQK ofron për bankat pjesëmarrëse brenda orarit të punës së SPN-së, duke përdorur letrat me vlerë të Qeverisë si kolateral, kur bilanci i një banke në llogarinë e saj në BQK është i pamjaftueshëm për të procesuar urdhërpagesat.

Raporti i vlerës së Huasë brenda-ditore për likuiditet ndaj vlerës totale të aktivitetit të sistemit RTGS për vitin 2022 rezulton në 4.1 përqind, duke reflektuar një peshë të ulët të nevojës së financimit të aktivitetit të këtij sistemi me likuiditet nga BQK-ja, rrjedhimisht të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.

Grafik 86. Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit të vlerës së shlyer në RTGS

Burimi: BQK (2023)

6.2.2. Regjistri i Llogarive Bankare

Në kuadër të funksioneve operacionale, rol të rëndësishëm zë edhe regjistri i llogarive bankare. Ky regjistër përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale), si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve përmbarimore nga organet e përmbarimit dhe institucionet e tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për procedurën përmbarimore. Ky regjistër ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit në procedimin e lëndëve përmbarimore nga organet e procedurës përmbarimore, sidomos pas zgjerimit të funksioneve për mundësimin e procedimit elektronik të vendimeve përmbarimore.

Në regjistrin e llogarive bankare gjatë vitit raportues kanë pasur qasje 47 përmbarues privatë, 114 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 12 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit kanë shkëmbyer me bankat komerciale 22,066 raste të procedurës përmbarimore, prej të cilave 16,678 janë mbyllur.

Tabela 27. Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare

Statusi i rasteve	2021	2022	Në ngritje/Në rënje (%)
Të hapura	23,078	22,066	-4.39%
Të mbyllura	15,349	16,678	8.66%

Burimi: BQK (2023)

6.2.3 Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Në funksionin e mbikëqyrjes dhe të reformimit të sistemeve të pagesave, BQK në fund të vitit 2022, ka zhvilluar diskutime të gjera me akterët e tregut të sistemeve të pagesave. Në këtë drejtim ka filluar procesin e avancimit të mëtejshëm të statistikave lidhur me llojet dhe instrumentet e pagesave. Si rezultat, është bërë edhe rishikimi i rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave dhe rishikimi i raporteve mujore për institucionet e parasë elektronike, me qëllim të përfshirjes së instrumenteve dhe formave të reja të pagesave në kuadër të analizave të sistemit të pagesave, si dhe mbështetjes së vendimmarrjes strategjike për zhvillimet në fushën e pagesave.

Në funksion të fuqizimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, është punuar edhe në amandamentimin e Politikës së Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave, nën mbështetjen e ekspertëve të Bankës Botërore në kuadër të programit të RPP-së. Fokusi i ndryshimeve të reja do të jetë në fuqizimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave me vlerë të vogël dhe identifikimit të rreziqeve që ndërlidhen me shërbimet dhe instrumentet e reja të pagesave duke zgjeruar kështu fushëveprimin dhe monitorimin ndaj institucioneve të reja të cilat ofrojnë shërbime të pagesave dhe parave elektronike.


Gjatë vitit 2022 është rishikuar analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë, e cila përveç informacioneve që kanë të bëjnë me shpërndarjen socio-demografike të kartelave të cilat përdoren nga qytetarët e Kosovës dhe faktorëve relevantë të cilët kanë ndikuar në shpërndarjen e tillë, përfshin edhe informacionet lidhur me llojet e kartelave, përdorimin e kartelave në terminale të ndryshme, përfshirë ato online. Analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë publikohet në baza të rregullta vjetore në faqen zyrtare të internetit të BQK-së.

Gjithashtu, në kuadër të përgatitjes së analizave dhe raporteve për statistikën e pagesave, janë përgatitur dhe publikuar raportet e rregullta vjetore dhe mujore lidhur me numrin dhe vlerën e pagesave të sistemit të pagesave ndërbankare, mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat, mbi instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme, si dhe raporti krahasues mbi instrumentet e pagesave elektronike (Kosova në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore) të cilat publikohen në faqen zyrtare të internetit të BQK-së.

6.2.4 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2022 numri i kartelave të debitit arriti mbi 1.3 milionë ndërsa numri i kartelave të kreditit arriti në 181 mijë. Krahasuar me një vit më parë, konstatohet se numri i kartelave të debitit është rritur për 2.0 përqind, ndërsa te numri i kartelave të kreditit është vërejtur një rritje prej 3.0 përqind.

Grafik 87. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2023)


Grafik 88. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2023)


Sa i përket infrastrukturës së terminaleve, shihet se ka pasur rritje të bankomatëve / ATM në vitin e fundit në krahasim me vitin paraprak, gjithashtu është shënuar rritje e lehtë e numrit të terminaleve në pikat e shitjes / POS gjatë vitit 2022.

Grafik 89. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2023)


Grafik 90. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2023)


Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, nga të dhënat statistikore shihet se viti 2022 është karakterizuar edhe me rritje të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Grafik 91. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2023)

Grafik 92. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave




Burimi: BQK (2023)

Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit të internetit/e-banking arriti në 8.3 milionë transaksione, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 16.5 përqind, ndërsa vlera e tyre arriti në 18.9 miliardë euro, me rritje vjetore prej 29.5 përqind.

Viti 2022 po ashtu u karakterizua me një trend në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në pikat e shitjeve / POS është rritur për 41.0 përqind, ndërsa vlera ka shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak me rreth 35.3 përqind. Tërheqjet në bankomate / ATM tregojnë për rritje sa i përket numrit dhe vlerës së tyre, krahasuar me vitin paraprak. Numri i tërheqjeve në bankomate / ATM është rritur për 7.8 përqind, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 13.8 përqind.

Grafik 93. Numri i transfereve të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër



Burimi: BQK (2023)

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2022, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve arriti rreth 2.37 milionë, që paraqet një rënie të lehtë prej 0.5 përqind

krahasuar me fundin e vitit 2021. Rreth 98.5 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.5 përqind janë të jorezidentëve.

Rritja e pagesave elektronike përgjatë viteve reflektohet edhe në mënyrën e realizimit të transfereve të kreditit. Transferet në formë letër vazhdimisht janë në rënie, kundrejt atyre në formë elektronike. Gjatë vitit 2022, transferet e iniciuara në formë letre përbënin 18 përqind, ndërsa ato në formë elektronike përbënin 82 përqind të gjithsej transfereve të iniciuara nëpërmjet bankave.

Nga totali i llogarive në fund të vitit 2022, mbi 688 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti. Kjo paraqet një rritje rreth 28 përqind të llogarive me qasje nga distanca.

Tabela 28. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022
Llogaritë e klientëve (1+2)	2,292,172	2,384,742	2,371,544	411,346	537,733	688,891
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.57%	98.57%	98.50%	98.22%	98.50%	98.29%
a-Individuale (%)	92.71%	92.97%	91.73%	86.63%	87.98%	89.54%
b-afariste (%)	7.29%	7.03%	8.27%	13.37%	12.02%	10.46%
2-Llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1.43%	1.41%	1.50%	1.78%	1.50%	1.71%
c-Individuale (%)	98.79%	98.99%	98.95%	93.66%	97.83%	91.55%
d-afariste (%)	1.21%	1.01%	1.05%	6.34%	2.17%	8.45%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve"

Pjesëmarrja e llogarive me qasje në internet, gjatë viteve të fundit ka shënuar rritje të vazhdueshme.

Grafiku 94 tregon pjesëmarrjen e llogarive me qasje në internet, në numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse gjatë pesë viteve të fundit. Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka vazhduar me një trend në rritje dhe inkurajues mbetet trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Institucionet financiare jobankare të regjistruara për emetimin e parasë elektronike, në fund të vitit 2022 kanë raportuar për 25,554 llogari të parasë elektronike, që shënon një rritje të shpejtë duke u bazuar se ky është vetëm viti i tretë i operimit të tyre në treg.


Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej afërsisht 300 mijë pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 70 milionë euro.

Tabela 29. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi i llogarisë	2021	2022
Llogaritë e parave elektronike (E-money accounts)	11,543	25,164

Burimi: BQK (2023)

Grafik 94. Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse



Burimi: BQK (2023)

Tabela 30. Numri dhe vlera pagesave të parave elektronike

Përshkrimi	2021	2022
Numri	52,779	278,538
Vlera	29,170,803	69,939,744

Burimi: BQK (2023)

Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet me ndikim edhe në zgjerimin e përfshirjes financiare të qytetarëve duke mundësuar qasjen në shërbimet e pagesave (hapjen e një llogarie paraje elektronike/llogarie pagese dhe zotërimin e një karteletë me parapagim) nga kategori të popullsisë pa qasje në shërbime bankare, si për shembull kategoritë që nuk janë të punësuar. Realizimi i transaksioneve elektronike konsiderohet edhe si dritarja kryesore që mund të ju lehtësoj qasjen në kredi dhe shërbime tjera financiare.

6.2.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave

Në kuadër të rolit të saj si katalizator i sistemit të pagesave, BQK ka vijuar reformat për modernizimin dhe zgjerimin e tregut të pagesave dhe ka ndërmarr disa aktivitete sa i përket zhvillimit dhe reformimit të mëtejshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve të pagesave. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2022, janë miratuar amandamentimet e rregullores për instrumentet e pagesave elektronike përmes të cilave janë adaptuar kërkesat e Rregullores së BE-së 2015/751 mbi tarifën e shkëmbimit për pagesat me kartelë. Qëllimi i këtyre plotësimeve është kufizimi i tarifave të shkëmbimit sipas standardeve të BE-së, me qëllim të ndikimit në uljen e kostos ndaj tregtarëve për pranimin e pagesave me kartelë për të mundësuar një kosto më të ulët edhe për tregtarët e vegjël me pakicë. Gjithashtu, ndryshimet e reja kërkojnë rritjen e transparencës sa i përket kostove të aplikuara ndaj tregtarëve nga ana e bankave që ofrojnë shërbimin e pranimit të pagesave me kartelë, për të ju mundësuar krahasimin më të lehtë të shërbimeve të ofruara nga bankat e ndryshme.

Në funksion të adresimit të rekomandimeve të misionit të Bankës Botërore në Kosovë në kuadër të Modullit të Zhvillimit të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), që ndërlidhen me sistemin e pagesave ndërbankare dhe kërkesave të bankave, si dhe çështjeve të identifikuara përgjatë operimit të sistemit SPN që nga funksionalizimi i tij në korrik 2016 në nevojë për qartësim dhe rregullim shtesë, është bërë edhe plotësimi i rregullores për Sistemin e Pagesave Ndërbankare.

Gjithashtu, me qëllim të mbledhjes së të dhënave statistikore për shërbimet e reja të pagesave, gjithnjë në zhvillim, siç janë pagesat përmes aplikacioneve të telefonave mobil, pagesat me kartelë përmes kuletave digjitale, si dhe forma të reja të pagesave, është bërë plotësimi i rregullores për statistikën e instrumenteve të pagesave.

Këto aktivitete janë realizuar kryesisht në kuadër të programit RPP me mbështetjen e ekspertëve të Bankës Botërore, në funksion të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (2021-2026). Në zbatim të strategjisë, BQK në kuadër të programit RPP ka vazhduar me draftimin e Ligjit për shërbimet e pagesave, përmes të cilit do të transpozohen në legjislacionin vendor tri direktivat e Bashkimit Evropian të rëndësishme për shërbimet e pagesave: Direktiva për shërbimet e pagesave e njohur si PSD2, Direktiva për llogaritë e pagesave dhe Direktiva për institucionet e parave elektronike. Adaptimi i këtyre direktivave në tregun vendor vlerësohet se do të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave, në rritjen e transparencës dhe sigurisë në shërbimet e ofruara nga tregu dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Përafrimi i praktikave të rregullimit të tregut të shërbimeve të pagesave me ato evropiane përbën edhe një hap themelor në lidhje me integrimin

dhe zbatimin e rekomandimeve në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe anëtarësimin në skemën e vetme të pagesave në euro të njohur si SEPA (Single Euro Payments Area).

6.2.6 Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe në nivel ndërkombëtar

Gjatë vitit 2022, në kuadër të bashkëpunimit në Projektin për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, nën udhëheqjen e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC – Regional Cooperation Council), janë zhvilluar konsultimet e nevojshme lidhur me fazën e dytë të projektit që synon mbështetjen në aspektin rregullativ dhe infrastrukturor me qëllim mundësimin e pagesave të shpejta dhe efikase ndërkufitare në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndërmjet tyre dhe BE-së, si dhe për përgatitjen e vendeve të rajonit për anëtarësim në skemën e pagesave në BE të njohur si SEPA.

BQK është angazhuar gjithashtu në mbështetjen e Thesarit, ASHI-së dhe akterët tjerë relevant në ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave. Në veçanti lidhur me projektin për mundësimin e pagesave elektronike nëpërmjet portalit të shërbimeve qeveritare e-Kosova. Gjithashtu, BQK ka organizuar takime dhe ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimeve të pagesave, përfshirë bankat dhe Shoqatën e Bankave, si dhe IFJB-të e regjistruara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe të parave elektronike, me qëllim nxitjen e zhvillimit të tregut të sistemeve dhe shërbimeve të pagesave, nëpërmjet organizimit të diskutimeve mbi zhvillimet më të fundit, si dhe përditësimet e nevojshme të kornizës rregullative, për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e sistemeve dhe shërbimeve të pagesave.

6.3. Menaxhimi i Mjeteve

Banka Qendrore e Kosovës realizon investimin e rezervave dhe operimin e sistemit qendror depozitar (CSD) për tregtimin e Letrave me Vlerë të emetuara nga Republika e Kosovës. Detyrat e menaxhimit të rezervave janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-209.

6.3.1. Menaxhimi i Investimeve

Banka Qendrore menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv, ku prioritet kanë siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet.

Instrumentet


Rezervat në portofolin e BQK-së përbëhen nga instrumentet e portofolit që klasifikohen si likuide dhe me gradë investuese. Kategorizimin likuid të rezervave e përbëjnë instrumentet që mirëmbahen për të siguruar mjete të mjaftueshme për kryerjen e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitorëve të saj. Nga ana tjetër kategorizimin investues e përmbushin instrumentet financiare të sigurta me vlerësim kreditor investiv që gjithashtu janë lehtësisht të tregtueshme.

Portfolio e rezervave në euro të BQK-së sipas instrumenteve është pasqyruar në grafikun 95 të gjendjes me 31 dhjetor 2022, ku kemi 47.9 përqind të portofolit në letra me vlerë ndërkombëtare dhe 20.5 përqind e portfolios nga letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për të siguruar mjaftueshmëri të fondeve për transferet ndërkombëtare të depozitarëve të BQK-së, mjetet në llogarinë rrjedhëse mirëmbahen për të realizuar obligimet afatshkurtëra të BQK-së të cilat për periudhën raportuese përbëjnë nivelin prej 21.7 përqind të portofolit. Rreth 10 përqind është plasuar në depozita bankare në mënyrë që të sigurohet shpërndarje adekuate sipas instrumenteve afatshkurtra.

Portofolin investues të rezervës së BQK-së në të gjitha valutat e përbëjnë këto instrumente financiare:

- depozitat bankare me afat, të plasuara në bankat evropiane me rangim adekuat investues, marrëveshjet afatshkurtëra të riblerjes të plasuara me bankat vendore apo Rezervën Federale të SHBA-së;
- letrat me vlerë ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, komunale, supranacionale, agjencive shtetërore apo institucioneve kreditore në euro dhe dollarë me afat deri në shtatë vite;
- obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në shtatë vite.

Grafik 95. Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2022




Burimi: BQK (2023)

Gjithashtu, përgjatë vitit 2022 kanë vazhduar plasmanët në marrëveshjet afatshkurtra të riblerjes (Repo) me bankat komerciale të Republikës së Kosovës si një instrument i rëndësishëm i tregut të parasë. Përmes këtij instrumenti, BQK u ofron likuiditet të shpejtë bankave vendore në rast nevojë për periudhë prej një deri në dhjetë ditë kundrejt kolateralit, respektivisht letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Po ashtu ky instrument u ndihmon obligacioneve qeveritare të trajtohen si instrumente më likuide, duke u ofruar mbajtësve të tyre qasje të lehtë në financim përmes kolateralit.


Sikurse në vitin paraprak, BQK gjatë vitit 2022 ka vazhduar të jetë pjesë e linjës kreditore të ofruar nga Eurosistemi përmes Deutsche Bundesbank. Përmes kësaj linje kreditore, Banka Qendrore Evropiane i ka ofruar mundësinë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të marrë hua nga pakaja e likuiditetit të Eurosistemit kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga letra me vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Kjo linjë kreditore adreson nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave eventuale, duke i mundësuar

Grafik 96. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në EUR (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2023)

Grafik 97. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2023)

hua deri në 100 milion euro nga Banka Qendrore


Evropiane. Linja kreditore do të qëndrojë në fuqi deri në mes të muajit janar 2024, me mundësi të zgjatjes së afatit.

Valutat

Përbërja valutore e portfolios së rezervave të BQK-së konsiston në euro dhe dollar amerikan. Siç shihet në grafikun 96 euro rezervat në dispozicion në portfolion e BQK-së kanë shënuar ngritje në 951 milion euro në vitin 2022 nga 774 milionë të vitit paraprak, për shkak të lëvizjeve të fondeve të depozitarëve të BQK-së.

Afërsisht 1 përqind e portfoliut të rezervave mbahet në dollar amerikan të investuara në plasmane një-ditore me normën e interesit të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Rezervën Federale të SHBA-ve dhe letra me vlerë afatshkurtëra të emetuara dhe paguara nga Thesari Amerikan me afat maturimi deri në një vit në kuadër të programit automatik të investimeve me Rezervën Federale (Automatic Investment Programme). Në vitin 2022 nuk ka ndryshim të konsiderueshëm në nivelin e rezervave në USD, me një ngritje të lehtë nga 10.37 milionë që ishte në vitin 2021 në 10.47 milionë në vitin 2022 siç shihet në grafikun 97 që vjen si rezultat i akumulimit të interesave. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të BQK-së nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht vijnë dhe mbahen në valutën euro.

Grafik 98. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portfoliut në EUR të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2023)

Shpërndarja

Shpërndarja e investimeve në portfolin e rezervave sipas Politikës së Investimeve realizohet në lloje instrumentesh dhe emetuesish të ndryshëm në mënyrë që të minimizohet rreziku i koncentrimin.

Gjatë vitit 2022 shpërndarja e portfoliut është realizuar me fokus në kategorinë e aseteve shumë likuide, lehtësisht të konvertueshme dhe me treg të zhvilluar siç janë letrat me vlerë – bonot e thesarit dhe obligacionet. Rrjedhimisht letrat me vlerë përbëjnë instrumentet kryesore me pjesëmarrjen më të lartë në portfolin e BQK-së si instrumente likuide, të pasqyruar në grafikun 98.

Në portfolin e letrave me vlerë rëndësi të veçantë i kushtohet shpërndarjes gjeografike, shpërndarjes sipas emetuesve dhe kushtit që këto letra të njihen si kolateral i pranueshëm nga Banka Qendrore Evropiane. Sikurse në vitin paraprak, shpërndarja e portfoliut të BQK-së në letra me vlerë është diktuar edhe nga çmimet e obligacioneve në treg dhe ofertën e tregut për obligacionet qeveritare, supranacionale, agjencive dhe institucioneve kreditore të emetuara dhe paguara në Euro.

Për shkak të normave negative në Euro-sistem që kanë vazhduar deri në Korrik 2022 kemi një shpërndarje më të lartë në llogari rrjedhëse dhe më pak në depozita bankare. Pas ngritjes së normave në korrik-gusht është rritur gradualisht edhe shpërndarja në depozita bankare duke e zvogëluar njëkohësisht nivelin e mjeteve në llogari rrjedhëse. Norma depozitare në tregun ndërbankar në euro bazohet në normën e vendosur nga Banka Qendrore Evropiane për depozita e

cila gjatë vitit 2022 ka variuar nga -0.5% prej janarit deri në korrik dhe nga 0% deri në rreth 2% në dhjetor 2022¹⁶.

Në vitin 2022 shpërndarja në letra me vlerë ka mbetur relativisht e njëjtë me vitin paraprak, siç shihet në grafikun 99. Ndryshimin kryesor në strukturën e shpërndarjes së portofolit e shohim tek depozitat bankare ku kjo kategori asetesh ka shënuar ngritje, si rezultat i ngritjes së normës depozitare nga Banka Qendrore Evropiane dhe mundësive për plasmane në tregun ndërbankar. Kjo shpërndarje i mundëson BQK-së që të mbajë likuiditetin të mjaftueshëm në portfolion e saj të rezervave, njëkohësisht duke kontribuar në ruajtjen e sigurisë së portofolios dhe realizimit të kthimit nga investimi nga kjo kategori e asetëve.

6.3.2. Performanca e portofolit

Instrumentet në portfolion e BQK-së kanë performuar mirë duke realizuar 6.05 milion euro të hyra neto nga të gjitha kategoritë e investimeve, përfshirë diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve nga normat depozitare të aplikuar ndaj llogarive.

6.3.3. Menaxhimi i Rrezikut

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet, agjencitë më kredibile të eurozonës dhe institucionet supranacionale me vlerësim kreditor investiv sipas vlerësimeve nga agjencitë kreditore ndërkombëtare: Standard & Poor's dhe Moody's, si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.


Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit, rreziku valutor dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor - Portofoli i investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

Rreziku i normës së interesit - menaxhimi i rrezikut të normave të interesit nga BQK kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standardë dhe jostandardë të normave të interesit.

Rreziku i likuiditetit - është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë likuiditetin të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Grafik 99. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK (2023)

¹⁶ https://www.ecb.europa.eu/stats/policy_and_exchange_rates/key_ecb_interest_rates/html/index.en.html


Rreziku valutor - paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar, ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor.

Rreziku operacional - është rreziku i përmbushjes që ka të bëjë me plasmanin e depozitave, tregtimin e letrave me vlerë dhe pagesën me kohë të tyre.


6.3.4. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike, BQK-ja vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në procesin e emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Grafik 100. Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit



Grafik 101. Struktura e investitorëve në ankande




Sipas kalendarit vjetor të emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë dhe të publikuar nga Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Sistemit të Regjistrimit Kontabël për Letra me Vlerë gjatë vitit janë realizuar gjithsej 12 ankande për emetimin e obligacioneve qeveritare me afat maturimi nga dy vite deri dhjetë vite.

Në grafikun 100 paraqitet struktura e Letrave me Vlerë të emetuara në tregun primar të Letrave me Vlerë të Qeverisë gjatë vitit, e shprehur në përqindje dhe sipas afatit të maturimit, ku shohim që afër gjysma e emetimeve janë me afat maturimi 5 vjeçar. Grafiku 101 paraqet pjesëmarrjen në ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë në tregun primar të ndara sipas kategorisë së investitorit¹⁷.

Në grafikun 102 shohim normat mesatare vjetore të kthimit në investim të ndara sipas maturitetit që mbeten në nivel të përafërt krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në grafikun 103 janë paraqitur të gjitha ankandet e realizuara gjatë vitit, ku shihet se kërkesa më e madhe e tregut ishte për obligacione qeveritare me afat maturimi tre vite dhe pesë vite.


Figura 102. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2021 dhe 2022, në përqindje



¹⁷ Pjesëmarrës në tregun primar të Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit si dhe personat juridikë dhe fizikë duke vepruar përmes bankave komerciale.

Gjithsej vëllimi i transaksioneve të shitblerjeve dhe riblerjeve në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit rezultoi me 242.1 milionë euro krahasuar me gjithsej vëllimin e vitit paraprak prej 203.4 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 19.5 përqind. Vëllimi i transaksioneve të shitblerjeve¹⁸ të letrave me vlerë të Qeverisë ndërmjet pjesëmarrësve gjatë vitit rezultoi me 94.8 milionë euro krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 120.7 milionë euro, duke shënuar një rënie prej 21.6 përqind.

Figura 103. Ankandet e letrave me vlerë të qeverisë në vitin 2022



Burimi: BQK (2023)

Për qëllime të huadhënies afatshkurtër, gjithsej vëllimi i transaksioneve të riblerjeve të mbështetur në kolateral me Letra me Vlerë të Qeverisë gjatë vitit rezultoi me 147.3 milionë euro, krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 82.6 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 78.3 përqind.

Me qëllim të menaxhimit sa më efikas të likuiditetit afatshkurtër të sektorit bankar, vëllimi i kërkesave të sektorit bankar me BQK, bazuar në huadhënien brenda-ditore të mbështetur me kolateral me Letra me Vlerë të Qeverisë ishte gjithsej 557.1 milionë euro.

6.4. Teknologjia Informative

Edhe gjatë vitit 2022, BQK-ja ka vazhduar me avancimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, duke i dhënë fokus të veçantë ngritjes së sigurisë së informacionit dhe shërbimeve të ofruara.

Për të garantuar vazhdimësi dhe cilësi të shërbimeve që BQK-ja ofron për institucionet financiare, qeveritare dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, është investuar në përditësimin, zgjerimin dhe avancimin e kapaciteteve ekzistuese të teknologjisë informative, duke futur në punë pajisjet e teknologjisë së fundit.

Gjatë këtij viti, janë zhvilluar edhe një numër i madh i formave të reja të raportimit të institucioneve financiare, me të cilat informacione lehtësohet dhe bëhet më cilësore mbikëqyrja e këtyre institucioneve nga ana e BQK-së, si institucion mbikëqyrës. Projekt tjetër me rëndësi gjatë këtij viti është edhe avancimi i mëtutjeshëm i platformës elektronike moderne të Ankesave të Shfrytëzuesve të Shërbimeve Financiare, e cila u mundëson qytetarëve t'i paraqesin ankesat online, si dhe informon ankuesit për statusin e lëndës deri në përmbyllje me këthim të përgjigjes.

Po ashtu, është punuar në vazhdimësi për avancimin e shërbimeve dhe proceseve të punës, si dhe në zhvillimin e projekteve të reja. Si projekt që do t'i shërbejë avancimit të proceseve të brendshme që vlen të përmendet është zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Rrezikut, i cili u mundëson stafit të brendshëm për raportimet e rregullta të rreziqeve operacionale dhe incidenteve të ndryshme që mund të ndodhin gjatë kryerjes së detyrave të përditshme. Me këtë sistem, tentohet që të identifikohen dhe të raportohen rreziqet eventuale operacionale në një kohë sa më të shkurtër, me qëllim që të merren masa në eliminimin e tyre, para se të kenë efekt në shërbimet që ofron Banka Qendrore. Janë zhvilluar edhe projekte tjera, të cilat lehtësojnë dhe avancojnë punët brenda vet institucionit.

¹⁸ Pjesëmarrës në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë ishin fondet pensionale, bankat komerciale personat fizikë dhe BQK.

6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, rregullojë, licencojë, regjistrojë dhe mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve kredidhënëse si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.


Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikrofinanciare të licencuara si dhe ato institucione financiare jobankare dhe sigurues të licencuar për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së aktualisht janë të regjistruar 2,130 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga e institucionet bankare me 1,571 përdorues aktiv, institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare vijojnë me 527 përdorues dhe në fund siguruesit me 32 përdorues aktiv të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2022, Regjistri i Kredive ka regjistruar 493 përdorues të ri.

Sistemi i Regjistrimit të Kredive është i dizajnuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke paraqitur një mjet të rëndësishëm për institucionet kredidhënëse në vlerësimin e rrezikut kreditor.


Sistemi i RKK-së është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse.

Grafik 104. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2023)

Figura 105. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2023)

Institucionet kredidhënëse në sistemin e RKK-së hulumtojnë mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2022 kap shifrën prej 1,009,083 hulumtime.

Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore, për vitet 2018 - 2022 është paraqitur në vijim në grafikun 104.


Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK-ja.

Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së, gjatë vitit 2022 janë raportuar 246,902 kredi ku përfshihen huat, kredit kartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore.

Raporti i numrit të kredive të regjistruara sipas llojit të institucionit kredidhënës për vitet 2018-2022 është paraqitur në vijim përmes grafikut 105.

Grafiku 106 paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve (fizikë / juridikë) bazuar nga të dhënat e sistemit të Regjistrimit të Kredive për vitet 2018 - 2022.

Grafik 106. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi BQK (2023)

6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivit primar të saj, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes monitorimit të rregullt të rrezikut sistemik, ndër të tjera, BQK bën identifikimin, monitorimin dhe analizimin e rrezikut sistemik në baza të rregullta tremujore. Në këtë kontekst, identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve ciklike dhe strukturore makroekonomike. Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre potencial në stabilitetin financiar dhe për pasojë stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, bëhet përmes analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative përfshirë analizimin e ecurisë së treguesve ekonomikë dhe financiarë me frekuencë të lartë, parashikimet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë dhe aplikimin e modeleve, që adresojnë dimensionin ciklik, strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik.

BQK-ja ka vazhduar të jetë e fokusuar në rritjen e vëllimit dhe cilësisë së analizave që shqyrtojnë zhvillimet kryesore makroekonomike në vend dhe atyre me fokus në vlerësimin e stabilitetit financiar. Përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij, me një perspektivë të analizave të bazuar në rrezik, BQK ka vazhduar të informojë publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, të rritë transparencën dhe nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar të vendit dhe infrastrukturës së tij.

Përveç analizave të ndryshme periodike dhe monitorimit të rregullt të treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës të ekonomisë, BQK ka vazhduar të azhurnojë modelet e zhvilluara për vlerësimin e rreziqeve, si modelin e Hartës së Stabilitetit Financiar (që analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar), modelin e stres-testit (një nga veglat kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin bankar dhe rreziqeve potenciale sistemike në vitin vijues), modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike (instrument tipik i politikës makroprudenciale i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistemik në tërë sistemin), si dhe modelin e Kapitalit Shtesë Kundërciklik (model

i politikës makroprudenciale). Në vitin 2022, në bashkëpunim me një asistencë të fokusuar teknike të FMN-së, BQK-ja ka filluar një proces tejet të rëndësishëm, për të rishikuar dhe avancuar një ndër veglat më të rëndësishme që ka një bankë qendrore për të vlerësuar stabilitetin e sektorit financiar – modelin e stres testit. Modeli që pritet të finalizohet gjatë vitit 2023 do të ndihmojë politikbërjen e BQK-së përmes rritjes së kapaciteteve për të vlerësuar dimensionet e rreziqeve që kanosin stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend. Gjithashtu, gjithmonë në funksion të avancimit të punës dhe ngritjes së kapaciteteve parashikuese dhe hulumtuese në BQK, ka filluar procesi i ndërtimit të modelit makroekonomik për BQK-në, model që pritet të finalizohet brenda vitit 2023.

Një ndër publikimet më të rëndësishme periodike është Raporti i Stabilitetit Financiar, raport që pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke analizuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike, së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit. Për t'i siguruar publikut qasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK-ja ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta edhe Vlerësimet Tremujore, raporte që ofrojnë një pasqyrë mbi zhvillimet kryesore makroekonomike dhe zhvillimet në të gjithë komponentët e sistemit financiar të ekonomisë në baza tremujore. Për më tepër, BQK-ja ka vazhduar të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar, raport që paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

BQK-ja ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar (AKB) me bankat komerciale në baza tremujore, anketë që përveç se ka ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, ka shërbyer edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomikë. Nga fundi i vitit 2020 dhe përgjatë vitit 2021, AKB është plotësuar edhe me seksionin që adreson pritjet e bankave komerciale për çmimet në vend, ndërkohë që seria kohore e pritjeve të bankave për dinamikat në inflacion publikohet edhe në faqen zyrtare të BQK-së.

Me interes të veçantë në vitin 2021 dhe tremujorit të parë të vitit 2022, BQK ka ndërmarrë angazhim të rëndësishëm për realizimin e studimit të Ngarkesës me Borxh të Ekonomive Familjare. Me qëllim të sigurimit të një mjedisi sa më të favorshëm për zhvillimin e sistemit financiar dhe mbështetjes së stabilitet të tij, BQK ka realizuar studimin e dytë me radhë për vlerësimin e ngarkesës me borxh të huamarrësve në sektorin financiar të Kosovës, përkatësisht ngarkesën me borxh të ekonomive familjare në Kosovë. Gjetjet dhe rekomandimet e studimit, që kryesisht kanë pasur të bëjnë me disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave, janë përfshirë në draft rregulloren e re për Regjistrin e Kredive në Kosovë.

6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2022

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK për përmbushjen e objektivave të saj mbledh, përpilon dhe publikon statistika dhe informacione tjera të nevojshme. BQK-ja është prodhuese dhe përdoruese kryesore e statistikave financiare të Republikës së Kosovës dhe një nga burimet kryesore të statistikave në nivel kombëtar. Në kuadër të mandatit ligjor të saj, BQK-ja përpilon dhe publikon statistikat e sektorit monetar, financiar, llogarive financiare dhe sektorit të jashtëm.

Për qëllime të përpilimit të statistikave, subjektet raportuese në BQK janë personat fizik dhe juridik përfshirë, institucionet financiare (bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, ndërmjetësit tjerë financiar dhe ndihmësit financiar), ndërmarrjet në pronësi të huaj, dogana e Kosovës, institucionet qeveritare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare dhe organizatat jofitimprurëse. Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK-ja respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që i siguron nga subjektet e ndryshme raportuese, të cilat i përdorë vetëm

për qëllime të përpilimit të statistikave. Informatat e siguruar nga raportuesit janë të nevojshme për të përpiluar statistikat monetare dhe financiare, statistikat e sektorit të jashtëm dhe llogarive financiare në kuadër të përgjegjësive ligjore të BQK-së. Këto të fundit burojnë nga Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Përpilimi i statistikave të lartpërmendura bëhet duke u bazuar në metodologjinë e rekomanduar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Banka Botërore, Eurostat dhe praktikatat më të mira të vendeve tjera.

Publikimi i statistikave bëhet sipas afatit të publikuar paraprakisht në faqen e internetit të BQK-së dhe në formate të ndryshme: seritë kohore, buletinin mujor statistikor, raportin vjetor, Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare, FMN, Eurostat, Banka Botërore, CEFTA, etj. Statistikat në përgjegjësinë e BQK-së sipas kërkesës përgatiten dhe shpërndahen për nevoja të njëjse organizative brenda BQK-së, si dhe për përdoruesit e jashtëm, si: institucionet qeveritare, mediat, organizata ndërkombëtare, universitetet dhe publiku i gjerë.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar përpilimin dhe publikimin e rregullt të statistikave në kuadër të fushëveprimit të saj në harmoni me kalendarin e publikimeve. Statistikat monetare dhe financiare përfshirë nën sektorët (banka qendrore, bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale, ndërmjetësit tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë) si dhe statistikat e sektorit të jashtëm (bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, borxhit i jashtëm) kanë vazhduar të publikohen rregullisht në faqen e internetit të BQK-së dhe organizatat ndërkombëtare. Moduli i ri i statistikave, ato të llogarive financiare janë kompletuar për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm dhe janë publikuar rregullisht në baza tremujore në faqen e internetit të BQK-së. Megjithatë janë edhe tre sektorë tjerë të ekonomisë të pambuluara, burimet e të dhënave për të cilët duhet të sigurohen në bashkëpunim me institucionet tjera relevante në vend. Në këtë drejtim, për të përcaktuar ndarjen e përgjegjësive institucionale, si edhe mekanizmat e bashkëpunimit për përgatitjen e llogarive financiare është në fazën finale arritja e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet BQK-së, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2022, BQK-ja ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të statistikave nën përgjegjësinë e saj me standardet e Bashkimi Evropian të përcaktuara me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Regionale (ESA 2010). Në baza të rregullta mujore janë raportuar statistikat mbi normat e interesit në Bankën Qendrore Evropiane (BQE), ndërsa në Eurostat në baza tremujore janë raportuar statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe në baza vjetore statistikat e investimet direkte dhe statistikat e tregtisë ndërkombëtare në shërbime. Tek transmetimi i të dhënave në Eurostat vlen të theksohet se gjatë vitit 2022 është avancuar metoda e përpilimit dhe validimit me rastin e raportimit duke implementuar rregullat e reja të validimit të dyfishtë të aplikuara nga sistemi i validimit në Eurostat. Gjatë vitit 2022, përmes asistencës teknike nga Eurostat, janë zhvilluar aktivitetet në drejtim të rritjes së kualitetit të përpilimit dhe shpërndarjes së të dhënave të shërbimeve në kuadër të projektit SP 2.1 International Trade in Services Statistics (ITSS). Gjatë vitit 2022 në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti është realizuar një mision i asistencës teknike nga Eurostat dhe një punëtori ku kanë marrë pjesë përfaqësues të Departamentit të Statistikës.

Gjatë vitit 2022 Departamenti i Statistikës është fokusuar në automatizimin e proceseve të punës duke; rritur efikasitetin dhe produktivitetin e realizimit të punëve të përditshme sidomos rreth pranimit dhe validimit të statistikave; zvogëluar punën manuale; zvogëluar gabimet e mundshme me rastin e pranimit të raporteve nga raportuesit dhe përpiluesit; etj. Nga ky automatizim është arritur që pothuajse të gjitha raportet në Departamentin e Statistikës tani e tutje të pranohen përmes sistemit, i cili mundëson validimin e të dhënave dhe mundësinë e përmirësimit para se ato

të pranohen nga zyrtarët e DS. Përveç kësaj, BQK-ja gjatë vitit 2022 është angazhuar në përmirësimin e cilësisë dhe konsistencës së të dhënave të prodhuara sipas standardeve dhe metodologjisë së rekomanduar nga Eurostat dhe FMN, përditësimin e metodikës së publikuar në faqen e internetit të BQK-së, publikimin e tabelave të reja në faqen e internetit të BQK-së, shkurtrimin e frekuencës së publikimit të treguesve statistikore, avancimin e metodave të procesimit dhe validimit të raporteve statistikore, mirëmbajtjen e faqes “Ekonomia e Kosovës në një shikim”, përpilimin dhe publikimin e kamatëvonesës në transaksionet tregtare dhe kreditore, përpilimin dhe raportimin e treguesve të shëndetit financiar, etj.

6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja

BQK-ja gjatë ushtrimit të kompetencave të veta mbikëqyrëse, vepron në pajtueshmëri me nenin 67 pika 4 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, para se të shqiptojë ndëshkime administrative, i ofron një deklaratë të detajuar subjektit/personit të cilit do ti shqiptohet ndëshkimi, duke përshkruar faktet dhe ligjin që mbështesin ekzistencën e shkeljes si dhe duke i dhënë mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente se pse ndëshkimi nuk do duhet ti shqiptohet.

Në deklaratën/Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative të dërguar nga BQK-ja, jepet edhe këshilla juridike, ku subjekti (institucioni financiar) informohet me të drejtën që brenda 15 ditësh kalendarike nga dita e pranimit të kësaj deklarate, mund të parashtojë kërkesë për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit të BQK-së. Në rast se subjekti (institucioni financiar) i mbikëqyrrur nga BQK-ja, vendos të ankohet, atëherë dërgon kërkesën në divizionin përkatës.

Ky divizion në vazhdimësi është koordinuar me mbikëqyrjen financiare lidhur me dërgimin e Njoftimit paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative nga BQK-ja tek subjekti (institucioni financiar), si parapërgatitje, në rast eventual të parashtrimit të kërkesave për rishqyrtim të këtyre institucioneve.

Gjatë vitit 2022 janë pranuar kërkesa për rishqyrtim nga dy subjekte (institucione financiare), të cilat janë shqyrtuar me kujdes dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore, si dhe është përgatitur raporti me rekomandimet përkatëse për vendimmarrje. Në baza të vazhdueshme janë përcjellë zhvillimet në kornizën ligjore me qëllim të identifikimit të nevojave për ndryshim të ndonjë dispozite që do të ndërlihej me çështjet e rishqyrtimit të kërkesave të pranuar nga institucionet financiare.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave është komunikuar me institucionet financiare që kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim dhe departamentet përkatëse në BQK, duke siguruar materialin e nevojshëm, sqarimet e mundshme si dhe duke arritur që kërkesat të shqyrtohen brenda afatit ligjor.

7. Zhvillimet e Brendshme

7.1. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion mjaft i rëndësishëm, i cili ofron siguri të arsyeshme për Bordin e Bankës Qendrore, Komitetin e Auditimit dhe Menaxhmentin e lartë, se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Auditimi i Brendshëm së bashku me auditimin e jashtëm përmbyllin zinxhirin e llogaridhënies brenda institucionit.

Korniza ligjore e BQK-së i ofron mandat të plotë AB-së që në mënyrë të pavarur të zhvilloj angazhime të auditimit me qëllim që t'i ofrojë Bordit të Bankës Qendrore, Komitetit të Auditimit dhe Menaxhmentit, rekomandime në funksion të rritjes së efikasitetit të kontroleve të brendshme dhe shtimit të vlerës në institucion.

Edhe gjatë vitit 2022, Auditimi i Brendshëm ka vazhduar angazhimet/auditimet konform Planit Vjetor. Ky dokument është ky i përgatitur duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Rreziqeve, sipas Qasjes së Bazuar në Rrezik. Ky Plan, fillimisht është diskutuar dhe ka marrë mbështetje nga Komiteti i Auditimit dhe i njëjti është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore.

Auditimet dhe angazhimet e kryera gjatë vitit 2022 ishin të natyrës: financiare, të pajtueshmërisë, operacionale dhe të teknologjisë informative. Këto aktivitete janë kryer duke iu referuar Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 61 të këtij ligji, si dhe Planit Vjetor të AB-së.

Fushëveprimi i AB-së ka vazhduar të jetë i orientuar në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemeve/proceseve të cilat e ndihmojnë Menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara. Përkundër mungesës së theksuar të stafit, si rrjedhojë e mos plotësimit të pozitave të lira, AB-ja përmes aktiviteteve/auditimeve të kryera, në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontroleve të brendshme, si dhe me qëllim të rritjes së vlerës së departamenteve/divizioneve dhe fushave tjera përgjegjëse në Bankën Qendrore ka dhënë gjithsej pesëdhjetë e një (51) rekomandime.

Konform kërkesave ligjore, AB-ja ka përgatitur Planin Vjetor 2023, të cilit i ka paraprirë përgatitja e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2023-2025. Në funksion të përmbushjes së kërkesave ligjore, Shefi i Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2022, e ka proceduar për diskutim tek organet përgjegjëse, Planin Vjetor 2023. Ky dokument, fillimisht është diskutuar dhe ka marrë mbështetje nga Komiteti i Auditimit. I njëjti, pas diskutimeve të nevojshme është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore.

Shefi i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022 ka vazhduar raportimin e tij të rregullt tek Bordi i Bankës Qendrore dhe Komiteti i Auditimit. Gjatë këtij viti janë mbajtur tetë (8) takime të Komitetit të Auditimit, ku pjesëmarrës ka qenë edhe Shefi i Auditimit të Brendshëm. Në këto takime, ndër të tjera është diskutuar mbi ecurinë e aktiviteteve të Auditimit të Brendshëm, me theks të veçantë lidhur me procesin e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve.

AB-ja ka vazhduar angazhimin lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme, si: Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar - Vlerësimi i Masave Mbrojtëse (Safeguards Assessment) dhe Auditorët e Jashtëm.

Aktivitetet rreth edukimit të vazhdueshëm profesional kanë vazhduar edhe gjatë këtij viti, përmes pjesëmarrjes së stafit të AB-së në disa trajnime dhe seminare, pjesa më e madhe e tyre në mënyrë virtuale. Departamenti i Auditimit të Brendshëm është i përfshirë në programin për forcimin e kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor, me qëllim integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, program ky i cili pritet të vazhdojë të implementohet edhe gjatë vitit 2023.

7.2. Burimet Njerëzore

Në zbatim të objektivave strategjike të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe politikave të administrimit të burimeve njerëzore, BQK-ja është fokusuar në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore që aplikohen në institucione të ngjashme.

Administrimi efektiv i burimeve njerëzore i kushton rëndësi të veçantë përshtatjes së infrastrukturës rregullative të institucionit me standardet më të mira, si dhe ofron mundësi për zhvillim dhe promovim për të gjithë punonjësit, duke synuar rritjen e profesionalizmit, performancës dhe motivimit të punonjësve.

Në fund të vitit 2022 numri i të punësuarve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ishte 228. Mosha mesatare e të punësuarve ka qenë 42 vite.

Përfaqësimi gjinor në nivel specialistësh dhe drejtuesish, është i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve është 54 - 46 përqind, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 38.3 - 61.7 përqind.

Në strukturën e përgjithshme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës 2 punonjës ose 0.9 përqind janë me PhD, 94 punonjës ose 41.2 përqind me edukim pasuniversitar, 109 punonjës ose 47.8 përqind me edukim universitar, 21 punonjës ose 9.2 përqind me edukim të mesëm dhe 2 punonjës ose 0.9 përqind me edukim bazik (grafiku 107.)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi, ekspertizë dhe ngritje profesionale adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas standardeve më të larta, për arritjen e potencialit të plotë të tyre, duke krijuar kushte për vijim të studimeve pasuniversitare si dhe përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, kurse, seminare, etj.


Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 140 punonjës ose 61.4 përqind e tyre kanë marrë pjesë në trajnime profesionale të cilat kryesisht janë organizuar online nga Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN, Joint Vienna Institute - JVI, Deutsche Bundesbank, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Banka e Francës, Banka e Italisë, Banka e Çekisë, Istanbul School of Central Banking, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe "Center of Excellence in Finance – CEF".

7.3. Aktiviteti Ligjor i BQK-së

Në zbatim të objektivave ligjore, gjatë vitit 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës-(BQK) është fokusuar në rishikimin dhe plotësim/ndryshimin e infrastrukturës ligjore, për mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së institucioneve financiare të licencuara nga kjo e fundit. Një veprimtari e tillë nga BQK-ja është ndërmarrë me qëllim të hartimit të një kornize të avancuar ligjore, në pajtim me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian si dhe standardeve të fundit ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit primar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe praktikave dhe standardet ndërkombëtare, dhe zbatimit të objektivave të BQK-së për ruajtjen dhe mbarëvajtjen e stabilitetit financiar janë hartuar projektligjet përkatëse si dhe janë bërë

Grafik 107. Struktura sipas edukimit



plotësim/ndryshimet e tyre, si në vijim: Projektligji për Banka dhe Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, të dyja këto projektligje të cilat ndodhen në organet qeveritare për procedim të mëtutjeshëm. Po ashtu, në proces të ndryshimeve të nevojshme është edhe Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, si dhe me asistencën e Bankës Botërore, ka vazhduar edhe procesi i hartimit të projektligjit për shërbimet e pagesave, i cili ka për qëllim të rregulloj shërbimet e pagesave që ofrohen në Kosovë, në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Për zbatimin e kërkesave ligjore përkatëse, organet vendimmarrëse të BQK-së kanë rishikuar dhe plotësuar legjislacionin sekondar për mbikëqyrje dhe rregullim të bankave dhe institucioneve jobankare, shërbimit të pagesave dhe përfituesve të fondeve pensionale, duke miratuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat paraprakisht, para miratimit të tyre, kanë qenë subjekt i shqyrtimit nga aspekti ligjor, në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria me kornizën ligjore në fuqi. Gjithashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësiave, organet vendimmarrëse kanë nxjerrë edhe vendime tjera, për rregullimin dhe mbajtjen stabil të sistemit financiar.

Gjatë këtij viti, është nxjerrë edhe vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar me të cilin është hedhë poshtë pretendimi i “Iute Credit” kundër Republikës së Kosovës, e me të cilin vendim është dëshmuar ligjshmëria e vendimeve të BQK-së, si një nga angazhimet kryesore drejt realizimit të detyrave me qëllim të arritjes së objektivave të caktuara me ligj.

Me qëllim të realizimit me efikasitet të detyrave lidhur me çështjet brenda fushave të kompetencave përkatëse ligjore, BQK është angazhuar edhe në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me institucione përkatëse, si vijon:

- Memorandum për implementimin e vendosjes së ngjitësve (stikersave), ndërmjet Bankës Qendrore, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ulja e automjeteve të paregjistruara në vend.

Në përgjithësi, edhe gjatë këtij viti, aktiviteti ligjor i BQK-së ka qenë i orientuar në drejtim të funksionimit në pajtim me kërkesat rregullative, e që ka mundësuar vazhdimin e funksionimit të sigurt dhe efektiv të sistemit financiar në Kosovë.

7.4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është i orientuar drejt arritjes së objektivave të Bankës Qendrore të përcaktuara me Ligj.

Korniza për menaxhimin e rrezikut dhe proceset mbështetëse janë dizajnuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të Bankës Qendrore, duke ofruar informacion të strukturuar dhe gjithëpërfshirës rreth asaj se si identifikohen rreziqet dhe menaxhohen/zvogëlohen këto rreziqe. Ky informacion ofrohet me kohë dhe ka për qëllim të ndihmojë vendimmarrjen. Korniza e përgjithshme për menaxhim të rrezikut definon llojet kryesore të rreziqeve të cilave ju ekspozohet dhe i menaxhon BQK-ja, siç janë ato strategjike, operationale dhe financiare. Pjesë e kornizës janë proceset për identifikim, analizë dhe vlerësim të rrezikut të cilat përcillen me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorohet niveli i tij sipas kuadrit rregullues në fuqi.

Zhvillimi i kornizës të menaxhimit të rrezikut në BQK-së mbështetet mbi parimet të cilat mundësojnë menaxhimin efektiv dhe efikas të rrezikut në arritjen e objektivave të saj. Parimet kryesore të cilat kanë ofruar udhëzime për zhvillim të saj janë: krijimi dhe ruajtja e vlerave të përcaktuara në orientimet strategjike dhe të jetësuar në angazhimet operative, integrimi i menaxhimit të rrezikut në strukturën qeverisëse dhe proceset institucionale dhe rezultatet e dala nga proceset e menaxhimit të rrezikut të përdoren për të ndihmuar vendimmarrjen drejt zgjidhjeve

të informuara, trajtimit me prioritet të veprimeve dhe vë në pah alternativat e mundshme në kursin e veprimeve.

Menaxhimi i rrezikut në BQK nuk është proces i pavarur nga aktivitetet dhe proceset tjera të punës, por është pjesë integrale e qeverisjes dhe e të gjitha proceseve, përfshirë planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve.

BQK-ja konform praktikave më të mira ka adaptuar modelin e tri linjave mbrojtëse. Si linjë e parë janë njësitë organizative/bartësit e proceseve përgjegjës për menaxhim të rrezikut përmes vendosjes së kontrolleve. Funkzioni i menaxhimit të rrezikut, shërben si linjë e dytë, me përgjegjësi që të monitorojë përshtatshmërinë e menaxhimit të rrezikut me fushëveprim të përcaktuara. Në linjën e tretë është funksioni i auditimit të brendshëm i cili kryen auditime të rregullta të proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe sistemit të kontrolleve të brendshme.

Funksioni i menaxhimit të rrezikut në baza periodike ka raportuar te Bordi Ekzekutiv i BQK-së rreth aktiviteteve të zhvilluara të cilat kanë qenë në shërbim avancimit të proceseve dhe mbi profilin e përgjithshëm të rrezikut në BQK.

Për realizimin e objektivave të BQK-së, të gjitha aktivitetet e BQK-së funksionojnë duke menaxhuar në mënyrë efektive rrezikun në pajtim me parimet dhe dispozitat e Politikës për Menaxhim të Rrezikut në BQK. Zhvillimi i proceseve të menaxhimit të rrezikut në BQK-së mbështetet mbi parimet të cilat mundësojnë menaxhimin efektiv dhe efikas të rrezikut në arritjen e objektivave të saj. Parimet kryesore janë: krijimi dhe ruajtja e vlerave të përcaktuara në orientimet strategjike dhe të jetësuar në angazhimet operative, integrimi i menaxhimit të rrezikut në strukturën qeverisëse dhe proceset institucionale dhe rezultatet e dala nga proceset e menaxhimit të rrezikut të përdoren për të ndihmuar vendimmarrjen drejt zgjidhjeve të informuara, trajtimit me prioritet të veprimeve dhe vë në pah alternativat e mundshme në kursin e veprimeve.

Është zhvilluar Sistemi për Menaxhimin e Rrezikut, i cili ka për qëllim të mbështes proceset për identifikim, vlerësim, raportim dhe monitorim me qëllim të avancimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut në BQK. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka iniciuar zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Rrezikut përmes të cilit tani mbështeten proceset për menaxhim të rrezikut. Ky projekt është iniciuar duke respektuar Rregullën e Menaxhimit të Projekteve të Teknologjisë së Informacionit në BQK dhe sistemi është zhvilluar nga Grupi i zhvilluesve të softuerëve në kuadër të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

Janë zhvilluar programe vetëdijesimi lidhur me menaxhimin e rrezikut të cilat programe janë ekzekutuar në mënyrë periodike. Për t'i kontribuar ngritjes së vetëdijesimit rreth raportimit të incidenteve, zhvillimit dhe raportimit të indikatorëve kyç të rrezikut dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut janë zhvilluar udhëzues dhe procedura lehtë të qasshëm për stafin. Gjatë periudhave tremujore të raportimit të vetëvlerësimeve dhe indikatorëve të rrezikut, janë mbajtur takime me të gjitha njësitë raportuese me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për identifikim të rrezikut dhe vlerësim të kontrolleve për mitigimi. Gjithashtu, pas çdo zhvillimi dhe avancimi të proceseve dhe instrumenteve mbështetëse janë organizuar tryeza dhe punëtori me njësitë organizative në mënyrë që të ofrohen informacionet e nevojshme për zbatim të kërkesave të reja të nxjerra përmes këtyre akteve.

Proceset për identifikim, analizë dhe vlerësim të rrezikut të cilat përcillen me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorohet niveli i tij janë dizajnuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të Bankës Qendrore duke vënë në pah mundësitë dhe rreziqet potenciale. Për të arritur këtë është bërë lidhja në mes qëllimeve strategjike, proceseve të punës që ndihmojnë arritjen e këtyre objektivave dhe rreziqeve që mund të rrezikojnë arritjen e tyre. Për secilën fazë të ciklit të

menaxhimit të rrezikut janë zhvilluar procedura, forma dhe vegla për të mbështetur identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e nivelit të rrezikut në institucion.

Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut ka përgatitur raporte të konsoliduara me rezultatet e nxjerra pas analizave dhe vlerësimeve duke përdor instrumentet e zhvilluara për këtë qëllim. Raportet si produkte finale të dala pas ekzekutimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut janë standardizuar dhe kostumizuar për palët e interesit.

8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

BQK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha institucionet vendëse dhe ato ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, BQK-ja nën kryesimin e Guvernatorit vazhdoi bashkëpunimin me institucione financiare ndërkombëtare, si: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore (BB), Bankën Qendrore Evropiane (ECB), Bordin e Guvernatorëve të Rezervës Federale të SHBA-së, Autoritetin Bankar Evropian (EBA), Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Komisionin Evropian (EC), Deutsche Bundesbank, Autoritetet e Mbikëqyrjes Federale Gjermane, Autoritetin e Mbikëqyrjes Austriake, Bankën e Turqisë, Bankën e Sllovakisë, Bankën e Portugalisë, Bankën e Italisë, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Bankës Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Këshillin e Byrove të Kartanit të Gjelbër me seli në Bruksel, me Zyrën e Bashkimit Evropian/Përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe institucione tjera.

Në këtë periudhë Guvernatori ka marrë pjesë në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore. Në takimet vjetore janë diskutuar zhvillimet e fundit ekonomike, fiskale dhe financiare, si dhe pritjet për vitin 2022. Gjithashtu, janë diskutuar edhe zbatimi i rekomandimeve nga raportet e mëparshme të asistencave teknike, si dhe shprehjet e interesit për përkrahje në të ardhmen.

Falë bashkëpunimit shumëvjeçar, BQK si nikoqire ka mirëpritur zëvendës drejtorin menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar Bo Li. Zëvendës drejtori menaxhues Bo Li përgëzoi Guvernatorin për ruajtjen e stabilitetit financiar në këtë kohë jo të favorshme ekonomike dhe theksoi rëndësinë e përdorimit të mjeteve mbikëqyrëse për fuqizimin e sektorit financiar. Gjithashtu gjatë vizitës së tij në Kosovë, Zëvendës drejtori Li riafirmoi zotimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për përkrahje të mëtejme dhe kërkoi që të mirëmbahet dhe ruhet pavarësia e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Poashtu, në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së që u mbajtën në Uashington të SHBA-ve, Guvernatori ka zhvilluar takim me përfaqësues të Rezervës Federale të New York-ut. Në takim u diskutua edhe mundësia e zgjerimit dhe avancimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve në fushën e menaxhimit të mjeteve dhe po ashtu edhe për pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga Rezerva Federale e New York-ut. Ndërsa, në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së, Guvernatori u prit në zyrat e Bordit të Guvernatorëve të Rezervës Federale të SHBA-së nga Guvernatorja, Lisa DeNell Cook. Gjithnjë në frymën e këtij bashkëpunimi në këto takime u diskutua bashkëpunimi i deritanishëm me Rezervën Federale, si dhe mundësinë e zgjerimit dhe avancimit të bashkëpunimit të mëtejme mes dy institucioneve. Gjatë vitit 2022 Guvernatori ka pritur në takim drejtues të lartë të FMN-së, derisa në deklaratën përmbyllëse pas vizitës së stafit në Kosovë në datat 10 - 20 maj, i udhëhequr nga shefi i Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Gabriel Di Bella, ky institucion ka vlerësuar se sektori bankar deri më tani i ka përballuar mirë goditjet, i ndihmuar nga një kuadër i mirë rregullator. Poashtu, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar lartë bashkëpunimin me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në një tekst artikull të publikuar, FMN ka përmendur asistencën teknike, përmes Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar (Financial Sector Stability Review - FSSR) e poashtu, deklarata përmbyllëse e Misionit në kuadër të Artikullit IV për vitin 2022 ka vlerësuar se sektori financiar ka përballuar tronditjet që goditën ekonominë dhe një nga faktorët që kanë ndikuar, kanë qenë edhe politikat e ndjekura nga BQK-ja. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime edhe me drejtues

të lartë të Bankës Botërore, ku Zëvendës-presidentja për Evropë dhe Azi Qendrore znj. Anna Bjerde theksoi se Banka Botërore do të vazhdojë të mbajë në nivel të lartë bashkëpunimin me BQK-në, në realizimin e projekteve që për qëllim kryesor kanë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit financiar dhe të ekonomisë së Kosovës në përgjithësi. Ndërkohë, në takimet me drejtuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZH. Guvernatori falënderoi përfaqësuesit e BERZH-it për prezantimin e Raportit të Tranzicionit për vitin 2021/2022, duke theksuar edhe angazhimin dhe kontributin e rëndësishëm që BERZH-i në vazhdimësi ka dhënë për mbështetjen e institucioneve të Kosovës dhe në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjatë vitit 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, organizuan punëtorinë me institucionet financiare rreth rregulloreve të rishikuara të qeverisjes korporative dhe deklaratat mbikëqyrëse. Delegacioni i Kosovës i kryesuar nga Guvernatori ka takuar Drejtoreshën Menaxhuese të Këshillit të Byrove në Bruksel-COB, znj. Greet Floré, të cilën e informoi mbi përgatitjet që Byroja Kosovare e Sigurimit, së bashku me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe institucione të tjera të interesit, kanë ndërmarrë deri më tani në lidhje me kërkesat që lidhen me procesin e anëtarësimit në COB, si dhe për gatishmërinë për të ndërmarrë hapa të tjerë në këtë drejtim. Guvernatori gjatë vizitës së saj në Kosovë ka mirëpritur në takim edhe Presidenten e Këshillit të Byrove, znj. Sandra Schwartz duke e njoftuar lidhur me veprimet e ndërmarra dhe plotësimin e kushteve që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në Kartonin e Gjellbër.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, gjatë vizitës në Stamboll të Turqisë ka takuar Udhëheqësin e Agjencionit Mbikëqyrës dhe Rregullativ Bankar të Turqisë, z. Mehmet Ali Akben. Në këtë takim është diskutuar për vazhdim të bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të stafit të BQK-së, pjesëmarrjen në kolegjet mbikëqyrëse dhe kryerjes së ekzaminimeve të përbashkëta.

Banka Qendrore u përfaqësua po ashtu edhe në takimet e rregullta të Konstituencës që kësaj radhe u mbajtën në Budapest të Hungarisë, me ç'rast u negociua lidhur me marrëveshjen e konstituencës së FMN-së për 10 vitet e ardhshme në të cilën bën pjesë Kosova. Rezultatet e negociatave gjetën mbështetje unanime nga të gjithë anëtarët e konstituencës, ndërsa anëtarët u pajtuan që përbërja e kësaj konstituence edhe për 10 vitet e ardhshme të vazhdojë të jetë e njëjtë me anëtarët e deritanishëm si, Austria, Bellorusia, Republika Çeke, Hungaria, Kosova, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia. Në kuadër të këtij takimi, vendet anëtare u pajtuan edhe për ndarjen e pozitave të përfaqësimit të këtyre vendeve në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv të konstituencës, me ç'rast Kosovës iu alokua pozita e këshilltarit për 4 vite.

BQK gjithashtu bashkë me 18 banka qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (ESCB) ka marrë pjesë në një program të financuar nga BE-ja dhe ku si qëllim kishte forcimin e kapaciteteve institucionale të institucioneve përfituese, veçanërisht duke përmirësuar mjetet e tyre analitike dhe të politikave dhe duke transferuar standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në praktikat kombëtare. Ky program përkrahët nga Deutsche Bundesbank, Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE). Në takimin e zhvilluar në shtator i është dhënë mbështetje këtij programi edhe për 36 muajt të ardhshëm e ku në mesin e 19 bankave përfituese do të jetë edhe BQK-ja.

Guvernatori ka realizuar takime duke pritur në takim edhe Shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian/Përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomáš Szunyog. Guvernatori njoftoi Shefin e Zyrës së BE-së lidhur me veprimet e ndërmarra nga BQK-ja në zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, si dhe me aktivitetet e rregullta në fushën e integritit, të zhvilluara së bashku me institucionet e BE-së. Një bashkëpunim i mirë ka qenë edhe me ambasadat në Kosovë, ku janë realizuar takime me ambasadorin e Turqisë, ambasadorin e Australisë të akredituar për Kosovë dhe Ambasadorin francez në Kosovë, si dhe

janë pritur në takim përfaqësues të bizneseve izraelite. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, organizuan punëtorinë me institucionet financiare rreth rregulloreve të rishikuara të qeverisjes korporative dhe deklaratat mbikëqyrëse. Në këtë punëtori u potencua si konkluzion përmbyllës së BQK është e angazhuar në avancimin e mëtutjeshëm të industrisë financiare në Kosovë, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022, vazhdoi të jetë e përkushtuar rreth informimit dhe edukimit të publikut mbi përgjegjësitë, detyrat dhe aktivitetet e saj.

Gjatë vitit 2022, BQK informoi mediat me kohë dhe në mënyrë të duhur përmes publikimeve të bëra në faqen zyrtare të saj apo edhe duke publikuar e ndarë me media 59 kumtesa dhe njoftime, 153 postime në mediat sociale, janë trajtuar 203 pyetje të mediave, të cilat pasqyruan punën dhe përgjegjësitë e BQK-së, gjatë realizimit të detyrave të saj. Gjatë kësaj periudhe, janë përgatitur shumë video nga aktivitetet e BQK-së (konferenca, raportime në komision) dhe video nga aktivitetet e edukimit financiar, të cilat janë të publikuara në kanal zyrtar të BQK-së në YouTube.

Gjatë vitit 2022, është menaxhuar komunikimi dhe publikimi i materialeve, hulumtimeve dhe raporteve e kumtesave në faqen dhe nënfaqen zyrtare të BQK-së; përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve; përgjigjeve në pyetjet e qytetarëve; pjesëmarrjes në emisione dhe debate televizive, përfaqësimet në radio; konferencave për shtyp, si dhe publikimeve në rrjetet sociale.

Edukimi Financiar – gjatë vitit 2022, ka realizuar aktivitetet:

Java Ndërkombëtare e Parasë 2022 – u mbajt nga 21 deri më 25 mars 2022, ku u zhvilluan aktivitete të edukimit financiar për fëmijë dhe të rinjë nëpër disa qytete të Kosovës për grup-mosha të ndryshme, duke filluar nga nxënësit e shkollave fillore, cikli i ulët deri te studentët e universiteteve. Java u hap me aktivitetin e ndarjes së çmimeve nga konkursi i shpallur për punimet më të mira me temën: “Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde!”. Aktivitetet vazhduan në “Qendrën e Edukimit Financiar” të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në Prizren, me nxënësit e klasave të 6-ta të shkollës fillore “Loyola”, me të cilët u realizua aktivitet edukativ. Aktivitetet vazhduan në shkollën fillore “Emin Duraku” në Shtime, me nxënësit e klasave të katërta të kësaj shkolle. Gjatë kësaj jave u mbajt edhe Ligjëratë me studentët e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë. Ligjëratat u mbajt me studentët e Fakultetit të Edukimit, për rolin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në ekonominë e Kosovës, për strukturën dhe funksionimin e sektorit financiar në Kosovë, si dhe tema të tjera relevante.

1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve u shënua me aktivitet edukativ në SHFMU “Asim Vokshi”, në Prishtinë, ku morën pjesë rreth 60 nxënës të klasave të IV-ta, me të cilët u realizua aktivitet edukativ e informues rreth BQK-së e sektorit financiar.

Dita Botërore e Kursimeve 2022 u shënua përmes një ligjërate me nxënësit e Shkollës së Mesme Ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina”.

Çmimi për Ekonomist të ri – këtë vit tema e konkursit ka qenë: Ndikimi i inflacionit në Tregtinë Evropiane dhe atë të Kosovës.

Gjatë këtij viti janë publikuar materiale edukative, si:

Studim - Remitancat një portë drejt zhvillimit të qëndrueshëm, (në bashkëpunim me Bankën Botërore), pastaj, broshurat:

- Monedhat euro veçoritë dhe tiparet e sigurisë,

- Stabiliteti financiar,
- Kushtet e përgjithshme të policës së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia -TPL.

Gjithashtu në bashkëpunim me zyrën e GIZ në Kosovë, janë përgatitur e publikuar broshurat në vijim:

- Rreth migracionit
- Rreth remitencave
- Rreth dërgimit të remitencave
- Rreth planit të buxhetit personal
- Rreth kredive biznesore, dhe
- Rreth analizës financiare

Aktivitete tjera të realizuara gjatë vitit 2022:

Ligjëratë me studentët e Universitetit të Prishtinës për rolin dhe rëndësinë e sigurimeve në ekonominë e vendit, Ligjëratë për të rinjtë e Grupit për Ballkan, Aktivitet edukimi me fëmijët e SOS Fshatit – bashkëbisedim mbi temat bazike ekonomike e financiare.

Aktivitet i edukimit financiar me nxënësit e shkollës fillore “Shaban Jashari “në Skënderaj.

Aktivitet edukimi me nxënësit e komunitetit turk të shkollave fillore në Prizren dhe aktivitete të tjera të realizuara gjatë këtij viti.

8.3. Asistenca Teknike

BQK-ja ka vazhduar të ketë bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe me bankat qendrore dhe agjencitë rregullatore, si në nivel rajonal ashtu edhe në rrafshin e gjerë ndërkombëtar. Gjatë vitit 2022, bashkëpunimi ka vazhduar me institucionet ndërkombëtare si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, Thesari Amerikan, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Fondi Evropian për Evropën Juglindore, Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike, si dhe bankat qendrore të vendeve tjera.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme nga FMN-ja, gjatë vitit 2022, BQK-ja ka pranuar asistencë teknike, për projektet e mëposhtme:

- Vlerësimin e masave mbrojtëse (Safeguard assesment), i cili vlerësim ka përfshirë fushat dhe funksionet e BQK-së, si: auditimin e jashtëm, auditimin e brendshëm, kornizën ligjore, raportimin financiar dhe kontrollet e brendshme dhe
- Rishikimin e politikës së investimeve të BQK-së, duke përfshirë: investimin në kohë krize, alokimin dhe diversifikimin e investimeve, vlerësimin e performancës së portofolit të BQK-së gjatë viteve të kaluara, vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe operacionale, vlerësimin e menaxhimit të rrezikut etj.
- Asistenca teknike lidhur me përditësimin e manualit ekzistues / zhvillimin e manualit sipas qasjes SREP. Ky manual përfshin procesin e vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit në lidhje me profilin e rrezikut të bankës dhe strategjinë për ruajtjen e niveleve të kapitalit, vlerësimin e brendshëm të niveleve të kapitalit me qëllim që të ruhet pajtueshmëria me rregullatorin, si dhe kërkesat e rregullatorit për nivele shtesë të kapitalit për banka, kur vlerësohet si e tillë.

KOS-18/0005- Mbështetje për integrimin evropian të Kosovës

BQK-ja edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të përfitojë në kuadër të programeve të asistencës së donatorëve nga Dukata e Madhe e Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë, që po mbështetin përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të Kosovës për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, në nivel qendror është ngritur Mekanizimi për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF) për ta mbështetur zbatimin e MSA-së. Në vazhdimësi të projektit KOS-18/0005, gjatë vitit 2022 ka filluar koordinimi i projektit për Asistencë Teknike me UNOPS “Njohuritë për veprimet reformuese në Ballkanin Perëndimor”- financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze. Objektivi kryesor i projektit është që të ofrojë asistencë teknike shteteve të Ballkanit Perëndimor (BP) në shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive me qëllim promovimin e reformave të integritimit evropian. Shteteve të Ballkanit Perëndimor do t’iu ofrohet ekspertizë në harmonizimin e kornizës legislative, strategjike dhe dokumenteve tjera relevante të politikave me qëllim përafrimin me standardet dhe acquis të BE-së.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me bankat tjera qendrore, sipas memorandumeve të mirëkuptimit në fuqi, BQK ka realizuar trajnime në fusha të ndryshme në sferën e integritimeve evropiane, siç është rasti me Bankën e Austrisë, Turqisë dhe Sllovenisë. Në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit me Bankën e Turqisë, gjatë vitit 2022 janë realizuar trajnime në fushën e Administratës, Financave, dhe Menaxhimit të rrezikut. Sipas nevojave të identifikuara, bashkëpunimi pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

8.4. Integritimet Evropiane

Me qëllim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës edhe këtë vit ka vazhduar t’i përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integritimit evropian. Monitorimi i zhvillimeve kryesore legislative dhe praktikave mbikëqyrëse, respektivisht harmonizimi i legjislacionit të BQK-së me ACQUIS, si dhe zhvillimet e fundit makroekonomike janë raportuar në vazhdimësi përmes dokumenteve raportuese, si dhe takimeve me palët vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integritimit evropian në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022 ka bashkëpunuar me institucionet relevante duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në avancimin e procesit të integritimit evropian në Republikën e Kosovës.

Rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka bashkëpunimi me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), e cila është koordinatore kryesore e procesit të integritimit evropian në Republikën e Kosovës. BQK-ja ka pasur bashkëpunim edhe me ministri dhe institucione të tjera si: Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Financave Punës dhe Transfereve; Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë. BQK-ja gjatë vitit 2022 ka vazhduar angazhimin për zbatimin e konkluzioneve të BE-së.

BQK-ja ka raportuar po ashtu për takimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit, duke raportuar inputet e kërkuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto inpute janë pjesë e qëndrimit zyrtar shtetëror (Position Paper), ku prezantohet progresi dhe të arriturat në fushat e caktuara, përfshirë sektorin financiar.

Gjatë vitit 2022, BQK-ja ka raportuar në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE) duke raportuar lidhur me konkluzionet që kanë derivuar nga Dialogu ekonomik dhe financiar mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë; strukturave të përbashkëta në kuadër të MSA-së,

respektivisht Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetin Publik si dhe Nënkomitetit për Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika.

Përpos strukturave të përbashkëta me Komisionin Evropian, BQK-ja ka raportuar në baza të rregullta edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Në këtë kontekst, BQK-ja ka raportuar për kapitujt përbërës të PKZMSA-së, që kanë për qëllim zbatimin e reformave që kërkohen me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA). Kapitujt për të cilët BQK ka raportuar janë: kapitullin e shërbimeve financiare si dhe kapitullin e lëvizjes së lirë të kapitalit. Në kuadër të MSA-së, rrjedhin detyrimet për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në fushën e shërbimeve financiare që lidhen me:

- të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve bankare;
- lirinë e ofrimit të shërbimeve të sigurimeve dhe shërbimeve tjera në fushën financiare; dhe
- përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me legjislacionin e Bashkimit Evropian, statutin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Kërkesat tjera përfshijnë zhvillime nga lëvizja e lirë e kapitalit:

- Legjislacioni i BE-së përfshin edhe rregullat për pagesa ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë.
- Detyrimet që rrjedhin në lidhje me çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave/kapitalit ndërmjet BE-së dhe Kosovës.
- Lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së;
- Në fushën e bankave dhe konglomerateve financiare: (autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredituese, kërkesat në lidhje me llogaritjen e kapitalit të institucioneve kredituese dhe firmave investuese, standardet ndërkombëtare Bazel III);
- Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve të punës: Direktivat evropiane që përcaktojnë rregulla lidhur me autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sigurimit të jetës dhe të jojetës si dhe risigurimin e ndërmarrjeve;
- Në fushën e tregut të letrave me vlerë dhe shërbimeve rreth investimeve: Direktiva 2004/39/KE mbi tregjet e instrumenteve financiare (MiFID).

Nga sfera e Integriteteve Evropiane BQK ka kryer raportime të rregullta lidhur me zhvillimet kryesore nga fushat e sipërpërmendura. Kapitujt të tjerë në të cilët BQK-ja në vazhdimësi ka kontribuar janë: kapitulli i të drejtës së themelimit të kompanive dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve; kapitulli i politikave ekonomike dhe monetare; kapitulli i statistikave; kapitulli i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (neni 89 Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit); si dhe kapitullin e kontrollit financiar.

Gjithashtu, BQK-ja ka përgatitur inputin për Raportin për Komisionin Evropian (KE) dhe në përputhje me afatet e parapara. Inputet janë formë uniforme e raportimit për të gjitha vendet kandidate dhe kandidate potenciale, të cilat mbulojnë zhvillime specifike gjatë gjithë vitit.

Gjithashtu, nëpërmjet Pyetësorit të hartuar nga Komisioni Evropian (pyetësor për të gjitha fushat e kriterëve politike dhe ato të ACQUIS-së), janë raportuar zhvillimet kryesore ligjore për të gjitha pyetjet që janë në fushëveprimtarinë e BQK-së.

Në fund vitit 2022 është përgatitur drafti i konsoliduar i PKZMSA-së, në të cilin BQK-ja ka bërë një përmbledhje të legjislacionit primar dhe akteve sekondare të cilat pritet të aprovohen gjatë

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimin të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njuh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

r) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** – Referuar në kornizën konceptuale (efektive për periudhat vjetore që kanë filluar më ose pas 1 janarit 2022)
- **Ndryshimet në SNK 37 “Provizionet, Pasuritë dhe Detyrimet Kontigjente”** - Kontratat e mëdha Kostoja e përbushjes së një kontrate (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),
- **Ndryshimet në SNK 16 “Prona, Impiantët dhe Paisjet”** -Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- **Cikli i përmirësimeve vjetore të SNRF-ve 2018-2020** i cili është një përmbledhje e ndryshimeve në SNRF 1, SNRF 9, SNK 41 (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022)

Aplikimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve nuk ka pasur ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore në periudhën raportuese.

(ii) Standardet dhe interpretimet nuk kanë datë efektive në periudhën e raportimit

Sikurse në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, rishikimet dhe interpretimet janë botuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive për periudhën e raportimit dhe si të tilla nuk janë aplikuar akoma nga Banka Qendrore:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Prezentimi i Pasqyrave Financiare” dhe Formulimi praktik SNRF 2 “Gjykimi i materialitetit”**- Shpalosja e politikave kontabël (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet”** - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare”** - Klasifikimi i detyrimeve si detyrime afat-shkurtra ose detyrime afat-gjata (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë”** – Detyrimi i qirasë në një shitje dhe marrje sërish me qira (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare”** – Detyrimet afatgjata me marrëveshje (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar).

Banka Qendrore ka zgjedhur të mos aplikoj këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Banka Qendrore parashikon që aplikimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga zhvillimi i aktiviteteve të saj dhe po ashtu edhe nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe administrimi aktiviteteve dhe po ashtu edhe të kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera sasiore dhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Mbikëqyrja e administrimit e aktiviteteve të BQK-së (përfshirë edhe menaxhimin e rrezikut) është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësinë t'i identifikojë dhe t'i vlerësojë rreziqet dhe të hartojë plane, që në rast të papriturash në të ardhmen, të sigurohen vazhdimësia e veprimtarive dhe siguria e Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht (në baza tremujore) nëpërmjet Departamentit për Menaxhimin e rrezikut dhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i BQK-së mbi praktikën e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për menaxhimin e rrezikut e kanë për detyrë të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqe, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së po ashtu është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe të rastësishme (ad-hoc), rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të Brendshëm tek Komiteti i Auditimit, pastaj te Bordi i BQK-së.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera. BQK për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut të kredisë, BQK-ja konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (siç është rreziku i vonësës së detyrimeve individuale, rreziku i vendit dhe sektorit).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj rrezikut kreditor në BQK

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Menaxhimi i rrezikut bëhet përmes:

- Kufizimit të fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së instrumenteve financiare,
- Kufizimit të emetuesve të palëve, me vlerësim të pranueshëm kredie për klasën e investimit dhe me lartë,
- Kufizimit të shumës dhe përqendrimit maksimal me palët.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat e huaja, letrave me vlerë (Bono të thesarit dhe Obligacione) dhe depozitave me bankat (përfshirë ato rezidente dhe jo rezidente). Për detaje mbi ekspozimin referohuni edhe te shënimet 8, 9 dhe 10.

Vlerësimi kreditor për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2022 është prej AAA deri BBB-/ Aaa deri Baa3/AAA deri BBB-.

Tabela në vijim paraqet vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas rangimit kreditor dhe të shprehura edhe pjesmarrja në përqindje me gjithsej.

Shpërndarja sipas llojit dhe vlerësimit kreditor

Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	31 dhjetor 2022					
	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	205,718	54,956	168,864	-	429,538	36.23%
AA+/Aa1/AA+	-	-	61,222	-	61,222	5.16%
AA/Aa2/AA	-	-	59,988	-	59,988	5.06%
AA-/Aa3/AA-	-	-	51,308	-	51,308	4.33%
A+/A1/A+	138	-	52,379	-	52,517	4.43%
A/A2/A	330	-	15,810	-	16,140	1.36%
A-/A3/A-	214	45,050	218,415	-	263,679	22.24%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	38,973	-	38,973	3.29%
N/A (pa vlerësim - IFN ⁶)	-	-	-	160,327	160,327	13.52%
N/A (pa vlerësim) ⁷	-	-	-	51,745	51,745	4.37%
Gjithsej	206,400	100,006	666,959	212,072	1,185,437	100.00%

⁶ IFN – Institucione financiare ndërkombetare.

⁷ Nuk ekziston ndonjë vlerësim kreditor (as i jashtëm as i brendshëm), për pasuritë në fjalë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

Shprehendaja sipas llojin dhe vlerësimit kreditor

Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	31 dhejtor 2021			
			Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	109,931	4,415	113,844	-	228,190	22.36%
AA+/Aa1/AA+	-	-	134,241	-	134,241	13.15%
AA/Aa2/AA	-	-	10,011	-	10,011	0.98%
AA-/Aa3/AA-	-	-	-	-	-	0.00%
A+/A1/A+	441	-	-	-	441	0.04%
A/A2/A	9,944	-	118,191	-	128,135	12.56%
A-/A3/A-	31,596	9,644	216,576	-	257,816	25.26%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	40,107	-	40,107	3.93%
N/A (pa vlerësim - IFN)	-	-	-	158,218	158,218	15.50%
N/A (pa vlerësim)	-	-	-	63,359	63,359	6.21%
Gjithsej	151,912	14,059	632,970	221,577	1,020,518	100.00%

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është në vonesë. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

Kriteret themelore të përcaktimit të ekspozimit janë vlerësimi kreditor. Vlerësimi kreditor merret nga agjensitë për vlerësim kreditor. Klasifikimi kreditor minimal i lejuar për investim në afat të shkurtër është P-2 (Moody's) ose A-2 (Standard & Poor's), ndërsa në afat të gjatë është Baa2 (Moody's) ose BBB (Standard & Poor's).

Ne rastet e jashtëzakonshme në pamundësi të realizimit të kthimeve pozitive, lejohet ekspozim i investimeve përmes klasifikimit afatshkurtër kreditor të emetuesit P-3 (Moody's) apo A-3 (Standard & Poor's) dhe klasifikimit afatgjatë kreditor të emetuesit Baa3 (Moody's) apo BBB-(Standard & Poor's).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

Modeli i dëmtimit të pasurive financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor respektivisht ndryshimeve në rrezik kreditor që nga njohja fillestare e pasurive financiare përcakton tre faza në modelin e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore. Këto faza mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Faza 1 (Performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - pasuritë financiare të cilat trajtohen si ekspozim me rrezik të ulët ose të mesëm përfshihen në këtë fazë në njohjen fillestare. Bazuar në procedurat tona të brendshme, nuk na lejohej të investojmë në ekspozime me rrezik të lartë kreditor. Bazuar në këtë, çdo investim në njohjen fillestare alokohet në Fazë 1 të ekspozimit.
2. Faza 2 (Nën-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - nëse kemi një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare, pasuria financiare e cila ndodhet në shkallën 1, transferohet në fazën 2.
3. Faza 3 (Jo-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - transferimi në fazën 3 bëhet vetëm atëherë kur ka evidenca objektive që klienti do të dështon në përmbushje të obligimeve.

Vlerësimi bëhet në njohjen fillestare dhe në datën e periudhës së raportimit. Modeli i përdorur për fazën 1 të shpërndarjes është baza 12 mujore e jetëgjatësisë, por mund të varet nga niveli i përbërë i ekspozimit të kredisë nëse kemi ndryshim të rëndësishëm në rritjen e rrezikut të kredisë dhe në kredinë e zhvlerësuar të portofolit të aktivitetit financiar.

Ndryshimi i ndjeshëm në rritjen e rrezikut të kredisë si kriter për të kaluar nga faza 1 në fazën 2, kur ai kalon nga klasa e investimit në klasën jo-investuese të vlerësimit të përbërë të kredisë së një portofoli.

Definicioni i dështimit:

Kriteret e dështimit duhet të bazohen në provat objektive të:

- Debitorëve, me vështirësi të konsiderueshme financiare,
- Kur është fjala për shkelje të detyrimeve kontraktuale, në lidhje me kryegjënë dhe interesin,
- Kur të ndodhë me ndonjë ristrukturim të kushteve ekzistuese të përmbushjeve të detyrimit nga një instrument financiar,
- Dëshmi/probabilitet i qartë që debitori po kalon në falimentim dhe/ose likuidim,
- Shenjat e të qenit jo aktiv në tregtim (në tregjet financiare).

Në tabelën në vijim paraqiten vlerat e ekspozimit në nivel të fazave. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	2022 ⁸			2021		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	206,400	-	-	151,912	-	-
Letrat me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	666,959	-	-	632,970	-	-
Plasmanët në tregun e parasë	100,006	-	-	14,059	-	-
Vlera bartëse bruto	973,365	-	-	798,941	-	-
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(459)	-	-	(406)	-	-
Neto vlera bartëse	972,906	-	-	798,535	-	-

⁸ Në vitin 2022 dhe as në vitin krahasues nuk janë të përfshira instrumentet financiare për llogaritë e ndërlidhura me FMN (IMF), pasi vlerësimi/pritshmëria është se ky grup nuk është ekspozim që mbart në vete lejime për humbje të pritura kreditore (HPK).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare ku BQK ka ekspozim janë si më poshtë:

	2022			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2022	406	-	-	406
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	53	-	-	53
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	459	-	-	459
	2021			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2021	1,399	-	-	1,399
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	(993)	-	-	(993)
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	406	-	-	406

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet e saj financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shumën të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësuar BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testimet të rregullta të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për pasuritë dhe detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit:

31 dhjetor 2022	Shënim	Neto vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vit deri në 5 vite	mbi 5 vite
Pasuritë jo-derivative							
Paraja e gatshme		409,426	409,426	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja	8	206,359	206,359	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	666,597	-	51,407	140,605	456,480	18,105
Plasmanët në tregun e parasë	10	99,950	14,799	40,069	45,082	-	-
Llogaritë në FMN	11	229,784	178,039	-	12,936	38,809	-
		1,612,116	808,623	91,476	198,623	495,289	18,105
Detyrimet jo-derivative							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(594,281)	(594,281)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(239,449)	(271)	-	(12,936)	(38,809)	(187,433)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(585,784)	(585,784)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(131,137)	(131,137)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(1,938)	-	-	(228)	(912)	(798)
Detyrime tjera vendore	20	(756)	(756)	-	-	-	-
		(1,553,345)	(1,312,229)	-	(13,164)	(39,721)	(188,231)
		58,771	(503,606)	91,476	185,459	455,568	(170,126)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2021

	Shënim	Neto vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1 deri ne 3 muaj	3 muaj deri ne një vit	1-5 vite	mbi 5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
Paraja e gatshme		537,818	537,818	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja	8	151,880	151,880	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	632,602	-	27,849	346,143	224,592	34,018
Plasmanët në tregun e parasë	10	14,053	14,053	-	-	-	-
Llogaritë në FMN	11	239,903	176,544	12,251	-	51,108	-
		1,576,256	880,295	40,100	346,143	275,700	34,018
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(589,099)	(589,099)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(248,584)	(268)	(12,251)	-	(51,108)	(184,957)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(608,362)	(608,362)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(77,392)	(77,392)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(2,139)	-	-	(225)	(901)	(1,013)
Detyrime tjera vendore	20	(756)	(756)	-	-	-	-
		(1,526,332)	(1,275,877)	(12,251)	(225)	(52,009)	(185,970)
		49,924	(395,582)	27,849	345,918	223,691	(151,952)

Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që pasuritë dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e ri-çmimit të indekseve të shumëllojshme me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve.

Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet tabelën e mëposhtme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 dhjetor 2022	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	206,359	206,359	-	-	-	-
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	9	666,597	-	10,109	34,499	567,624	54,365
Plasmanët në tregun e parasë	10	99,950	24,774	30,094	35,090	9,992	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	229,784	178,039	-	-	51,745	-
Gjithsej		1,202,690	409,172	40,203	69,589	629,361	54,365
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(594,281)	(594,281)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(239,449)	(271)	-	-	(51,745)	(187,433)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(585,784)	(585,784)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(131,137)	(131,137)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(1,938)	-	-	-	-	(1,938)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,553,345)	(1,312,229)	-	-	(51,745)	(189,371)
Ndryshimi		(350,655)	(903,057)	40,203	69,589	577,616	(135,006)

31 dhjetor 2021	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	151,880	151,880	-	-	-	-
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	9	632,602	-	-	6,635	518,894	107,073
Plasmanët në tregun e parasë	10	14,053	14,053	-	-	-	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	239,903	176,544	-	-	63,359	-
Gjithsej		1,038,438	342,477	-	6,635	582,253	107,073
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(589,099)	(589,099)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(248,584)	(268)	-	-	(63,359)	(184,957)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(608,362)	(608,362)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(77,392)	(77,392)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(2,139)	-	-	-	-	(2,139)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,526,332)	(1,275,877)	-	-	(63,359)	(187,096)
Ndryshimi		(487,894)	(933,400)	-	6,635	518,894	(80,023)

Pasuritë dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë të përfshira në tabelën më lartë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2022

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(3,507)	3,507

2021

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(4,879)	4,879

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutor të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT-të lidhur me pasuritë dhe detyrimet e saj në FMN si dhe ndaj USD lidhur me pasuritë e saj në formën e llogarive rrjedhëse me bankat jo rezidente dhe investimet në letra me vlerë në dollar, të cilat i monitoron në vazhdimësi. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2022

	DVT		USD	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	51	(51)	(98)	98

2021

	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	42	(42)	(92)	92

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2022	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
Pasuritë				
Paraja e gatshme	409,426	-	-	409,426
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	206,012	347	-	206,359
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	661,916	4,681	-	666,597
Plasmanët në tregun e parasë	95,168	4,782	-	99,950
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	1,158	-	314,405	315,563
Mjetet e tjera	2,709	-	-	2,709
Gjithsej	1,376,389	9,810	314,405	1,700,604
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	594,281	-	-	594,281
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	1,201	-	317,535	318,736
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	585,784	-	-	585,784
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	131,137	-	-	131,137
Nga huamarrja /et	-	-	1,938	1,938
Detyrime të tjera vendore	2,444	-	-	2,444
Gjithsej	1,314,847	-	319,473	1,634,320
Pozicioni neto për valuta të huaja	61,542	9,810	(5,068)	66,284
31 dhjetor 2021				
Pasuritë				
Paraja e gatshme	537,818	-	-	537,818
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	151,552	328	-	151,880
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	628,188	4,414	-	632,602
Plasmanët në tregun e parasë	9,638	4,415	-	14,053
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	144	-	323,649	323,793
Mjetet e tjera	2,187	-	-	2,187
Gjithsej	1,329,527	9,157	323,649	1,662,333
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	589,099	-	-	589,099
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	145	-	325,708	325,853
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	608,362	-	-	608,362
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	77,392	-	-	77,392
Nga huamarrja /et	-	-	2,139	2,139
Detyrime të tjera vendore	2,418	-	-	2,418
Gjithsej	1,277,416	-	327,847	1,605,263
Pozicioni neto për valuta të huaja	52,111	9,157	(4,198)	57,070

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht “Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes” (“DVT”) dhe Dollar Amerikan (USD). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 ishin si vijon:

	2022	2021
	Euro	Euro
1 DVT	1.25291	1.23748
1 USD	0.93756	0.88292

DVT-të janë pasuri rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së pesë valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike, jeni japonez dhe renmindbi kinez.

USD-të janë mjete në llogari rrjedhëse dhe afatizime brenda natës (si repo) me Federal Rezerve New York.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullative si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objekti i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional, si dhe dëshiron të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me menaxhimin e kostove efektive.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket çdo njësie organizative përmes stafit menaxhues të tyre. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program raportimi periodik i rishikuar prej Departamentit për menaxhimin e rrezikut dhe Auditimit të Brendshëm. Gjetjet e vlerësimeve si të Departamentit për menaxhimin e rrezikut ashtu edhe të Auditimit të Brendshëm diskutohen me menaxhimin e njësisë organizative me të cilën ato ndërlidhen, dhe po ashtu të njëjtat dorëzohen dhe diskutohen në Komitetin e Auditimit dhe të organet vendimmarrëse të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që pëson BQK-ja. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit të përealizuara që rrjedhin nga fitimet dhe humbjet e përealizuara për shkak të pozicioneve të saj me valuta të huaja, ari, instrumente financiare dhe aktive tjera.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të përealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të përealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e përealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të përealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e përealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të përealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

Të ardhurat e ndashme

Përshkrimi	2022	2021
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	8,552	6,116
Nga të cilat janë fitimet (fitimet) e përealizuara nga rivlerësimi (shënimi 29)	542	1,529
Nga të cilat janë humbjet e përealizuara të rivlerësimit të cilat janë realizuar në vitin aktual	-	-
Të ardhurat e ndashme	8,010	4,587

Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme

	2022	2021
Kapitali	30,000	30,000
Rezervat e përgjithshme	31,444	26,857
Të ardhurat e ndashme	8,010	4,587
Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme	69,454	61,444

Gjithsej detyrimet monetare

	2022	2021
Ndaj bankave komerciale vendore	594,281	589,099
Ndaj institucioneve qeveritare	585,784	608,362
Ndaj llogarive të lidhura me FMN ⁹	187,704	185,225
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	131,137	77,392
Nga huamarrja/et	1,938	2,139
Ndaj detyrimeve tjera monetare	756	756
Gjithsej detyrimet monetare	1,501,600	1,462,973
Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1.	4.63%	4.20%

⁹ Përfshijë llogarinë e letrave me vlerë dhe akrualet.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(g) Menaxhimi i asetëve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuara në emër të Ministrisë së Financave.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare përfshin përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve të pasigurta lidhur me ngjarjet e ardhshme që ndikojnë në shumatat e njohura për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet. Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet kreditore

Pasuritë e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen në baza të vazhdueshme për të identifikuar rënien e mundshme në vlerë të pasurisë. Pasiguri në vlerësim të cilat mund të rezultojnë në një rregullim material në periudhë raportuese, paraqiten në rastin e: përcaktimit të të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen dhe supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e flukseve të rikuperueshme monetare. Përbërësit specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të pasurive financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohen në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur.

Pandemia COVID 19 dhe zhvillimet tjera globale

Në pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 2022 rezervat ndërkombëtare të bankës, të përbërë nga letra me vlerë të vlerësuara lartë dhe depozita bankare afatshkurtra (në valuten euro), nuk janë ndikuar materialisht nga ngadalësimi ekonomik në nivel global respektivisht përkeqësimi i kushteve të tregut si rezultat i pandemisë, inflacionit dhe krizave tjera të këtyre viteve në nivel global. Si dhe po ashtu nuk vlerësojmë se do ketë ndikim edhe në vitin pasues pas vitit raportues.

Gjatë vitit 2021, ka pasur një emetim të ri nga FMN që ka rritur rezervat ndërkombëtare në valutë DVT (SDR) për anëtarët e saj, rritje kjo që ka përfituar edhe Kosova, duke ju rritur rezervat ndërkombëtare të Kosovës me FMN për rreth 100 milion euro [apo rreth 79 milion DVT (SDR)]. Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndryshim të theksuar të ngjashëm.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që pasuritë dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e pasurive financiare si të mbajtura për t'u arkëtuar rrjedhat e kontraktuara të parasë, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për t'i mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël.

Poashtu gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël, që kanë një ndikim domethënës në shumatat e njohura në pasqyrat financiare janë: përcaktimi i kritereve për të vlerësuar nëse rreziku kreditor i një pasurie financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit mbi të ardhmen në matjen e Humbjeve të Pritshme Kreditore (HPK) dhe përzgjedhja dhe miratimi i modeleve të përdorura për të matur HPK-të.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

6. Pasuritë dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të pasurive dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre. Të gjitha pasuritë financiare janë të mbajtura në koston e amortizuar (të mbajtura për të arkëtuar).

31 dhjetor	Shënim	2022		2021	
		Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë	Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme	7	409,426	409,426	537,818	537,818
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	206,359	206,359	151,880	151,880
Letrat me vlerë	9	666,597	645,095	632,602	631,621
Plasmanët në tregun e parasë	10	99,950	99,950	14,053	14,053
Pasuritë lidhur me FMN	11	315,563	315,563	323,793	323,793
Pasuritë tjera	14	176	176	129	129
		1,698,071	1,676,569	1,660,275	1,659,294
Detyrime ndaj bankave vendase	15	594,281	594,281	589,099	589,099
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	318,736	318,736	325,853	325,853
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	585,784	585,784	608,362	608,362
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	131,137	131,137	77,392	77,392
Nga huamarria /et	19	1,938	1,938	2,139	2,139
Detyrime të tjera vendase	20	756	756	756	756
		1,632,632	1,632,632	1,603,601	1,603,601

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme

	2022	2021
Paraja e gatshme	409,426	537,818
Gjithsej vlera	409,426	537,818

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2022	2021
Deutsche Bundesbank	142,288	64,669
Raiffeisen Zentralbank	330	9,944
Deutsche Bank	214	31,596
Banque centrale du Luxembourg	63,102	44,985
Commerzbank AG	138	441
Federal Reserve Bank (FED-NY)	328	277
Gjithsej vlera bartese	206,400	151,912
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(41)	(32)
Gjithsej vlera neto	206,359	151,880

Deri më 27 korrik 2022, BQK-ja ka paguar norma negative për gjendjet e llogarive rrjedhëse nostro pranë bankave korrespondente (sipas limiteve të caktuara të përcaktuara prej tyre). Nga data 27 korrik (referuar vendimit të BQE-së për ndryshimin e normës bazë të interesit nga 27 korrik 2022, 14 shtator, 2 nëntor dhe 21 dhjetor 2022) BQK-ja merr interes nga normat pozitive në llogaritë rrjedhëse nostro me Deutsche Bundesbank dhe Banque Centrale du Luxembourg (sipas disa kufijve të përcaktuar prej tyre). Norma e interesit për periudhën raportuese është ndërmjet 1.85% dhe 2%.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja janë si më poshtë:

	2022			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2022	32	-	-	32
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	9	-	-	9
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	41	-	-	41

	2021			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2021	363	-	-	363
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	(331)	-	-	(331)
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	32	-	-	32

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit janë letra të borxhit të lëshuara nga vendet e Bashkimit Evropian, Amerika dhe nga Kosova. Bonot e thesarit të shpalosura me poshtë kanë maturitetet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve deri në 7 vite. Norma e interesit efektiv në letra me vlerë variron nga -0.014% deri në 3.023% vjetore në vitin 2022 (2021: -0.014% deri në 3.023% vjetore).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare) (vazhdim)

Shpalosje analitike e letrave me vlerë sipas llojit dhe sipas shteteve emetuese:

Sipas shteteve:

Shteti	2022			2021		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera
Gjermani	95,693	(40)	95,653	65,703	(32)	65,671
Francë	59,988	(28)	59,960	10,011	(16)	9,995
Holandë	48,956	(18)	48,938	12,122	(4)	12,118
Finlandë	51,251	(18)	51,233	-	-	-
Sloveni	21,021	(13)	21,008	-	-	-
Luksemburg	13,520	(1)	13,519	87,452	(17)	87,435
Belgjikë	51,308	(22)	51,286	-	-	-
Zvicër	-	-	-	-	-	-
Danimarkë	6,014	(1)	6,013	6,027	(3)	6,024
Austri	9,971	(2)	9,969	72,366	(21)	72,345
Irlandë	52,379	(4)	52,375	102,229	(11)	102,218
Amerikë	4,681	(1)	4,680	4,414	(1)	4,413
Itali	38,973	(24)	38,949	40,107	(63)	40,044
Poloni	15,810	(35)	15,775	15,962	(35)	15,927
Kosovë	197,394	(156)	197,239	216,577	(165)	216,412
Gjithsej	666,959	(362)	666,597	632,970	(368)	632,602

Sipas llojit:

	2022			2021		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto Vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera
Bono thesari	24,642	(6)	24,636	4,414	(1)	4,413
Obligacione	642,317	(356)	641,961	628,556	(367)	628,189
Gjithsej	666,959	(362)	666,597	632,970	(368)	632,602

Lëvizjet e HPK përkatëse për letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar janë si më poshtë:

	2022			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2022	368	-	-	368
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	(6)	-	-	(6)
